Translacioni është lëvizje e formës 2D sipas drejtimit dhe kahes.

Format 2D janë të lëvizshme në rrafsh sipas drejtimit dhe kahes së dhënë.



Djathtas për 4 katrorë



Poshtë për 3 katrorë



Majtas për 5 katrorë



Translacioni për 5 katrorë djathtas dhe 2 katrorë poshtë.



Translacioni për 2 katrorë djathtas dhe 3 katrorë lart.

1

Në vizatim është dhënë trekëndëshi T të vizatuar në letër me katror.



a) Kryeje translacionin e T për 3 katrorë djathtas dhe 4 katrorë lart. Shënoje figurën me K..

b) Kryeje translacionin e T për 2 katrorë majtas dhe 3 katrorë poshtë. Shënoje figurën me H.

.



Shembull:
Translacioni i formës 3D prej kuadrantit të parë për 6 katrorë majtas

1

Te këtoforma 2D bëj translacionin:

a) për 6 katrorë djathtas, kurse pastaj cakto koordinatat e kulmeve të figurës.

b) për 7 katror ëmajtas, kurse pastaj cakto koordinatat e kulmeve të figurës.





2

Mario çdo mëngjes shkon deri te shkolla sipas planit të tij të lëvizjes.

Tregoni planin e lëvizjes së Mario prej figurës.

Bëni planin tuaj me disa proporzime për lëvizje.

Pse i zgjodhët ato pako?

TEMA 3
OPERACIONET ME NUMRA

- **Mbledhja dhe zbritja deri më 1 000 000 (mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, vetia komutative dhe vetia asociative)**
- **Shumëzuesi dhe pjesëtuesi**
- **Thyesa**

REZULTATET NGA TË MËSUARIT

Nxënësi/nxënësja do të aftësohen:

1. të mbledhë dhe zbresë numra deri 1 000 000;
2. të zgjidhë problem me gjetjen e pjesëtuesve ose shumëfishave të numrave dyshifrorë;
3. të zgjidhë problem nga konteksti i përditshmërisë me shumëzim dhe pjesëtim deri 10 000;
4. të shfrytëzojë barazi të thyesave të rregullta gjatë të zgjidhurit e problemeve me mbledhje dhe zbritje të thyesave të rregullta me emërues të njëjtë;
5. të mbledhë, zbresë numra dhjetorë deri 100 dhe të shumëzojë numër dhjetor me një dhjetore, më të vogël se 10, me numër njëshifror

SFIDA TË MUNDSHME

Shumë shprehje të cilat përmbajnë operacione mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim paraqesin vështirësi për nxënësit dhe moment të të menduarit të rendit të kryerjes së operacioneve dhe dhënia e përparësisë së zgjidhjes së operacionit përkatës te detyra. Si sfidë parashtrohen detyra të nivelit themelor me shprehje numerike vetëm me mbledhje dhe zbritje të cilat paraqesin paranjohuri për rendin e zgjidhjes së operacioneve te detyra. Gradualisht duhet të futen edhe shumëzimi edhe pjesëtimi dhe të orientohet përparësia e tyre paraprake e zgjidhjes së detyrave (të mos lihet përparësia e kllapës). Sfida është të kuptohen dhe drejt të zbatohen vetia komutative, asociative dhe distributive në operacionet përkatëse. Të kuptuarit e barazisë, krahasimi i thyesave dhe mbledhja e thyesave me emërues të barabartë, është e nevojshme të vizuelizohet me shembuj me vegla manipulative dhe digjitale. Nxënësit kanë vështirësi në të kuptuarit e vlers vendore dhe rëndësia e numrave dhjetorë, prandaj gabojnë në mbledhjen dhe zbritjen e numrave dhjetorë. Është e nevojshme të ushtrohet vendosja e numrave dhe përvetësimi gradual i tyre tek operacionet e mbledhjes dhe zbritjes.

Fjalori koncepteve të reja

Mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, vetia komutative, vetia asociative dhe vetia distributive, shumëfishi, pjesëtuesit, nuk është pjesëtues, shumëzuesi, prodhimi, katrori i numrit, i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi, ndryshorja, thyesat e rregullta, numëruesi, emëruesi, thyesa të barabarta, numri dhjetor me dy dhjetore.

Tema

3

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE DERI 1 000 000

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE DERI 10 000

Të përkujtojmë!

- Shifrat në klasën e njëjtë i shkruajmë njëra nën tjetrën.
- Edhe mbledhja edhe zbritja kryhen duke filluar prej klasës së njësheve.
- Numrat katërshifrorë i mbledhim dhe i zbresim njëjt sikurse që i mbledhim dhe i zbresim numrat treshifrorë, vetëm që tani mbledhim dhe zbresim edhe njësha mijëshe me njëshe mijëshe.

Vëre se si është njehsuar shuma e numrave 2 354 dhe 3 521.

QM	DHM	M	Q	DH	NJ
		2	3	5	4
	+	3	5	2	1
		5	8	7	5

Themi:

4NJ + 1NJ = 5NJ

5DH + 2DH = 7DH

3Q + 5Q = 8Q

2M + 3M = 5M

Praktikisht:

$$\begin{array}{r} 2\,354 \\ +\,3\,521 \\ \hline 5\,875 \end{array}$$

1 **Njehso shumat**

a) $\begin{array}{r} 4\,150 \\ +\,2\,628 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 6\,204 \\ +\,2\,674 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 5\,148 \\ +\,2\,730 \\ \hline \end{array}$

2 **Cili numër është për 1 250 më i madh se numri 3 628?**

3 **Cili numër do të fitohet nëse shuma e numrave 2 004 dhe 3 020 zmadhohet për 1 642?**

4 **Prej një are fitohen 1 560 thasë me grurë dhe 980 thasë me tërshërë më shumë. Sa gjithsej grurë dhe tërshërë janë fituar prej arës?**

5 **Në një postë kanë arritur 2 990 letra dhe 1 050 kartolina më shumë se letra. Sa gjithsej letra dhe kartolina kanë arritur në postë?**

6 **Njehso shumat**

a) 3 247 + 1 899 b) 5 674 + 2 746 c) 6 378 + 2 784 ç) 4 479 + 3 856 d) 6 748 + 2 695

Vëre se si është njehsuar ndryshimi i numrave 6 859 dhe 4 423

QM	DHM	M	Q	DH	NJ
		6	8	5	9
	–	4	4	2	3
		2	4	3	6

Themi

9NJ – 3NJ = 6NJ

5DH – 2DH= 3DH

8Q – 4Q= 4Q

6M - 4M = 2M

Praktikisht:

6 859
- 4 423
2 436

7 **Njehso ndryshimet:**

a) 6 858 – 2 335 b) 8 888 – 5 225 c) 9 638 – 3 205

8 **Cili numër do të fitohet, nëse shuma e numrave 4 320 dhe 2 566 zvogëlohet për 3 333?**

9 **Një kopshtar ka mbledhur 5 756 kg mollë ajdaret, por jonatan për 2 544 kg më pak. Sa gjithsej kilogram mollë ka mbledhur kopshtari?**

10 **Njehso:**

a) 3 156 + 1 789 b) 5 961 + 345 c) 8 237 + 88 ç) 4 088 + 2 890 d) 7 135 + 1 009

dh) 9 655 – 7 481 e) 7 108 – 2 099 ë) 5 694 – 2 538 f) 8 620 – 3 485

11 Me shifrat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 dhe 0 shkruaj dy numra katërshifrorë, duke përdorur çdo shifër vetëm njëherë, ashtu që shuma e tyre të jetë:

a) më i vogël b) më i madh

12 **Prej shumës së numrave 4164 dhe 3 301 zbrit shumën e numrave 3 223 dhe 2 179.**

Tema 3

MBLEDHJA E NUMRAVE PESËSHIFRORË DHE GJASHTËSHIFRORË TË PËRAFËRT DERI TE SHUMËFISHAT E 10, 100, 1 000, 10 000 DHE 100 000

1 **Anja ka kursyer 20 000 denarë. Për ditëlindjen e saj gjyshja i ka dhënë 10 000 denarë, gjyshi 1 000 denarë, nëna 100 denarë, por babai 10 denarë. Sa denarë gjithsej ka Anja? Parashtroje detyrën në shtylla.**



2 **Lidhi kartelat prej rendit të poshtëm dhe të lartë.**

a) me ngjyrë të gjelbër kartelat që bëjnë shumën 1 000

b) me ngjyrë të kuqe çiftin e kartelave shuma e të cilave është 10 000

c) me ngjyrë të kuqe çiftin e kartelave shuma e të cilave është 10 000

ç) me ngjyrë të kaltër çiftin e kartelave shuma e të cilave është 1 000 000

20 000	36 000	700 000	84 000	600	7 000	45 000	81 000	5 000
55 000	3 000	19 000	5 000	80 000	400	300 000	64 000	16 000

3 **Te tabela e vlerës vendore paraqiti mbledhësit, njehso shumën dhe vëre ndryshimin. Nga sa zmadhohet numri?**

500 000 + 10 =____
500 000 + 100 =____
500 000 + 1 000 =____
500 000 + 10 000 =____
500 000 + 100 000 =____

	MILIONË	MIJËSHE			NJËSHE		
	M	QM	DHM	NJM	Q	DH	NJ
+							

4 **Njehso:**

a	a + 10	a + 100	a + 1 000	a + 10000	a + 100000
5 399					
18 402					
10 168					
20 640					
180 000					
630 900					
900 000					

5 **Njehso shumat:**

31 310 + 10 = _____ 25 000 + 500 = _____ 48 900 + 60 = _____

89 300 + 100 = _____ 74 600 + 30 = _____ 41 189 + 400 = _____

5 000 + 90 = _____ 90 520 + 200 = _____

6 **Njehso:**

5 550 + 1 000 =

9 000 + 1 000 =

20 000 + 40 000 =

69 000 + 10 000 =

1 000 + 5 000 + 3 000 =

30 000 + 10 000 + 50 000 =

7 **Njehso :**

200 000 + 500 000 =

600 000 + 100 000 =

800 000 + 100 000 =

900 000 + 100 000=

300 000 + 400 000 =

500 000 + 500 000 =



20 000 + 40 000 = 60 000



300 000 + 400 000 = 700 000

8 **Te shima e numrave 40 000 dhe 20 000 shto numrin më të vogël pesëshifror.**

9 **Zgjidhe katrorin magjik. Shuma e të gjithë numrave në rresht, në shtyllë dhe në diagonal është numër i njëjtë.**

1 000			1 400
	1 600	1 700	
1 800	2 000		
2 300	1 300	1 200	

10 **Për sa shuma e numrave 70 000 dhe 90 000 është më e madhe prej numrit 100 000.**

11 **Një fermë ka prodhuar 400 000 litra qumësht delesh dhe qumësht lopësh për 100 000 litra më shumë se qumësht delesh. Sa litra qumësht gjithsej ka prodhuar ferma?**

Tema 3

ZBRITJA E NUMRAVE PESËSHIFRORË DHE GJASHTËSHIFRORË TË PËRAFËRT DERI TE SHUMËFISHAT E 10, 100, 1 000, 10 000 DHE 100 000

1 **Njehso shumat**

a) 7 000 – 3 000 =



b) 60 000 – 20 000 =



c) 50 000 – 200 000 =



2 **Njehso:**

4 000 - 2 000 =
9 000 – 7 000 =
8 500 – 4 500 =
10 000 – 6 000=

15 000 – 5 000 =
37 000 – 14 000 =
68 000 – 8 000=
70 000 – 20 000 =

200 000 – 150 000 =
389 000 – 100 000 =
579 000 – 179 000 =
980 000 – 80 000 =

3 **Njehso:**

a	a – 10	a – 100	a – 1 000	a – 10 000	a – 100 000
117 490					
215 390					
410 168					
520 640					
780 000					
830 900					
900 000					

4 **Te çdo grup të numrave, gjej çiftet e numrave që kanë shumë të barabartë me çdo shumëfish të 1 000 dhe të 100 000**

a) 3 785, 4 000, 3 057, 1 215
b) 8 990, 5 670, 4 330, 1 010
c) 6 459, 2 891, 1 541, 8 900
ç) 1 100, 4 865, 1 900, 2 869
d) 279 000, 527 900, 172 100, 121 000
dh) 456 000, 269 000, 131 000, 56 000
e) 109 109, 901 901, 350 000, 50 000

Sqaro cilat rregulla i vëren gjatë të zgjidhurit.

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE PESËSHIFRORË DHE GJASHTËSHIFRORË

Për njehsimin e shumës përmendësh, mund t'i rrumbullakojmë deri te dhjetëshja, qindëshja ose dhjetë mijëshja më e afërt. Edhe tek operacioni zbritje caktimin e ndryshimit përmendësh, të zbritshmin ose zbritësin mund t'i rrumbullakojmë deri te dhjetëshja, qindëshja, mijëshja ose dhjetë mijëshja më e afërt.

Për të **shtuar** 9 ndonjë numri, shto 10, pra **zbrit** 1.
Shembull: 246 + 9 = 255 (Së pari 246 + 10 = 256, pastaj 256 – 1 = 255)

1 **Plotësoje tabelën.**

+	11	31	49	51	29
646					
483					
739					

2 **Duke rrumbullakuar njërin mbledhës në qindëshe të plotë ose mijëshe njehso shumat:**

a) 3 356 + 109 = (3 356 + 100) + 9 =

b) 6 559 + 298 = (6 559 + 300) – 2 =

c) 29 997 + 2 379 =

ç) 179 990 + 280 715 =

d) 850 354 + 100 020=

dh) 100 003 + 180 814 =

Edhe tek operacioni zbritje, caktimin e ndryshimit përmendësh, të zbritshmin ose zbritësin mund t'i rrumbullakojmë deri te dhjetëshja, qindëshja, mijëshja ose dhjetë mijëshja më e afërt. Për të shtuar 9 ndonjë numri, shto 10, pra zbrit 1.

Për të **zbritur** 11 prej ndonjë numri, **zbrit** 10, pra **zbrit** 1

Shembull: 627 – 11 = 616 (Së pari 627 – 10 = 617, pastaj 617 – 1 = 616)

3 **Plotësoje tabelën**

–	102	298	1 005	998
5 489				
16530				
178137				

4 **Caktoji dhe lidhi të dy çiftet e numrave me:**

a) shuma më e madhe çift
b) shuma më e vogël tek
c) shuma më afër deri te 1 000 000

147 801	150 703
35 902	380 455
600 335	17 483
192 679	80 901
836 702	478 580



Tema 3

MBLEDHJA E NUMRAVE DERI 1 000 000 PA KALIM

Të përkujtojmë!

Gjatë mbledhjes me shkrim numrat shumëshifrorë, të shkruar në **shtyllë njëri nën tjetrin**, është e rëndësishme: SHIFRAT E KLASËS SË NJËJTË I SHKRUAJMË NJËRA NËN TJETRËN. Mbledhja kryhet duke filluar prej klasës së njësheve.

Komponentët gjatë mbledhjes

Mbledhës → 25 354
Mbledhës → + 31 521
Shuma → 56 875

1 **Njehso shumat.**

a) 4 000 + 8
b) 36 204 + 84
c) 49 000 + 125
d) 319 000 + 114
dh) 240 000 + 3 114

2 **Cakto shumat, pasi që të kesh radhitur mbledhësit njëri nën tjetrin.**

a) 5 700 + 2 000
4 000 + 265

b) 3 410 + 2 068
5 261 + 3 425

c) 715 245 + 261 322
807 426 + 191252

3 **Biletat për një garë futbolli janë shitur për dy ditë. Ditën e parë janë shitur 22 400 bileta, por ditën e dytë për 12 350 bileta më shumë. Sa bileta gjithsej janë shitur për garën e futbollit?**

4 **Njehso shumën në vendin e pikëpyetjeve.**

a) 220 362 + 145 426 = ?

b) 375 436 + 221 341 = ?





5 **Jani shokut të tij i ka dhënë adresën e tij. Jetoj në bulevardin „Drini“. Numrin e ndërtesës në të cilën jetoj do ta zbulosh nëse mbledh numrat treshifrorë fqinjë, prej të cilëve njëri ka dy nëntëshe, tjetri dy zero, por i treti tri shifra të ndryshme shuma e të cilave është 3.**

Jani a i ka dhënë shokut të dhëna të mjaftueshme?



6 **Shkruaj shifra që shuma të jetë e saktë.**

a)

....
+ ....
8 0 1

b)

.... 1
+ ..... 0 .....
1 ....

7 **Shumën e numrave 20 450 dhe 120 000, zmadhoje për numrin më të vogël gjashtëshifror.**

8 **Njehso dhe plotëso**

6	□	2	8
+ □	1	□	□
8	4	7	8

7	2	4	1
+ □	□	□	□
9	9	9	9

1	5	□	3
+ 3	□	1	□
□	5	9	7



ZBRITJA E NUMRAVE DERI 1 000 000 PA KALIM

Të përkujtojmë!

Gjatë zbritjes me shkrim numrat shumëshifrorë, të shkruar në shtyllë njëri nën tjetrin, është e rëndësishme:

SHIFRAT PREJ KLASËS SË NJËJTË I SHKRUAJMË NJËRA NËN TJETRËN.

Zbritja kryhet duke filluar prej klasës së njësheve.

Komponentët gjatë zbritjes I zbritshmi

Zbritësi → 59 867
Zbritësi → – 26 123
Ndryshimi → 33 744

Zbritja është operacion i kundërt ose invers i mbledhjes

1 **Njehso sipas shembullit.**

8 000	3 000
5 000	

90000	60000

700000	400000

600000	200000

2 **Njehso ndryshimet.**

a) 9 017 – 7

b) 45 369 – 54

c) 156 124 – 113

ç) 275 684 – 3 271

3 **Njehso ndryshimet dhe bëj kontrollë me mbledhje.**

a) 86 539 – 32 108 +

b) 76 325 – 1 114 +

c) 387 654 – 242 213 +

ç) 275 684 – 172 243 +

4 **Gjeji ndryshimet pasi që të caktosh numrat njërin nën tjetrin.**

a) 356 821 – 41 200
124 531 – 12311

b) 622 897 – 1 356
456 318 – 2 107

c) 399 072 – 4 001
275 683 – 32683

5 Njehso ndryshimin, nëse i zbritshmi është 75 844, kurse zbritësi 42 512

6 Në një pyll ka pasur 280 990 drunj. Në vjeshtë janë prerë 80 000 dru të njomë, por në pranverë janë mbjellë 40 000 drunj të rinj. Sa gjithsej drunj ka pasur në pyll verës?



7 Cili numër do të fitohet nëse shuma e numrave 322 143 dhe 265 435 zvogëlohet për 225 144?

8 Formo detyrë, krahaso të dhënat dhe zgjidhe.





Tema 3

MBLEDHJA E NUMRAVE DERI 1 000 000 ME KALIM STRATEGJI PËR MBLEDHJE

STRATEGJIA PËR MBLEDHJA

Gjatë mbledhjes me shkrim të numrave shumëshifrorë, të shkruar në **shtyllë njëri nën tjetrin**, është e rëndësishme:

SHIFRAT PREJ KLASËS SË NJËJTË I SHKRUAJMË NJËRA NËN TJETRËN.

Mbledhja kryhet duke filluar prej klasës së njësheve dhe kalimi shkruhet mbi numrin e parë.

Shembull:
Njehso shumën
47 586 + 28342

	DHM	M	Q	DH	NJ
	4	7	5	8	6
+	2	8	3	4	2
	1 ←	①5	1 ←	①2	
	7	5	9	2	8

$$\begin{array}{r} {\scriptstyle 1\ \ 1\ \ } \\ 47\,586 \\ +\ \ 28\,342 \\ \hline 75\,928 \end{array}$$

1 **Njehso shumat sipas shembullit.**

Mbledhësi	298 153	14 486	3 809	6 074	356 420
Mbledhësi	411 108	8 063	14031	1 868	200 390
Mbledhësi	160 490	1 402	5 120	9 400	81 030
Shuma					

2 **Cili numër është për 23 500 më i madh se 145 600?**

3 **Njehso shumën nëse njëri mbledhës është 29 780, por mbledhësi tjetër është mbledhësi i parë i rrumbullakuar në qindëshe**

Mbledhja me zbërthim

```
    4 578
+   2 349
-------
    6000
     800
     110
+     17
-------
    6927
```

4 **Njehso shumat sipas shembullit, me zbërthim.**

a) 248 657 + 382 938

b) 448 775 + 383 686

c) 368 049 + 485 668

ç) 529 380 + 265 745

5 **Numrit 39 801 shtoji paraardhësin e numrit 61 400**

Mbledhja duke shkruar në formën e zbërthyer

4 578 + 2 349 =
(4 000 + 500 + 70 + 8) + (2 000 + 300 +40 +9) =
(4 000+2 000) + (500+300) + (70+40) + (8 + 9) =
6 000 + 800 +110 +17 = 6 927

6 **Njehso shumat sipas shembullit, duke shkruar në formën e zbërthyer.**

a) 35 600 + 46 130 =

b) 150 769 + 340659 =

c) 377 881 + 209 819 =

ç) 90789 + 43 259 =

d) 204 507 + 189 033 =

7 **Njehso shumat me strategjinë që e ke më të lehtë.**

a) 12 400 + 79 709

b) 57 800 + 98 208

c) 371 200 + 209 981

ç) 190 801 + 89 299

8 **Shumës së numrave 212 350 dhe 23 760 shto numrin më të vogël pesëshifror.**

Paraqitja e mbledhësve me vlerën vendore

4 578 + 2 349 =

$$\begin{array}{l} (4 \cdot 1\,000 + 5 \cdot 100 + 7 \cdot 10 + 8 \cdot 1) \\ + \ (2 \cdot 1\,000 + 3 \cdot 100 + 4 \cdot 10 + 9 \cdot 1) \\ \hline 8 \cdot 1\,000 + 8 \cdot 100 + 11 \cdot 10 + 17 \cdot 1 = \_\_\_\_\_ \end{array}$$

9 **Njehso.**

+		+		+		+	
27453	8 263	476328	205402	326795	80012	2 389	359040

10 **Prej shifrave 4, 6 2, 9 dhe 0 formo numra pesëshifrorë (shifrat shfrytëzoji vetëm njëherë) dhe njehso shumat me paraqitjen e mbledhësve me vlerë vendore. Shkruaj disa barazime.**

11 **Mbledhësi i parë është numri katërshifror më i madh, mbledhësi tjetër është 5 986, por i treti është i barabartë me shumën e numrit më të madh treshifror dhe pasardhësi i numrit 9 980. Njehso shumën e këtyre tre mbledhësve.**

Tema 3

ZBRITJA E NUMRAVE DERI 1 000 000 ME KALIM STRATEGJITË PËR ZBRITJEN

STRATEGJIA PËR MBLEDHJA

Gjatë zbritjes me shkrim numër shumëshifror, të shkruar në shtyllë njëri nën tjetrin, është e rëndësishme:

SHIFRAT PREJ KLASËS SË NJËJTË I SHKRUAJMË NJËRA NËN TJETRËN."

Zbritja kryhet duke filluar prej klasës së njësheve. Zbriten numrat prej klasës së njëjtë.

Shembull:

Njehso ndryshimin e numrave 72 586 dhe 38 258.

QM	DHM	M	Q	DH	NJ
	6 ~~7~~	12 ~~2~~	5	7 ~~8~~	16 ~~6~~
–	3	8	2	5	8
	3	4	3	2	8

$$\begin{array}{r} 72\,586 \\ -\ 38\,358 \\ \hline 34\,328 \end{array}$$

1 Njehso ndryshimet sipas shembullit.

a) $\begin{array}{r} 426\,572 \\ -\ 158\,436 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 847\,362 \\ -\ 263\,582 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 530\,891 \\ -\ 367\,243 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 459\,812 \\ -\ 367\,700 \\ \hline \end{array}$ d) $\begin{array}{r} 999\,137 \\ -\ 278\,900 \\ \hline \end{array}$

2 **Njehso.**

362 537	56 218	426 036	81 506	207 486	35 235	259 049	134 208
–		–		–		–	

1	90	90	90	90	90	100
– 5	7	2	1	1	4	
4	2	7	8	8	6	

3 **Njehso ndryshimin.**

a) $\begin{array}{r} 400\,000 \\ -\ 126\,230 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 800\,000 \\ -\ 782\,814 \\ \hline \end{array}$

c) $\begin{array}{r} 300\,000 \\ -\ 45\,870 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 400\,000 \\ -\ 126\,230 \\ \hline \end{array}$ d) $\begin{array}{r} 800\,000 \\ -\ 782\,814 \\ \hline \end{array}$

Duke shkruar në formën e zbërthyer

6 920 – 510 =
(6 000 +900 + 20) – (500 + 10)=
6 000 + (900 – 500) + (20 – 10) =
6 000 + 400 + 10 = 6 410

4 **Prej shifrave 4, 7, 8, 5, 3 dhe 0 shkruaj numrin më të vogël dhe më të madh gjashtëshifror dhe njehso ndryshimin e tyre. Shifrat shfrytëzoji vetëm njëherë.**

Zbritja me zbërthim

6 920 – 510 =

$$\begin{array}{r} 6\,000 + 900 + 20 \\ -\quad 500 + 10 \\ \hline 6\,000 + 400 + 10 \end{array}$$

5 **Për sa është më i madh numri 41 703 prej numrit të përbërë prej shifrave të njëjtë vetëm në renditjen e anasjelltë?**

6 **I zbritshmi është 824 por zbritësi 100, është 345 600.**

- **Saështë ndryshimi?**
- **Saështë ndryshimi nëse prej të zbritshmit zbritet numri 156 250?**

7 **Ndryshimin e numrave 125 600 dhe 45 371 zvogëloje për 34 902.**

Kontrollohemi, ushtrojmë

Zbritja me zbërthim

680 020 – (240 370 + 126 860) =

458 332 – (183 664 – 75 189) =

Zbritja me zbërthim

(179 248 + 141 630) – 131 345 =

(156 413 + 452 146) – 129 215 =

832 459 – (321 576 – 279 203) =

624 748 – (159 200 + 89 311) =

Cili numër duhet t'i shtohet numrit 226 348 që të ketë

a) një kalim në klasën e njësheve;

b) dy kalime në klasën e dhjetësheve.

Njehso

(98 426 – 98 426) + 98 426 =

279 675 + (279 675 – 279 675) =

(37 856 + 9 720) – 9 720 =

(18 328 + 4 356) – 4 356 =

(500 000 + 8 590) – 500 000 =

(26 815 – 26 815) + 395 =

Në një shitore çmimi i një pale patikave është 3 690 denarë, të një fustani është 7 140 denarë, por të një marame është për 1 700 denarë më e lire se patikat, Njehso vlerën e përgjithshme të të tre artikujve.

Plotësoje tabelën sipas kërkesës m = 15 900

a	9 842	16 864	158 270	709 143
a + m				

VETIA KOMUJTATIVE E MBLEDHJES

Njehso shumat: 23 500 dhe 54 000 dhe 54 000 dhe 23 500, kurse pastaj krahasoji.

Çka vëren? Si janë shumat ndërmjet veti? Pse janë të njëjta?

23 500 + 54 000 = 77 500

54 000 + 23 500 = 77 500

23 500 + 54 000 = 54 000 + 23 500

Gjatë operacionit të mbledhjes, nëse mbledhësit i ndërrojnë vendet, shuma nuk ndryshon. Kjo është vetia komutative e mbledhjes!

	Vetia komutative
Mbledhja	vlen $a + b = b + a$
Zbritja	vlen pasi $24 - 6 \neq 6 - 24$

1 **Cili numër duhet të qëndrojë në vendin e zbrazët që të jetë e saktë?**

a) 32 654 + 71 126 = _____ + 32 654

b) 425 300 + 248 300 = 248 300 + _____

c) 267 000 + _____ = 28 000 + _____

2 **Njehso duke zbatuar vetinë komutative**

a	b	$a + b =$ _____	$b + a =$ _____
1 200	4 500	1 200 + 4 500 = 5 700	4 500 + 1 200 = 5 700
631	349		
999	1		
78	902		

VETIA ASOCIATIVE E MBLEDHJES

Luka dhe Edo kanë zgjidhur detyra.
Shprehjen numerike: 32 000 + 18 000 + 42 000 e kanë zgjidhur në mënyra të ndryshme, por shumën e kanë fituar të njëjtë. Pse?

Luka → (32 000 + 18 000) + 42 000 = 50 000 + 42 000 = 92 000

Edo → 32 000 + (18 000 + 42 000) = 32 000 + 60 000 = 92 000

Gjatë operacionit të mbledhjes, nëse mbledhësit grupohen në mënyra te ndryshme, shuma nuk ndryshon. Kjo është vetia asociative e mbledhjes.

	Vetia asociative
Mbledhja	vlen: (a + b) + c = a + (b + c)
Zbritja	nuk vlen, pasi (24 – 4) – 2 ≠24 – (4 – 2)

1 **Cili numër duhet të qëdrojë në vendin a, që të jetë e saktë**

a) (2 583 + 3 328) + 4 125 = 2 583 + (a + 4 125)
b) (16 384 + 32 450) + 26 384 = 16 384 + (32 450 + a)
c) (75 340 + a) + 23 840=75 340 + (36 600 + 23 840)

2 **Duke zbatuar vetitë për mbledhje në mënyrë më të përshtatshme njehso:**

a) 5 250 + 6 739 + 4 750 = (5 250 + 4 750) + _____=
b) 20 999 + 17 856 + 60 001 =
c) 88 882 + 88 884 + 88 886 + 11 114 + 11 116 + 11 118 =

3 **Me grupimin e mbledhësve, njehso shumën e:**

a) numrat e dhjetëshes së dytë
b) numrat tek më të vegjël se 20

4 **Nëse e di se 428 + 5 642 = 6 070, atëherë cakto x në këto barazime:**

a) (428 + 528) + 5 642 = 6 070 + x

b) (428 +500) + (5 642 – 400) = 6 070 + x

c) (428 + x) + 5 642 = 6 080

ç) (428 – 100) + (5 642 – 200) = 6 080 – x

5 **Me zëvendësimin e mbledhësve dhe grupimin e mbledhësve njehso:**

a) 30 000 + 350 + 250 + 750 =

b) 40 000 + 460 + 26000 + 540 + 4 000 =

c) 650 + 10 000 + 30 000 + 350 =

ç) 150 + 20 000 + 250 + 350 =

6 **Njehso në mënyrë më të lehtë**

a) 350 + 197 + 50 = _____

b) 64 + 152 +136 = _____

c) 217 + 69 + 83 + 431 = _____

ç) 353 + 87 + 80 = _____

d) 527 + 49 + 43 + 21 = _____

dh) 65 + 850 + 825 = _____

CAKTIMI I MBLEDHËSIT TË PANJOHUR; TË ZBRITSHIM DHE ZBRITËSIN

Shembull:

Cili numër duhet t'i shtohet numrit 12 174 që të fitohet numri 21 749?



12 174 + x = 21 749
x = 21 749 – 12 174
x = 9 575

Kontrolli:
12 174 + 9 575 = 21 749

Si do të veprojmë nëse e kemi mbledhësin e panjohur, por e dimë shumën?

Mbledhësi i panjohur gjendet nëse prej shumës zbritet mbledhësi i njohur.

1 **Cakto mbledhësin e panjohur?**

a) x + 165 290 = 860 800
x =
x =

Kontrolli:

b) 245 790 + x = 375 290
x =
x =

Kontrolli:

c) x + 96 548 = 405 278
x =
x =

Kontrolli:

ç) 384 795 + x = 142 600 + 570 898
x =
x =

Kontrolli:

2 **Safet ka menduar një numër. Kur ndaj atij numri e ka shtuar numrin 150 400 dhe e ka fituar numrin 350 600. Cilin numër e ka menduar Safet?**

3 **Një mbledhës është shuma e numrave 403 856 dhe 296 544, por shuma është numri më i madh gjashtëshifror. Sa është mbledhësi tjetër?**

4 **Moni prej babait ka marrë 12 000 denarë, por prej nënës 12 500 denarë. Sa denarë ka pasur Moni në fillim, nëse tani ka 100 000 denarë?**

Shembull:

Prej cilit numër do të zbritet numri 1 456 që të fitohet numri 86524



x – 1 456 = 86 524
x = 86 524 + 1 456
x = 87 980

kontrolli
87 980 – 1 456 = 86 524

Si do të veprojmë nëse e kemi të njohur të zbritshmin, kurse ndryshimi dhe zbritësi janë të njohur?

I zbritshmi i panjohur gjendet nëse ndryshimi mblidhet me zbritësin.

5 **Cakto numrin e panjohur.**

a) x – 334 556 = 167 760
x =
x =

Kontrolli:

b) x – 125 673 = 98 570
x =
x =

Kontrolli:

c) x – 35 284 = 44 716
x =
x =

Kontrolli:

ç) x – 399 999 = 1
x =
x =

Kontrolli:

6 **Prej cilit numër duhet të zbritet numri 224 690, që të fitohet numri 100 000?**

7 **Cakto numrin e panjohur.Formo detyrë tekstuale e cila zgjidhet me shprehjen numerike x – 512 000 = 398 000.**

8 **Sa është i zbritshmi, nëse zbritësi është 215 859, kurse ndryshimi është 79 555?**

9 **Për cilin numër duhet të zvogëlohet shuma e numrave 35 689 dhe 57 120 që të fitohet numri 99670?**

Shembull:

Cili numër duhet të zbritet prej numrit 214 562 që të fitohet numri 7 426?



214 562 – x = 7 426
x = 214 562 – 7 426
x = 207 136

Kontrolli:
214 562 – 7 426 = 207 136

Si do të veprojmë nëse e kemi të njohur të zbritshmin, kurse ndryshimi dhe zbritësi janë të njohur?

Zbritësi i panjohur gjendet nëse ndryshimi zbritet me ndryshimin.

5 **Njehso zbritësin e panjohur:**

a) 880 120 – x = 598 670
x =
x =

Kontrolli:

b) 1 000 000 – x = 560 900
x =
x =

Kontrolli:

c) 420 000 – x = 156 384 + 98 379
x =
x =

Kontrolli:

ç) 439 800 – x = 100 500 + 45 690
x =
x =

Kontrolli:

6 **I zbritshmi është 90 000, kurse ndryshimi është 15 721. Sa është zbritësi?**

7 **Formo detyrë tekstuale sipas shprehjes numerike: 859 000 – x = 374 900.**

Tema 3

VLERËSIMI I VLERËS SË SHUMËS OSE NDRYSHIMIT DHE KONTROLLIT

Vlerësimi paraqet gjetjen e përgjigjes që është mjaft afër deri te përgjigja e saktë.
Bërja e kontrollit është e dobishme dhe argëtuese.

Vlerëso!

- Sa hapa ka prej shtëpisë tuaj deri në shkollë?
- Sa shokë do të takosh në rrugë?
- Sa minuta do të jetë kthimi deri në shtëpi?

Për numra të ndryshëm janë të nevojshme mënyra të ndryshme të të menduarit gjatë kontrollit.

Të vlerësojmë!

Sa është shuma e numrave 540 dhe 198?

Pasi 198 është afër 200, do t'i mbledhim 540 + 200 = 740

Vlerësimi është afër 740.

Njehso dhe kontrollo sa shmangemi prej vlerësimit

1 **Të vlerësojmë! Sa është shuma?**

515 + 589 + 523 + 566 + 592 =

Kur mbledhim më shumë numra të ngjashëm mund të marrim ndonjë mes të atyre numrave dhe e shumëzojmë me numrin e mbledhësve.

Mesi i mbledhësve është 550. $550 \cdot 5 = 2\,750$

Kontrollo sa shmangemi prej vlerësimit

2 **Të vlerësojmë! Sa është ndryshimi i numrave 650 dhe 202?**

Pasi 202 është afër deri te 200, do t'i zbresim 650 – 200 = 450

Vlerësimi është afër 450.

Njehso dhe kontrollo sa shmangemi prej vlerësimit.

3 **Vlerëso shumën, e pastaj njehso dhe kontrollo vlerësimin.**

a) 4 590 + 3 951 + 4 280 + 4 100 + 3 789 + 4 001 =

b) 27 000 + 35 000 + 29 000 + 32 000 +28 500 + 31 500 =

c) 58 000 – 1 998 – 2 019 =

4 **Arzija ka pasur banknotë prej 1 000 denarë. Ka dashur të blejë vathëtë cilët kushtojnë 245 denarë, bluzë që kushton 492 denarë, çorape 184 denarë dhe shnolla për 105 denarë. Vlerëso, e pastaj njehso saktë se Arzija a ka mjaft para të blejë gjithçka që dëshiron?Sa denarë i mungojnë ose sa denarë do t'i ngelin?**

5 **Vlerëso vlerën e shumave. Cila shumë ka vlerë më të madhe dhe është më afër deri në një milion, kurse cila ka vlerë më të vogël. Bëj vlerësim edhe për ndryshimin. Në cilën shtyllë ndryshimi ndërmjet të zbritshmit dhe zbritësit është më i madh.**

Njehso shumën dhe ndryshimin dhe kontrollo vlerësimin tënd

Mbledhësi	30 798	25 438	685 079
Mbledhësi	663 122	34 549	314 768
Shuma			

Zbritësi	98 456	156 894	900 804
Zbritësi	32 175	34 799	800 149
Ndryshimi			

ZGJIDHJA E DETYRAVE ME SHFRYTËZIMIN E OPERACIONEVE MBLEDHJE DHE ZBRITJE

1 **Shkruaje shenjën për mbledhje dhe zbritje ndërmjet numrave që shprehja numerike të jetë e saktë.**

1 027		301		400		374	=	1 500

2 **Njehso:**

80 998 + 1 002		?
+	+	+
? + 3 934		?
? + ?		87 254

78 684 + 37 935		?
−	−	−
? − 4 570		364
? − ?		?

? + 18 945		95 476
+	+	+
? + 2 112		4 251
? + ?		?

3 **Cakto numrin në vend të pikëpyetjes dhe shifrat në vend të pikave.**





8 _ 6 _ 3
− _ 5 _ 6 1
3 5 6 6 2

7 _ _ 4 3
− 2 6 7 _ _
_ 9 4 0 7

9 _ 3 _ 9
− _ 5 _ 4 7
_ _ 1 0 _

4 **Cili numër do të fitohet nëse prej numrit 200 000 zbritet ndryshimi i numrave 456 900 dhe 310 089.**

5 **I zbritshmi është shuma e numrave 47 336 dhe 489 621, por zbritësi është ndryshimi i numrave 780 130 dhe 570 900. Njehso ndryshimin.**

6 Jovani ka menduar një numër. Kur ndaj atij numri e shton ndryshimin e numrave 127 203 dhe 94 856, e ka fituar numrin 360 000. Cilin numër e ka menduar Jovani?

7 Ndryshimin e numrave 951 247 dhe 489 009 zvogëloje për ndryshimin e numrave 135 600 dhe 35 600. Cilin numër e ka fituar?

8 Shuma e tre numrave është 100 000. Numri i parë është 36 845, numri i dytë është për 8 888 më i madh se i pari. Njehso numrin e tretë.

9 Jetoni i ka zbritur numrat 306 dhe 297, por Mentori e ka zbritur numrin 593 prej ndonjë numri. Poashtu e kanë fituar ndryshimin e njëjtë. Prej cilit numër Mentori e ka zbritur numrin 593.

11 Në kopshtin e pemëve gjyshi Branko ka mbjellë fidanë mollë, dardha, pjeshka dhe kumbulla, gjithsej 772 drunj. Ka pasur 263 fidanë mollë, 147 fidanë dardha më pak se fidanë mollë, por 56 fidanë pjeshka më pak se dardha. Sa fidanë kumbulla ka mbjellë gjyshi Branko?

12 Në një shitore për pajisje sportive ka pasur 36 140 rekuizita. Prej tyre gjysma kanë qenë topa, litarë ka pasur për 1 000 më shumë se topa, kurse të tjerat kanë qenë unaza. Sa unaza ka pasur në shitoren sportive?



13 **Katrori i dhënë është magjik. Plotësoje katrorin e dytë, ashtu që çdo numër prej katrorit të parë të zvogëlohet për 88. Kontrollo sekatrori a është magjik.**

145	178	127
132	150	168
173	122	155

14 **Formo detyrë sipas të dhë nave**

Java e parë – 71 300
Java e dytë – për – за 1 200 më shumë se
Java e tretë – për – за 2 400 më pak se

15 **Njehso:**

7 ☐ 5	–	5 ★ ●	=	● 5 ⬢
+		+		+
★ ● ☐	–	☐ 4	=	☐ ●
=		=		=
8 9 ★	–	5 7 ☐	=	⬢ ★ 5

SHUMËFISHAT DHE PJESËTUESIT E NUMRAVE DERI 1 000

Njehso përmendësh 10 prodhimet e para të numrave 2, 3, 4 dhe 5 dhe shkruaji te ret

2	3	4	5
2 4			

Prodhimet të cilat i shkruajte te retë themi se janë shumëfisha të 2, 3, 4 dhe 5.

është shumëfish i 2 pasi që 12 = 2·6. Numri 12 është **shumëfish** i numrit 6.

Vërejte se numri **20** është shumëfish i numrave 2, 4 dhe 5 njëkohësisht.

Numri 35 është shumëfish i numrave 3 dhe 5.

Për këta numra themi se janë shumëfisha të **tyre të përbashkët.**

Një numër ka shumë shumëfisha, mund të formohet vargu prej shumëfishave të numrit a sipas rregullës: a, 2a, 3a, 4a,... na, ...

1 Shkruaji shumëfishat e 2, 3, 4 dhe 5 që gjenden ndërmjet numrave 28 dhe 50.

Numri 30 i cilëve numra është shumëfish i përbashkët?

Gjeji 3 shumëfishat e përbashkët të numrave 2, 3, 4 dhe 5.

numri	Shumëfish i 2	Shumëfish i 3	Shumëfish i 4	Shumëfish i 5
12				
24				
35				
60				
100				

Shënoje me √ fushën që i përgjigjet çdonjërit prej numrave në tabelë.

SHUMËFISHAT E 6, 7, 8, 9 DHE 10

Njehsoji përmendësh 10 prodhimet e para të numrave 6, 7, 8, 9 dhe 10 dhe shkruajl te retë.

6 7 8 9 10

2 Shkruaji shumëfishat e 6, 7, 8, 9 dhe 10 që gjenden ndërmjet numrave 60 dhe 120.

Gjej shumëfishat e përbashkët të numrave 6 dhe 8.

Gjeji 5 shumëfishat e parë të përbashkët të numrave 7 dhe 9. Cili numër (6, 7, 8, 9 ose 10) ka shumëfishë të përbashkët me të gjithë numrat?

SHUMËFISHAT E 20, 25, 50 DHE 100

Njehso 5 shumëfishat e parë të përbashkët të numrave 20, 25, 50 dhe 100 dhe shkruaj te shigjetat.

20 25 50 100

3 Shkruaji shumëfishat e 20, 25, 50 dhe 100 që gjenden ndërmjet numrave 130 dhe 260.

Gjeji tre shumëfishat e parë të përbashkët të 20, 25 dhe 50.

Cili prej numrave 20, 25 ose 50 është shumëfish i dy numrave tjerë.

Shkruaji shumëfishat e 100 që janë më të vegjël se 1 000.

Cili është shumëfishi më i vogël i numrave 10, 100.

Gjeji tre shumëfisha të përbashkët të numrave 10 dhe 100..

SFIDË

Cili është shumëfishi i vogël i numrit 50 shuma e shifrave të të cilit është 8.

4 Shkruaji 10 shumëfishat e parë të numrave 5 dhe 25, kurse pastaj cakto shumëfishat e përbashkët. Pastaj paraqiti të dhënat me diagram të Venit.



5 **Diskuto këto pyetje në grup:**

Të gjithë shumëfishat e 5 a janë edhe shumëfishat e 10? Pse?
Pse të gjitha shumëfishat e 2 janë edhe shumëfisha të 4?
Të gjithë shumëfishat e 100 a janë edhe shumëfishat e 10? Pse?
A ekziston shumëfishë më i madh të një numri?
Cili është shumëfishi më i vogël i një numri?

6 Radhiti drejt numrat te kavanozët, ashtu që çdo kavanoz të jetë shumëfish i numrit që është shënuar me numër te kavanozi.



7 **a) Rretho numrat që janë shumëfisha të 2.**

18 22 33 54 121 98 27 90

b) Rretho numrat që janë shumëfisha të 5.

80 202 35 355 20 670 72 190

c) Rretho numrat që janë njëkohësisht shumëfisha të 2 dhe të 10

25 20 90 485 70 62 78 290

GJETJA E SHUMËFISHAVE TË NUMRAVE DYSHIFRORË DERI 1 000

Shkruaji katër shumëfishat e përbashkët të numrit 11.



Numrat 11, 22, 33 dhe 44 janë shumëfisha të numrit 11.
Shumëfishat e 11 nuk mbarojnë me 44.
Mund të vazhdojmë vargun dhe të gjejmë të tjerë.
5 · 11 = 55
55 është shumëfishi i pestë i numrit 11. 10 · 11 = 110
110 është shumëfishi i dhjetë i numrit 11.

Shkruaj pesë shumëfisha të numrave

18 _____ _____ _____

35 _____ _____ _____

24 _____ _____ _____

Radhiti këta numra në vendet përkatëse te diagram i Venit: 130, 125, 250, 338, 65, 750, 117, 1 000, 325, 650,



1 Gjej tre shumëfisha të numrave 14, 28 dhe 32

Njehso:

2 a) shumëfishin e gjashtë të numrit 23
b) shumëfishin e tretë të numrit 47
c) shumëfishin e katërt të numrit 84

CAKTIMI I NUMRAVE TË PLOTPJESËTUESHËM ME 2, 5, 10 DHE 100 DERI 1 000

Te tabela janë paraqitur të gjithë numrat të cilët janë pjesëtues të numrit 12.

12	
1	12
2	6
3	4

Numri që pjesëtohet me tjetër numër pa mbetje quhet **pjesëtues** i atij numri.
Për të konstatuar se një numër plotpjesëtohet me numër tjetër, a mjafton të caktosh herësin e tyre.

Cakto të gjithë pjesëtuesit te 30.

1 • 30 = 30 Fillojmë me 1 pasi 1 është pjesëtues i çdo numri.
2 • 15 = 30 30 është numër çift, pra 2 është pjesëtues i atij.
3 • 10 = 30 Pastaj përpiqemi me 3.
5 • 6 = 30 nuk është pjesëtues, pra përpiqemi me 5.
Numri tjetër është 6, por atë tanimë e kemi.

Pjesëtues të 30 janë: 1, 2, 3, 5, 6, 10, 15 dhe 30.

Pjesëtues të 12 janë: 1, 2, 3, 4, 6 dhe 12
Pjesëtues të 30 janë: 1, 2, 3, 5, 6, 10, 15 dhe 60
Pjesëtues të përbashkët janë numrat: 1, 2, 3 dhe 6.

Numri natyror a është pjesëtues i numrit natyror **b**, ose **a** plotpjesëtohet me **b**, nëse mbetja gjatë pjesëtimit është 0.

10: 5 = 2 10 = 5 • 2

5 është pjesëtues i 10 **Shkruajmë: 5 I 10** **Lexojmë: 5 është pjesëtues i 10.**

Nëse a nuk është pjesëtues i **b** shkruajmë:a ∤b.

3∤10 10 Lexojmë: 3 nuk është pjesëtues i 10.

Të gjithë numrat çift plotpjesëtohen me 2. Shifra e fundit e numrit çift është 0, 2, 4, 6 dhe 8.
Numri plotpjesëtohet me 5 nëse shifra e fundit është 5 ose 0.
Numri plotpjesëtohet me 10 nëse shifra e fundit është 0.
Numri plotpjesëtohet me 100 nëse dy shifrat e fundit janë 00.

3 Tema

Shumëfishat e 25 janë 25, 50, 75, 100, 125, 150...
Pjesëtuesi te 25 janë 1, 5, 25 Gjej pjesëtuesi te këtyre numrave.



1. A kanë pjesëtues të përbashkët?
a) 12 b) 8 c) 16 ç) 25 d) 100

2. Cili prej numrave 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 janë pjesëtues të 42?

3. Shkruaj dy pjesëtues të 24, shuma e të cilit është 11.

4. Pjesëtues të përbashkët të numrave 12 dhe 24 është numri 2. Shkruaj 2 numra të tjerë më të mëdhenj se 1, por të cilët janë pjesëtues të 12 dhe 24.

5. Provo cili prej numrave: 13, 24, 15, 57, 155, 850 dhe 1 000 është:
a) i plotpjesëtueshëm me 2 b) i plotpjesëtueshëm me 5 c) i plotpjesëtueshëm me 2 dhe me 5.

6. Gjej pjesëtuesi te përbashkët të numrave.

24	

40	

100	

Me ndihmën e tabelave cakto shumëfishat e përbashkët të numrave:
a) 24 dhe 40
b) 40 dhe 100

INDICET PËR PLOTPJESËTUESHMËRINË ME 2, 5, 10 DHE 100 DHE ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE

1. A mund t'u ndahen 22 ngjyra druri dhe 38 lapsa:
a) 4 nxënësve b) 6 nxënësve c) 9 nxënësve

2. Zëvendësoje yllzin me shifër, ashtu që numri i fituar të plotpjesëtohet me 5.
a) 4* b) 1*5 c) 2*0 ç) 7*

3. Cili prej këtyre ndryshimeve dhe shumave plotpjesëtohen me 4:
a) 789 – 36 b) 628 – 90 c) 212 + 36 ç) 342 + 164

4. Cili prej këtyre numrave janë pjesëtues të 30: 4, 5, 6, 10, 1, 20, 60, 30, 2

5. Për numrat e dhënë gjej pjesëtuesin e përbashkët më të madh se
1. a) 6 I 8 b) 10 I 100 c) 5, 4 I 8 ç) 12, 20 I 42

6. Martina ka sjellë bonbone në shkollë dhe ka planifikuar t'ua ndajë shoqeve të saja. Kur ka menduar se si t'i ndajë në 4, 5 ose 6 shoqeve të saja, gjithmonë i ka ngelur nga një bonbon. Sa më së paku bonbone ka pasur Martina ?

7. Cakto:
a) numrin më të vogël treshifror që plotpjesëtohet me 2 dhe me 5.
b) numrin më të madh treshifror që plotpjesëtohet me 100.

8. Onegu ka luajtur me kube dhe mund t'i radhitë nga 10 ose nga 25 në radhë. Sa kube ka Onegu, nëse dihet se ka më shumë se 1 250, por më pak se 1 350 kube?

Të përkujtojmë!

Njehso sa peshq ka në akuariumet?



Njehsojmë: 7 + 7 + 7 + 7 = 28

Këtë shumë mund ta paraqesim më shkurt në këtë mënyrë:

4 • 7 = 28 prodhimi

shumëzues

shumëzues

shenja për shumëzim

Mbledhja e mbledhësve të barabartë quhet **shumëzim.** Shumëzimi do të thotë „herë“ ose „nga“. Numrat që i shumëzojmë quhen **shumëzues**

Kur shumëzojmë dy numra fitojmë numër që është shumëfish i tyre.
Kështu, te shumëzimi 4 • 7 = 28, numri 28 është shumëfish i 4 dhe shumëfish i 7.
Prodhimin e quajmë rezultat të fituar gjatë operacionit të shumëzimit të dy ose më shumë numrave.

1 **Njehso prodhimet.**

	90		600	
50		400		1 000

• 1

90	30	500	400	1 000

• 0

Kur një shumëzues është numri 1, atëherë prodhimi është i barabartë me shumëzuesin tjetër.

Kur njëri shumëzues është numri 0, atëherë prodhimi është i barabartë me 0.



2 **Njehso:**

a) 60 · 1 + 12 = ☐ b) 400 · 1 +364 = ☐ c) (525 + 475) · 1 = ☐

42 - 90 · 0 = ☐ 746 - 0 · 800 = ☐ 0 · (256 - 156) = ☐

Shfrytëzo sistemin kënddrejtë prej 20 katrorëve për të shkruar të gjitha kombinimet e mundshme të shumëzuesve.

____ • __ = 20 ___• ___=20 ____• ___ = 20

Në fletore vizatoi të gjithë drejtkëndëshat që mund të bëhen me 32 katror. Për çdo vizatim shkruaj shprehje numerike me shumëzues dhe operacionin e shumëzimit.

3 Jovani dhe Esma e kanë njehsuar numrin e topave në vizatim. Kanë njehsuar në mënyra të ndryshme. Çfarë mendoni? Si kanë njehsuar?
Si i kanë paraqitur shumëzuesit? A kanë fituar prodhim të njëjtë? Pse?



4 **Plotëso fushat te tabela dhe shkruaj shumëzimin me ndihmën e mbledhjes.**





Shumëzues janë 3 dhe 6
6 + 6 + 6 = 18
3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 =18

5 Shkruaje shumën si prodhim:

5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5;

8 + 8 + 8 + 8 + ... + 8;

15 mbledhës

25 + 25 + 25;

a + a + a + a + ... + a.

300 mbledhës

6 Paraqite prodhimin si shumë prej këtyre mbledhësve:

a) 7 · 60 = _____

b) 3 · 90 = _____

c) 4 · 100 = _____

ç) 5 · 200 = _____

7 Shkruaji të gjithë shumëzuesit prodhimi i të cilëve është:

a) 32 b) 75 c) 100 ç) 120

8 Njehso prodhimin nëse njëri shumëzues është 0, kurse tjetri është numër më i vogël treshifror

9 Shumën e numrave 60 dhe 20 shumëzoje me numrin 1.

10 Ndryshimin e numrave 700 me numrin 200 shumëzoje me numrin 0.

11 Me plotësimin e tabelës, do të kujtohesh në tabelën e shumëzimit.

·	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
0											
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

PJESËTUESI

Marko ka 32 topa që i ka ndarë në 4 grupe. Nga sa topa ka çdo grup?



32 : 4 = 8

i pjesëtueshmi

pjesëtuesi

herësi

shenja për pjesëtim

Pjesëtimi është operacion i anasjelltë, invers i shumëzimit; 32 : 4 = 8 pasi 8 · 4 = 32.

Pjesëtimi është njehsim sa herë një numër përfshihet te numri tjetër.

Herësi është rezultati prej operacionit të pjesëtimit të dy numrave.

1 **Nga sa topa ka fituar çdo nxënës nëse topat i ka ndarë në mënyrë të barabartë:**

a) 6 nxënës b) 4 nxënës c) 3 nxënës ç) 8 nxënës d) 5 nxënës

2 Gjeji të gjithë pjesëtuesit te numri 30, që këto gurabi të ndahen në mënyrë të barabartë.



Kur pjesëtuesi është numri 1, atëherë herësi është i barabartë me të pjesëtueshmin.

Kur i pjesëtueshmi është numri 0, por pjesëtuesi është çdo numër i ndryshueshëm prej 0, atëherë herësi është 0. Pjesëtuesi nuk guxon të jetë 0. Me zero nuk pjesëtohet!



3 **Njehso herësit:**

a) 50 : 1 = ☐ b) 300 : 1 = ☐ c) 0 : 90 = ☐ ç) 0 : 600 = ☐

80 : 1 = ☐ 900 : 1 = ☐ 0 : 70 = ☐ 0 : 200 = ☐

4 **Cakto të gjitha çiftet prej pjesëtuesve prodhimi i të cilëve është i barabartë me numrin e dhënë.**

a) 30 b) 56 c) 110 ç) 200

5 **Cili numër është pjesëtues i çdo numri? Trego me shembull.**

6 **Cili është pjesëtuesi më i madh i një numri? Trego me shembull.**

7 **Cili numër është pjesëtues i çdo numri çift? Trego me shembull.**

8 **Nëse 7 • 9 = 63, atëherë sa është: 63: 7 = ___ dhe 63 : 9 = ____?**

9 **Nëse një numër pjesëtohet me 9 fitohet herësi 90. Cili është ai numër?**

SHUMËZUESIT E NUMRIT DYSHIFROR, SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR DYSHIFROR

$12 \cdot 2 = 24$ $\qquad$ $10 \cdot 2 = 20$ $\qquad$ $2 \cdot 2 = 4$

$12 \cdot 2 = (10 + 2) \cdot 2 = 10 \cdot 2 + 2 \cdot 2 = 20 + 4 = 24$

Kur shumëzojmë numër dyshifror me numër njëshifror, për më lehtë dhe më shpejt të njehsojmë, numrin dyshifror e zbërthejmë.

E paraqesim si shumë të dy mbledhësve dhe çdo mbledhës e shumëzojmë me numrin, me shumëzuesin tjetër.

$12 \cdot 11 = 12 \cdot (10 + 1) = 12 \cdot 10 + 12 \cdot 1 = 120 + 12 = 132$

Kur shumëzojmë numër dyshifror me numër dyshifror, për më lehtë dhe më shpejt të njehsojmë, njërin shumëzues e zbërthejmë.

E paraqesim si shumë të dy mbledhësve dhe çdo mbledhës shumëzohet me shumëzuesin tjetër.

1 **Njehso prodhimet sipas shembullit.**

$14 \cdot 4 = (10 + 4) \cdot 4 = 10 \cdot 4 + 4 \cdot 4 = 40 + 16 = 56$

$22 \cdot 8 =$

$36 \cdot 5 =$

$73 \cdot 3 =$

	1	4
x	1	4
	5	6

2 **Njehso prodhimet sipas shembullit.**

$26 \cdot 11 = 26 \cdot (10 + 1) = 26 \cdot 10 + 26 \cdot 1 = 260 + 26 = 286$

$39 \cdot 11 =$

$42 \cdot 13 =$





18 • 24 = ☐

18 • 24 =
(10 + 8) • 24 =

(10 • 24) + (8 • 24) =
10 • 24 = 240

8 • 24 =
8 • (20 + 4) =

(8 • 20) + (8 • 4) =
160 + 32 = 192

8 • 4 = 32

240 + 192 = 432

3 Njehso prodhimet sipas shembullit paraprak.

a) 48 • 23 = b) 29 • 17 = c) 37 • 21 = ç) 63 • 15 =

4 Cato çiftet e numrave shumëzues, prodhimi i cilëve është 120, 360, 540 dhe 720.

5 Ana ka lexuar 73 faqe të një libri, por Emiri ka lexuar 13 herë më shumë faqe prej Anës. Sa faqe ka lexuar Emiri?

6 Cili numër do të fitohet nëse numri 92 zmadhohet 18 herë?

7 Çdo vagon ka nga 84 vende. Sa vende ka një tren nëse ai përbëhet prej 26 vagonëve?

8 Cili prodhim është më i madh? Prodhimi i numrave 43 dhe 12 ose 25 dhe 21?

9 Një vreshtar prej vreshit të tij ka mbledhur 78 kg rrush të bardhë dhe për 14 herë më shumë se rrush të zi. Sa rrush të zi ka mbledhur vreshtari?

Të ushtrojmë, të përsërisim

1 Numri 8 ka katër pjesëtues: 1, 2, 4 dhe 8. Cakto numër tjetër njëshifror që ka 4 pjesëtues.

2 Cakto cili prej numrave të dhënë 328, 128, 88, 976, 6 400, 1 568 plotpjesëtohen me 8.

3 Caktoi pesë shumëfishat e parë të numrave 6, 8 dhe 9.

4 Ema dhe Seno janë anëtarësuar në bibliotekën e shkollës. Kanë pasur libra ndërmjet 110 dhe 150 të cilat duhet t'i radhitin te raftet. Së pari i kanë radhitur nga 5 rreshta, por nuk u ka pëlqyer, pra i kanë radhitur nga 7 në rresht. Sa libra kanë?

5 Te cila prej këtyre vargjeve anëtarët janë shumëfisha të numrit 25?

a) 25, 50, 150, 220, 250 b) 20, 25, 50, 55, 75 c) 50, 75, 100, 150, 200

6 Shkruaji pjesëtuesit te përbashkët të numrave:

a) 6, 20, 50 _____ b) 24, 48, 96 _____

7 Zbërtheji këta numra me ndihmën e drurit të pjesëtuesve:

a)



b)



c)



54 = ____ • ____ • ____ 75 = ____ • ____ • ____ 40 = ____ • ____ • ____

Druri i pjesëtuesve



48 = 2 • 2 • 2 • 2 • 3

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI DERI 10 000

NJEHSIMI I KATRORIT TË NUMRIT DERI 10

Te letra me katrorë vizato, kurse pastaj preji katrorët me gjatësi të brinjës 1, 2, 3... deri 10. Katrorët radhiti njërin pranë tjetrit duke filluar prej katrorit me syprinë më të vogël.

Nga sa katrorëve të vegjël „përbëhet" çdonjëri prej katrorëve?

Si mundesh ta caktosh numrin e tyre? (kujtohu se si caktohet syprina e katrorit te rrjeta e katrorit!)

Nëse a është numri me të cilin matet gjatësia e brinjës së katrorit, atëherë a · a = a2 është numri me të cilin është matur syprina e tij.

Numri a2 quhet edhe **katror i plotë** i numrit a.

$1 \cdot 1 = 1$ $2 \cdot 2 = 4$ $3 \cdot 3 = 9$ $4 \cdot 4 = 16$ $5 \cdot 5 = 25$ $6 \cdot 6 = 36$



$1 \cdot 1 = 1 = 1^2$
$2 \cdot 2 = 4 = 2^2$
$3 \cdot 3 = 9 = 3^2$
$4 \cdot 4 = 16 = 4^2$
$5 \cdot 5 = 25 = 5^2$
$6 \cdot 6 = 36 = 6^2$
$7 \cdot 7 = 49 = 7^2$
$8 \cdot 8 = 64 = 8^2$
$9 \cdot 9 = 81 = 9^2$
$10 \cdot 10 = 100 = 10^2$

Katror i plotë i numrit të dhënë a fitohet kur ai numër shumëzohet me vetveten.

Thuhet edhe se numri a është kuadruat, por numri a · a = a2 është katrori i numrit a.

Gjeji në tabelën për shumëzim deri 10 dhe rrethoji katrorët e plotë. Çfarë vëren? Si gjenden këta katrora të plotë në tabelë?

·	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2	2	4	6	8	10	12	14	16	18	20
3	3	6	9	12	15	18	21	24	27	30
4	4	8	12	16	20	24	28	32	36	40
5	5	10	15	20	25	30	35	40	45	50
6	6	12	18	24	30	36	42	48	54	60
7	7	14	21	28	35	42	49	56	63	70
8	8	16	24	32	40	48	56	64	72	80
9	9	18	27	36	45	54	63	72	81	90
10	10	20	30	40	50	60	70	80	90	100

Numri 3 i shumëzuar me vetveten është 9.

Kjo do të thotë se 9 është katror i plotë i numrit 3.

$3 \cdot 3 = 9 = 3^2$

Mund të parashtrohet pyetja:

Sa është katrori i numrit 8?

Ose sa është 8 në katror?



Numri 12 nuk është katror i plotë! Sqaro pse!

1 **Njehso katrorët e këtyre numrave:**

a) 2 b) 4 c) 7 ç) 9 d) 8 dh) 10 e) 5

2 **Cili numër i shumëzuar me vetveten e jep këtë prodhim?**

a) 9 b) 81 c) 25 ç) 100 d)) 49 dh) 36

3 **Rrethoji numrat të cilët nuk janë katrorë të plotë të ndonjë numri.**

5 15 25 12 6 16 49 20 81 1 100

4 **A 5^2 dallohet prej $5 \cdot 2$? Sqaro pse!**

5 **Shkruaje katrori e tetë të plotë.**

Tema 3

SHUMËZIMI I NUMRAVE PREJ 1 DERI 10 000 ME 10 OSE ME 100

Të përkujtojmë!

shumëzues • shumëzues = prodhim

456 • 10 = 4 560

Mbledhja e shkurtuar e mbledhësve të njëjtë quhet SHUMËZIM.
Numrat që shumëzohen quhen SHUMËZUES, rezultati i fituar quhet PRODHIM.

456 • 10 =

mijëshe	qindëshe	dhjetëshe	njëshe
	4	5	6
4	5	6	0

Kur numri i dhënë **shumëzohet** me dhjetë, ai numër bëhet dhjetë **herë** më i madh.

Njëshi bëhen dhjetëshe.
Dhjetëshet bëhen qindëshe.
Qindëshet bëhen mijëshe.
Për shembull: 456 · 10 = 4 560

Të shumëzohet një numër me 10, kjo do të thotë të zmadhohet dhjetë herë.



10 + 10 + 10 = 30
3 · 10 = 30

Për shembull:
35 · 10 = 350
123 · 10 = 1 230
254 · 10 = 2 540

145 · 10 = 1 450

Kur shumëzojmë ndonjë numër me 10, numrin e përshkruajmë, kurse pastaj e shtojmë zeron.

1 **Njehso prodhimet.**

$20 \cdot 10 =$	$10 \cdot 30 =$	$100 \cdot 10 =$
$823 \cdot 10 =$	$234 \cdot 10 =$	$390 \cdot 10 =$
$8\,204 \cdot 10 =$	$10 \cdot 999 =$	$10 \cdot 5\,678 =$

2 **Cakto shumëzuesit e panjohur.**

___ $\cdot 10 = 480$	____ $\cdot 10 = 5\,500$
$89 \cdot$ ___ $= 890$	$934 \cdot$ __ $= 9\,340$
____ $\cdot 10 = 700$	___ $\cdot 10 = 4\,940$

3 **Për zyrat e veta firma ka blerë 9 shtypës, 2 herë më shumë kompjuterë dhe 10 herë më shumë aparate telefonike. Sa aparate telefonike ka blerë firma?**

4 **Prodhimin e numrave 9 dhe 6 zmadhoje 10 herë.**

5 **Jana 10 ditë ka mbledhur nga 15 fotografi, kurse Aki ka mbledhur gjithashtu 10 ditë, por nga 19 fotografi. Sa është ndryshimi ndërmjet numrit të fotografive të mbledhura ndërmjet Janës dhe Akit? Cila ka mbledhur më pak fotografi?**

Të shumëzohet ndonjë numër me 100, kjo do të thotë të zmadhohet ai numër 100 herë.

$3 \cdot 1\boxed{00} = 3\boxed{00}$

Numri 300 është njëqind herë më i madh se numri 3.

Kur shumëzojmë ndonjë numër me 100, numrin e përshkruajmë, por pastaj i përshkruajmë zerot.

Për shembull:

$5 \cdot 100 = 500$

$24 \cdot 100 = 2\,400$

$80 \cdot 100 = 8\,000$



Kur numri i dhënë shumëzohet me 100, ai numër bëhet njëqind herë më i madh.
Njëshet bëhet qindëshe.
Dhjetëshet bëhen qindëshe.
Qindëshet bëhen dhjetë mijëshe.

1 **Njehso prodhimet.**

$7 \cdot 100 =$
$12 \cdot 100 =$
$100 \cdot 16 =$
$32 \cdot 100 =$
$100 \cdot 43 =$
$80 \cdot 100 =$
$100 \cdot 78 =$
$96 \cdot 100 =$

$100 \cdot 8 =$
$18 \cdot 100 =$
$100 \cdot 21 =$
$28 \cdot 100 =$
$100 \cdot 37 =$
$59 \cdot 100 =$
$100 \cdot 84 =$
$48 \cdot 100 =$

2 **Njehso shumëzuesit të cilët mungojnë.**

$13 \cdot$ _____ $= 1\,300$
_____ $\cdot 19 = 1\,900$
$100 \cdot$ _____ $= 35\,000$
_____ $\cdot 28 = 2\,800$

_____ $\cdot 100 = 1\,800$
$25 \cdot 100 =$ _____
_____ $\cdot 100 = 5\,500$
$100 \cdot$ _____ $= 7\,400$

$100 \cdot$ _____ $= 1\,500$
_____ $\cdot 42 = 4\,200$
$100 \cdot$ _____ $= 3\,000$
_____ $\cdot 100 = 3\,900$

3 **Sa herë numri 3 500 është më i madh se numri 35?**

4 **Orgesi çdo ditë ka marrë nga 100 denarë prej gjyshes së tij. Sa para ka mbledhur Orgesi nëse paratë i ka marrë gjatë gjithë muajit maj?**

5 **Njehso këto prodhime.**

$32 \cdot 10 =$ _____
$100 \cdot 16 =$ _____
$78 \cdot 100 =$ _____
$10 \cdot 9 =$ _____
$100 \cdot 37 =$ _____
$84 \cdot 100 =$ _____
$10 \cdot 59 =$ _____
$41 \cdot 100 =$ _____

$8 \cdot 100 =$ _____
$10 \cdot 45 =$ _____
$67 \cdot 100 =$ _____
$28 \cdot 10 =$ _____
$10 \cdot 67 =$ _____
$48 \cdot 10 =$ _____
$100 \cdot 59 =$ _____
$48 \cdot 100 =$ _____

$10 \cdot 16 =$ _____
$0 \cdot 100 =$ _____
$10 \cdot 29 =$ _____
$31 \cdot 100 =$ _____
$100 \cdot 94 =$ _____
$76 \cdot 100 =$ _____
$100 \cdot 88 =$ _____
$10 \cdot 0 =$ _____

PJESËTIMI I NUMRAVE PREJ 1 DERI 10 000 ME 10 OSE ME 100

PJESËTIMI ME 10

10 • 10 = 100 pra 100 : 10 =10.

I pjesëtueshmi pjesëtuesi herësi

Të pjesëtohet një numër me 10, kjo do të thotë ai numër të zvogëlohet dhjetë herë.

230 : 1 = 230
230 : 10 = 23
2 300 : 10 = 230

230 · 1 = 230
23 · 10 = 230
2 30 · 10 = 2 300

Kur një numër pjesëtohet me 10, shifrat te herësi fitohen prej shifrave të pjesëtueshmit ashtu që zhvendosen për një vend djathtas te tabela me vlera vendore.

Mijëshet bëhet qindëshe.
Qindëshet bëhet dhjetëshe.
Dhjetëshet bëhen njëshe.

340 : 10 = 34

650 : 10 = 65

mijëshe	qindëshe	dhjetëshe	njëshe
	3	4	0
		3	4
	6	5	0
		6	5

1 Njehso:

a) 490 : 10 =
b) 1 000: 10 =
c) 890 : 10 =
ç) 7 800 : 10 =
d) 1 200: 10 =
e) 6 060 : 10 =

2 Për t'u qepur një kostum janë të nevojshme 10 metra pëlhurë. Sa kostume do të qepen prej 550 metra pëlhurë?

3 Plotësoi katrorët e zbrazët.





Për shembull:
2 300 : 100 = 23
200 : 100 = 2

Kontrolli: 23 · 100 = 2 300
2 · 100 = 200

Kur një numër **a** e pjesëtojmë me 100, ai zvogëlohet njëqind herë, pra herësi fitohet nëse shifrat prej numrit a (të pjesëtueshmit) zhvendosen për dy vende djathtas në tabelë me vlera vendore.

mijëshe	qindëshe	dhjetëshe	njëshe
1	2	0	0
		1	2

1 200 : 100 =



1 **Njehso:**

a) 50 : 10 = b) 410 : 10 = c) 100 : 10 =
ç) 20 : 10 = d) 200: 10 = dh) 140 : 10 =
e) 600 : 100 = f) 730 : 10 = g) 900 : 100 =

2 **Njehso:**

a) 70 : _____ = 7 b) 6 230 : 10 = _____ c) 94 200 : 10 = _____
ç) 10 000 : 100 = _____ d) 5 100: 10 = _____ dh) 450 : 10 = _____
e) 960 : _____ = 96 f) 112 = _____ : 100 g) _____ : 100 = 23
h) 7 106 = _____ : 100 i) 40 300 : _____ = 4 030
j) 1 000 000 : _____ = 1 000

3 **Te tabelat zbulo lidhjen ndërmjet numrave dhe plotëso.**

2 000	20
50 000	500
7 000	
	24
380 000	
	2 500

850	
	124
2 000	
1 400	140
	70
26 000	2 600

630	6 300
640	
	11 500
18	
35 000	350 000
	450

SHUMËZIMI I NUMRAVE NJËSHIFRORË ME QINDËSHE TË PLOTË DERI 900

Qindëshet e plota janë numra të cilët në vendin e dhjetësheve dhe njësheve kanë zero.

Te mijëshja e parë, qindëshe të plota janë numrat 100, 200, 300, 400, 500, 600, 700, 800, 900

Numri shumëzohet me 200, 300, 400...900, ashtu që numri shumëzohet me 2, 3, 4...9, kurse pastaj prodhimit i shtohen dy zero.

Të shumëzojmë
$7 \cdot 300 = ?$

$300 = 3$ qindëshe
$= 3 \cdot 100$

$7 \cdot 300 = 7 \cdot 3 \cdot 100$
$= 21 \cdot 100$
$= 2\,100$

1 **Njehso prodhimet:**

a) $1 \cdot 700 =$	b) $4 \cdot 500 =$	c) $5 \cdot 400 =$	ç) $3 \cdot 700 =$
d) $2 \cdot 300 =$	dh) $3 \cdot 800 =$	e) $7 \cdot 70 =$	ë) $5 \cdot 900 =$
f) $2 \cdot 800 =$	g) $4 \cdot 700 =$	gj) $4 \cdot 400 =$	h) $7 \cdot 400 =$
j) $8 \cdot 900 =$	i) $6 \cdot 300 =$	k) $5 \cdot 500 =$	l) $1 \cdot 500 =$
ll) $9 \cdot 800 =$	m) $6 \cdot 500 =$	n) $7 \cdot 200 =$	nj) $5 \cdot 800 =$

2 Njehso prodhimin nëse njëri shumëzues është 8, kurse shumëzuesi tjetër është dyqind herë më i madh se ai.

3 Numrin 5 600 zmadhoje për prodhimin e numrave 400 dhe 6, kurse pastaj zvogëloje për 100. Cilin numër e fitove?

4 **Njehso dhe plotëso sipas kërkesave.**





5 **Shenoli ka menduar një numër. Kur numrin e zmadhoi dyqind here e fito i numrin 1 000. Cilin numër e ka menduar Berati?**

Tema 3

SHUMËZIMI I NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

$234 \cdot 3 = 234 + 234 + 234$
$= 702$

Shumëzimi është mbledhje e shumëhershme të mbledhsave të njëjtë

Shumëzimi mund të kryhet edhe me zbërthimin e numrave dhe grupimin e tyre:

$234 \cdot 3 = (200 \cdot 3) + (30 \cdot 3) + (4 \cdot 3)$
$= 600 + 90 + 12$
$= 702$

1 **Përpiqu të njehsosh këto prodhime me ndihmën e mbledhjes me mbledhës të njëjtë.**

125 · 4 = _____ + _____ + _____ = _____

242 · 5 = _____ + _____ + _____ + _____ = _____

204 · 2 = _____

2 **Këto prodhime njehsoji me ndihmën e zbërthimit të numrave dhe grupimit të tyre.**

343 · 6 = (____ · ____) + (____ · ____) + (____ · ____) =

_____ + _____ + _____ = _____

405 · 3 = _____

516 · 7 = _____

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

$$\begin{array}{r} 237 \\ \cdot\quad 5 \\ \hline 35 \\ 150 \\ +\ 1000 \\ \hline 1185 \end{array}$$

Shumëzimi me njëshe 5 · 7

Shumëzimi me dhjetëshe 5 · 30

Shumëzimi me qindëshe 5 · 200

Por ka edhe mënyrë të shkurtër për shumëzimin

3 **Njehso prodhimin me ndihmën e strategjisë së treguar**

718 · 2	351 · 9	380 · 7
104 · 3	840 · 2	425 · 5

182 · 4

Q	DH	NJ	
1	8	2	· 4
	32		
7	2	8	

197 · 5

Q	DH	NJ	
1	9	7	· 5
	45	5	
9	8	5	

Shumëzimi fillon prej numrit njëshifror me njëshet të numrit dyshifror

- 4 · 2 Nj = 8NJ (shkruajmë 8 te prodhimi në vend të NJ)
- 4 · 8 DH = 32 DH (2 DH shkruajmë në vend të DH te prodhimit, por 3 Q mbajmë në mend, i shtojmë te qindëshet)
- 4 · 1 Q = 4Q + 3Q = 7Q (shkruajmë 7 qindëshe te prodhimi në vend të qindësheve)

3 **Njehso prodhimet me ndihmën e mënyrës së shkurtër.**

533 · 8	979 · 8	941 · 5	530 · 9
257 · 8	790 · 8	965 · 3	799 · 2

4 **Zbulo shifrat e lëna.**

5 719 · □	2□□4□ · 4	7□7□7 · 2
□0 033	□2 196	□□1□14

Njehsimi mund të paraqitet në mënyrë tabelare.

x	200	30	5	
3	600	90	15	705

$3 \cdot 235 = ?$
$235 = 200 + 30 + 5$
$200 \cdot 3 = 600$
$30 \cdot 3 = 90$
$5 \cdot 3 = 15$

Te rreshti i parë i tabelës shkruhet numri treshifror sipas vlerës vendore të shifrave.
Pastaj çdonjërin prej numrave te rreshti i parë e shumëzojmë me numër njëshifror.
Në fund prodhimet e fituara i mbledhim. Shuma e paraqet rezultatin e shumëzimit.

1 **Njehso shumëzimin me ndihmën e tabelës.**

$350 \cdot 5$

x	300	50	0	
5				

$648 \cdot 3$

x				

2 **Shumëzo. Duke shfrytëzuar strategjinë që e ke më të lehtë.**

a) $502 \cdot 6 =$ b) $440 \cdot 7 =$ c) $813 \cdot 3 =$ D) $551 \cdot 5 =$ d) $692 \cdot 6 =$

dh) $316 \cdot 3 =$ e) $418 \cdot 4 =$ ë) $509 \cdot 8 =$ f) $276 \cdot 5 =$ g) $217 \cdot 4 =$

3 **Njehso:**

a) $328 \cdot 2 + 167 =$ b) $(128 + 76) \cdot 3 =$

c) $928 - 253 \cdot 2 =$ ë) $607 \cdot 2 - 270 =$

4 **Prodhimin e numrave 169 dhe 8 zvogëloje për shumën e numrave 386 dhe 156.**

5 **Prej numrit 10 000 zbrite prodhimin e numrave 686 dhe 8.**

6 **Në festën e ditëlindjes Sema ka blerë 4 kuti me nga 135 gurabi dhe 2 kutia me nga 160 kifla. Sa gurabi dhe sa kifla ka blerë Sema?**

7 **Në një kopsht pemësh ka 205 fidan mollë, 3 herë më shumë fidanë dardha dhe kumbulla 189 më pak se dardha. Sa fidanë pemësh ka në kopshtin e pemëve?**

SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR DYSHIFROR

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

Shumëzimi me zbërthim

$36 \cdot 23 = 36 \cdot (20 + 3) =$

$= 36 \cdot 20 + 36 \cdot 3 =$

$= 720 + 108 =$

$= 828$

$$\begin{array}{r} 36 \cdot 23 \\ \hline 720 \\ +\ 108 \\ \hline 828 \end{array}$$

1 Njehso me zbërthim.

a) $34 \cdot 31 =$ b) $72 \cdot 23 =$ c) $28 \cdot 25 =$ ç) $92 \cdot 33 =$

d) $91 \cdot 39 =$ dh) $52 \cdot 34 =$ e) $7\ 4 \cdot 19 =$ ë) $38 \cdot 79 =$

2 **Petra ka 74 fotografi tek albumi i saj. Jovani ka 14 herë me shumë se Petra.**

Sa fotografi ka Jovani?

Sa fotografi gjithsej kanë së bashku?

3 **Fletorja e Elvir ka 65 faqe. Sa faqe kanë 12 fletore të atilla?**

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

Shumëzimi në tabelë

$99 \cdot 28 =$

·	20	8	
90	1 800	720	2 520
9	180	72	252
			2 772

3 **Njehso prodhimet në tabelë.**

$84 \cdot 35$, $26 \cdot 56$, $42 \cdot 39$, $96 \cdot 44$, $76 \cdot 28$

·			

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

$$\begin{array}{r} 32 \cdot 24 \\ \hline 128 \\ +\ 64\ * \\ \hline 768 \end{array}$$

Së pari shumëzuesin e parë e shumëzojmë me shifrën e njësheve të shumëzuesit të dytë $4 \cdot 32 = 128$.
Rezultati shkruhet nën vijën.
Pastaj e shumëzojmë me shifrën e dhjetësheve $2 \cdot 32 = 64$
Rezultati shkruhet nën prodhimin paraprakisht të fituar, duke pasur kujdes se shifra e fundit e prodhimit të tij duhet të qëndrojë nën shifrën e dhjetësheve të prodhimit të parë (duke zhvendosur për një vend majtas). Në fund i mbledhim numrat dhe e gjejmë **prodhimin** e kërkuar

1 **Njehso:**

42 · 18 _____ 61 · 24 _____ 59 · 47 _____ 36 · 82 _____

64 · 21 _____ 75 · 15 _____ 94 · 32 _____ 77 · 48 _____

2 **Njehso shprehjet numerike.**

a) 78 · (16 + 39) = _____ = _____

b) 78 · 16 + 39 = _____ = _____

c) 78 + 16 · 39 = _____ = _____

ç) (78 + 16) · 39 = _____ = _____

3 **Prodhimin e numrave 8 dhe 7 shumëzoje me shumën e tyre.**

4 **Numrat: 56, 78 dhe 95 zmadhoji 46 herë.**

MËSO MË SHUMË – STRATEGJIA GJEOMETRIKE PËR SHUMËZIM

23 · 12 = 276



2 3 + 4 = 7 6

Prodhimi fitohet si numër të pikëprerjeve ndërmjet vijave të vizatuara te klasa përkatëse
(2 pika te klasa qindëshe, 3 + 4 pika te klasa dhjetëshe dhe 6 pika te klasa njëshe)

Q	DH	NJ
2	7	6

Shumëzuesit i zbërthejmë në dhjetëshe dhe në njëshe. Për çdo shifër vizatohen numër përkatës të vijave paralele. Së pari vizatojmë për numrin 23 (për 2 – dy vija, për 3 – tre vija).

Pastaj, normalisht te vijat e vizatuara, vizatohen edhe për numrin 12 (për 1-një vijë, për 2-dy vija)

Numri 23



Numri 12

5 **Me strategji gjeometrike përpiqu të njehsosh prodhimet:**

a) $47 \cdot 14$ b) $32 \cdot 41$ c) $25 \cdot 33$ ç) $52 \cdot 31$

STRATEGJIA PËR SHUMËZIM

$13 \cdot 19$ $= 13 \cdot 20 = (10 + 3) \cdot 20 = 10 \cdot 20 + 3 \cdot 20 = 200 + 60 = 260$
$260 - 13 = 247$

Pasi shumëzuam me 20, por jo me 19, do **të zbresim një 13**, që është tepricë.

$13 \cdot 21$ $= 13 \cdot 20 = (10 + 3) \cdot 20 = 10 \cdot 20 + 3 \cdot 20 = 200 + 60 = 260$
$260 + 13 = 273$

Pasi shumëzuam me 20, jo me 21, **shtojmë një 13**, që mungon.

$6 \cdot 99$ $= 6 \cdot 100 = 600$
$600 - 6 = 594$

Pasi shumëzuam me 100, por jo me 99, **do të zbresim një 6**, që është tepricë.

$6 \cdot 101$ $= 6 \cdot 100 = 600$
$600 + 6 = 606$
Pasi shumëzuam me 100, por jo me 101, **shtojmë një 6.**

6 **Shumëzo. Shkruaj të katër hapat te mënyra për shumëzim.**

a) $21 \cdot 42 =$ b) $19 \cdot 63 =$ c) $32 \cdot 19 =$ ç) $83 \cdot 21 =$

7 **Shumëzo. Shkruaj të katër hapat te mënyra për shumëzim.**

a) $74 \cdot 99 =$ b) $37 \cdot 12 =$ c) $51 \cdot 98 =$ ç) $66 \cdot 52 =$

Tema 3

VETIA KOMUTATIVE TE SHUMËZIMI



Të mendojmë? Çka do të ndodhë nëse shumëzuesit i ndërrojmë vendet?

$2 \cdot 4$

$4 \cdot 2$

$2 \cdot 4$ $4 \cdot 2$

Përfundimi: Nëse shumëzuesit i ndërrojnë vendet, prodhimi do të ngelë i njëjtë, përkatësisht nuk do të ndryshojë. Kjo veti quhet VETIA KOMUTATIVE te shumëzimi



$3 \cdot 2 = 2 \cdot 3 = 6$

VETIA KOMUTATUVE

Renditja sipas të cilës shumëzohen numrat nuk është e rëndësishme: $x \cdot y = y \cdot x$



1 Te vendet e zbrazëta shkruaj shumëzuesit për të zbatuar vetinë komutative gjatë shumëzimit.

a) $6 \cdot 2 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

b) $60 \cdot 2 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

c) $8 \cdot 9 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

ç) $16 \cdot 12 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

d) $5 \cdot 7 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

dh) $15 \cdot 20 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

e) $4 \cdot 8 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

ë) $80 \cdot 90 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

f) $25 \cdot 9 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

g) $60 \cdot 49 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

gj) $13 \cdot 12 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$

h) $7 \cdot 600 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

2 Te katrorët e zbrazët vendo shenjën e nevojshme: < = ose >, që të jetë i saktë gjykimi:

a) $42 \cdot 900$ ☐ $300 \cdot 42$

b) $15 \cdot 20$ ☐ $2 \cdot 150$

c) $215 \cdot 8$ ☐ $8 \cdot 215$

ç) $65 \cdot 23$ ☐ $23 \cdot 56$

3 Njehso vlerën e çdonjërës prej shprehjeve $a \cdot b$ dhe $b \cdot a$, nëse $a = 65$ dhe $b = 12$, kurse pastaj krahasoji rezultatet e fituara. Si janë ato ndërmjet veti

4 Në një bibliotekë ditën e hënë janë sjellë libra dhe janë renditur në 5 rreshta, por në çdo rresht ka pasur nga 15 libra. Ditën tjetër janë sjellë ende libra të cilët kanë qenë të renditur në 15 rreshta, por në çdo rresht ka pasur nga 5 libra. Sa libra gjithsej janë sjellë për dy ditë?

VETIA ASOCIATIVE TE SHUMËZIMI

Në një librari të vogël ka 3 vitrina me nga 5 rafte. Te çdo raft ka nga 8 libra. Sa libra gjithsej ka në librari?

Detyrën mund ta zgjidhim në dy mënyra:

$(3 \cdot 5) \cdot 8 = 15 \cdot 8 = 120$

$3 \cdot (5 \cdot 8) = 3 \cdot 40 = 120$

Përfundojmë se:

$(3 \cdot 5) \cdot 8 = 3 \cdot (5 \cdot 8)$

Vetia asociative vlen për çfarëdo numra a, b dhe c.

$(a \cdot b) \cdot c = a \cdot (b \cdot c)$

Te shumëzuesit nëse i grupojmë në mënyrë të ndryshme, prodhimi nuk ndryshon.

Shumëzimi mund të kryhet edhe me më shumë se dy shumëzues.

$4 \cdot 2 \cdot 3 = ?$

Për njehsim më lehtë të prodhimit, shumëzuesit mund të grupohen, si për shembull:

$(4 \cdot 3) \cdot 2 = 12 \cdot 2 = 24$
$4 \cdot (3 \cdot 2) = 4 \cdot 6 = 24$

$(4 \cdot 3) \cdot 2 = 4 \cdot (3 \cdot 2)$
$12 \cdot 2 = 4 \cdot 6$
$24 = 24$

1 **Njehso me zbatimin e vetisë asociative.**

a) $3 \cdot 8 \cdot 5 =$ b) $6 \cdot 12 \cdot 4 =$ c) $15 \cdot 4 \cdot 26 =$

2 **Njehso vlerën e çdonjërës prej shprehjeve, kurse pastaj krahasoje.**

a) $(388 \cdot 2) \cdot 4 =$
$388 \cdot (2 \cdot 4) =$

b) $(4 \cdot 135) \cdot 7 =$
$4 \cdot (135 \cdot 7) =$

3 **Njehso në mënyrë të thjeshtë.**

a) $4 \cdot 224 \cdot 5 =$ b) $5 \cdot 370 \cdot 2$ c) $322 \cdot 3 \cdot 10 =$

4 **Cili numër do të fitohet nëse prodhimi i numrave 23 dhe 8 zmadhohet 32 herë.**

5 **Cili numër do të fitohet nëse numrin 98 e dyfishon, pro prodhimin e tyre e zmadhon 8 herë.**

6 **Prodhimin e numrave 58 dhe 36 dyfishoje.**

7 **Në një livadh ka pasur 85 lule. Çdo lule ka pasur nga 16 degë. Në çdo degë janë ndalë 7 bletë. Sa bletë ka pasur në kopsht?**

Tema 3

VETIA DISTRIBUTIVE TE SHUMËZIMI

Në sallën e fizkulturës nxënësit kanë luajtur volejboll. Janë ndarë në dy grupe, por në çdo grup ka pasur nga 9 djem dhe 5 vajza. Sa nxënës gjithsej ka pasur në sallën e fizkulturës?

Mënyra e parë: $2 \cdot (9 + 5) = 2 \cdot 14 = 28$ Mënyra e dytë: $2 \cdot 9 + 2 \cdot 5 = 18 + 10 = 28$

Çka vëren?

Gjatë shumëzimit të shumës (ndryshimit) me numër, mund të zbatohet edhe mënyra e shumëzimit të çdo anëtari prej shumës (ndryshimit) me atë numër dhe mbledhja (zbritja) e prodhimeve të fituara. Kjo veti e shumëzimit të shumës (ndryshimit) me numër quhet edhe vetia distributive e shumëzimit në lidhje me shumën (zbritjen).

$3 \cdot (4 + 5) = 3 \cdot 4 + 3 \cdot 5$

$9 \cdot (15 - 4) = 9 \cdot 15 - 9 \cdot 5$

$(10 + 6) \cdot 2 = 10 \cdot 2 + 6 \cdot 2$

$(14 - 10) \cdot 6 = 14 \cdot 6 - 10 \cdot 6$

Vetia distributive e shumëzimit në lidhje me mbledhjen

$a \cdot (b + c) = a \cdot b + a \cdot c$

$a \cdot (b - c) = a \cdot b - a \cdot c$

Vetia distributive e shumëzimit në lidhje me zbritjen.

1 **Njehso në mënyrë më të lehtë vlerën e shprehjeve.**

a) $138 \cdot 45 - 38 \cdot 45$ b) $265 \cdot 304 - 165 \cdot 304$

c) $428 \cdot 125 + 372 \cdot 125$ ç) $3\,578 \cdot 378 - 2\,578 \cdot 378$

2 **Shkruaj numër te katrorët që shprehja numerike të jetë e saktë.**

a) $(7 + \_\_\_\_) \cdot 6 = \_\_\_\_ \cdot 6 + 2 \cdot 6$

b) $(3 + \_\_\_\_ + 4) \cdot 4 = 3 \cdot \_\_\_\_ + 2 \cdot 4 + 4 \cdot 4$

c) $(80 + 10) \cdot \_\_\_\_ = 80 \cdot 9 + 10 \cdot \_\_\_\_$

ç) $(100 + 80 + 20) \cdot \_\_\_\_ = \_\_\_\_ \cdot 5 + 80 \cdot 5 + 20 \cdot 5$

2 Cakto cili prej barazimeve të dhëna është i saktë:

a) $(47 + 39) \cdot 28 = 47 \cdot 28 + 39 \cdot 28$

b) $(150 + 63) \cdot 45 = 150 \cdot 45 + 150 \cdot 63$

c) $25 \cdot (78 + 96) = 25 \cdot 78 + 25 \cdot 96$

3 Shumën e numrave 8 dhe 9 zmadhoje 12 herë. Cilin numër e fitove? Zgjidh në dy mënyra.

4 Një bujk prej kopshtit ka mbledhur 365 kumbulla, kurse mollë 24 herë më shumë se kumbulla. Sa kilogram pemë ka mbledhur bujku?

Përsërisim dhe ushtrojmë

1 Në një tren ka 23 vagonë. Në çdo vagon mund të ulen nga 95 udhëtarë. Sa udhëtar mund të ulen në tren?

2 Milloshi ka 58 fotografi, por vëllau Pero ka 12 herë më shumë se ai. Sa fotografi gjithsej kanë së bashku?

3 Njehso syprinën e bangës, gjatësia e së cilët është 95 cm dhe gjerësia 34 cm.

4 Cili numër është 13 herë më i madh se ndryshimi i numrave 208 dhe 174?

5 Njehso shprehjet numerike.

a) $61 \cdot 15 + 123 \cdot 4 =$

b) $19 \cdot 35 - 135 + 100 \cdot 5 =$

c) $50 + 52 \cdot 21 - 158 \cdot 2 =$

6 Për sa prodhimi i numrave 358 dhe 27 është më i madh se shuma e tyre?

7 Cili numër do të fitohet nëse prej prodhimit të numrave 225 dhe 64 do të zbritet prodhimi i numrave 136 dhe 72?

Tema 3

PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR. TË SHKRUARIT E MBETJES SI THYESË

DYSHIFROR ME NJËSHIFROR ME MBETJE

Njehso herësin e numrave 48 dhe 6 dhe bëje kontrollin.

48 : 6 =

Të pjesëtohet numri natyror **a** me numrin natyror **b** do të thotë të caktohet numër i atillë c që i shumëzuar me numrin b e jep numrin a.

a : b = c ако **b • c = a**

Pjesëtimi është operacion invers i shumëzimit.

Shenja për pjesëtim

pjesëtueshmi

pjesëtuesi

48 : 6 = 8

herësi

8 • 6 = 48

6 • 8 = 48

Në një barkë mund të ulen 3 fëmijë. Sa barka janë të nevojshme për 57 fëmijë?

_____

_____

_____

1 Plotësoje tabelën. Vendo X ku nuk mundesh në mënyrë tabelare të pjesëtosh. Si te shembujt e paraqitur

:	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
: 3	x									
: 4		8								
: 5			x							
: 6				x						

Te detyra paraprake në tabelë diku nuk mund të pjesëtosh në mënyrë tabelare.
Gjatë pjesëtimit ka mbetje.
Sipas shembullit vijues, në fletore zgjidhi detyrat ku ke venduar shenjën X.



28 : 5 = 5
- 25
3

Çdo mbetje gjatë pjesëtimit të një numri me tjetër mund të paraqitet edhe si thyesë dhe të paraqet sa pjesë prej tërësisë ka ngelur tepricë gjatë pjesëtimit në pjesë të barabarta.
Shkruajmë: mbetja gjatë pjesëtimit/pjesëtues.

Kontrolli:

5 · 5 = 25 + 3 = 28

28 : 5 = 5
- 25
3

Numërues

Emërues

$\frac{3}{5}$

2 Shkruaje mbetjen gjatë pjesëtimit në formë të thyesës.

38 : 6 = ☐ ___

☐

☐

Kontrolli:

25 : 4 = ☐ ___

☐

☐

Kontrolli:

19 : 2 = ☐ ___

☐

☐

Kontrolli:

3 Një grup ka pasur 28 fëmijë. Arsimtari dëshiron t'i ndajë në grupe më të vogla prej nga 5 fëmijë. Sa grupe do të bëjë arsimtari?

4 Një shportë nxë 8 kavanozë. Sa shporta mund të mbushen me:

a) 48 kavanozë? b) 55 kavanozë? c) 60 kavanozë? ç) 100 kavanozë?

5 Formo detyrë tekstuale e cila zgjidhet sipas shprehjes numerike: 67 : 31 = 3 (mbetja 4).

PJESËTIMI ME ZBËRTHIM

28 : 4 =

(20 : 4) + (8 : 4) = 5 + 2 = 7

6 Njehso me zbërthim.

a) 26 : 2 = b) 75 : 5 = c) 84 : 2 = ç) 76 : 4 = d) 91 : 7 =

7 Njehso.

a) (48 – 24) : 6 = 48 : ___ - 24 : ___ =
b) (50 – 15) : ___ = 50 : 5 – 15 : 5 =
c) (30 + 24) : 6 = 30 : ___ + ___ : ___ =

8 Formo detyrë tekstuale e cila zgjidhet me shprehje numerike (200 – 50) : 5 = 30

56 : 4 = 14
- 4
16
- 16
0

Kontrolli : 16 · 4
56

Numri i dhjetësheve është 5 dhe është më i madh se pjesëtuesi. Herësi është numër dyshifror.

Pjesëtimin e fillojmë prej dhjetësheve.
5DH : 4 = 1DH (mbetja 1DH). Deri te mbetja prej 1DH e shkruajmë (e lëshojmë) shifrën 6 (njësi) të pjesëtueshmit. Fitojmë 16 njësi.
16NJ : 4 = 4NJ

Kontrolli: 4NJ · 4
Nuk ka mbetje

9 **Njehso herësit dhe bëje kontrollin.**

a) 85 : 5= b) 98 : 7 = c) 90 : 6 = ç) 84 : 6 =

10 **Nëna e Anjes ka bërë 364 kavanozë për dimër. Tani në podrum kanë ngelur 4 herë më pak kavanozë. Sa kavanozë për dimër kanë ngelur të pangrëna?**

11 **Kola ka 243 lepuj. Sa kafazë duhet të blejë Kola për t'i vendosur lepujt nga 9 së bashku?**



12 **Prodhimin e numrave 43 dhe 33 zvogëloje 3 herë.**

13 **Formo detyrë tekstuale sipas shprehjes numerike 250 + (100 : 5) = 270**

PJESËTIMI I NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR PA MBETJE DHE ME MBETJE

732 : 6 = 122
- 6
13
- 12
12
- 12
0

Fillojmë të pjesëtojmë prej shifrës së qindësheve të pjesëtueshmit me pjesëtuesin.
7Q : 6 = 1 Q (6 në 7 përmbahet njëherë)
I zbresim qindëshet 7Q – 6Q = 1Q
Pranë 1Q e shkruajmë (lëshojmë) dhjetëshen.
13DH : 6 = 2DH (2 · 6 = 12)
13DH – 12DH = 1 DH Pranë 1DH e shkruajmë (lëshojmë) njëshen. 12NJ : 6 = 2NJ
2 · 6 = 12 mbetje nuk ka d.m.th., mbetja është 0

736 : 8 = 92
- 72
16
- 16
0

kontrolli:
1
92 · 8
736

Si pjesëtojmë kur shifra e parë prej të pjesëtueshmit është më e vogël prej pjesëtuesit?
7 pjesëtuar me 8 është 0, por 0 nuk shkruhet si shifër e parë. Pjesëtuesi 8 nuk përmbahet asnjëherë te shifra 7, atëherë vlerësojmë pjesëtuesin 8 sa herë përmbahet te 73. (shifrat 7 dhe 3 së bashku)

1 **Njehso herësit dhe bëje kontrollin**

654 : 2 = ☐☐☐
- ☐
☐
- ☐
☐☐
☐☐
0
kontrolli: ☐ · 2
☐

864 : 4 = ☐☐☐
- ☐
☐
- ☐
☐☐
☐☐
0
kontrolli: ☐ · 4
☐

690 : 6 = ☐☐☐
- ☐
☐
- ☐
☐☐
☐☐
0
kontrolli: ☐ · 6
☐

2 **Njehso: (464 + 288) : 2 =** **(135 + 420) : 5 =**

3 **I pjesëtueshmi është numri treshifror më i madh, por pjesëtuesi është numri njëshifror më i madh. Sa është herësi?**

4 **Shoku im ka blerë shall dhe kësulë në lirim. Para lirimit kanë kushtuar 990 denarë. Gjatë kohës së lirimit kanë qenë të zvogëluara 6 herë. Sa para i ka blerë shallin dhe kësulën?**

571 : 4 = 142
- 4
17
- 16
11
- 8
3

Fillojmë të pjesëtojmë prej shifrës së qindësheve prej të pjesëtueshmit me pjesëtuesin.
5Q : 4 = 1 Q (4 në 5 përmbahet njëherë)
I zbresim qindëshet 5Q – 4Q = 1Q
Pranë 1Q e shkruajmë (lëshojmë) dhjetëshen.
17DH : 4 = 4DH (4 • 4 = 16)
17DH – 16DH = 1DH
Pranë 1DH e shkruajmë (lëshojmë) njëshen.
11NJ : 4 = 2NJ (2 • 4 = 8)
11NJ – 8NJ = 3 **mbetja**

Kontrolli: 142 • 4 + 3 = 568 + 3 = 571

5 **Njehso herësit dhe gjeje mbetjen. Bëje kontrollin.**

a) 526 : 4 = b) 658 : 5 c) 757 : 5 = ç) 917 : 7 =

6 **Për sa është më i madh herësi i numrave 524 dhe 4 prej herësit të numrit 123 dhe 3.**

7 **Shkruaj njërën prej shenjave < = >, që të jetë e saktë.**

(768 : 2) : 4 ☐ 768 : 8 (152 · 2) · 3 ☐ (912 : 2) : 3

8 **Shkruaj një numër katërshifror më të vogël se 1 008, i cili gjatë pjesëtimit me 8 ka mbetje 7.**

9 **Sa mund të jetë mbetja gjatë pjesëtimit të ndonjë numri me 5?**

10 **Njehso.**



VLERËSIMI I VLERËS SË PRODHIMIT OSE HERËSIT DHE KONTROLLI I VLERËSIMIT

Shpeshherë ndodh të bëhen gabime gjatë shumëzimit ose pjesëtimit të numrave.

Prandaj para se të fillojmë me njehsimin është mirë të vlerësojmë rezultatin.

Çfarë vlerësimi do të jepnit për prodhimin e numrave 52 • 13 • 20?

Numri 52 është afër 50, kështu që prodhimi i 52 dhe 20 do të ishte afër 50 • 20 = 1000

Pastaj 1 000 e shumëzuar me 13 është 13 000.

Vlerësimi për prodhimin e dhënë është 13 000.

Hapi i parë i vlerësimit është rrumbullakimi i numrave, duke ndryshuar deri te dhjetëshja, qindëshja, mijëshja e përafërt.

I rrumbullakojmë numrat, kurse pastaj përdorim aritmetikën mentale për vlerësim

Deri te vlerësimi i rezultatit të shumëzimit (prodhimit), rrumbullakimi i disa numrave të përafërt mund lehtë ta shumëzojmë.

Deri te rezultati prej pjesëtimit (herësit), të pjesëtueshmin e rrumbullakojmë dhe vlerësojmë pjesëtuesin sa herë përmbahet tek i pjesëtueshmi.

Vlerëso.

Në një kuti mund të paketohen 8 gota. Sa kuti janë përdor për t'u paketuar 790 gota?

Vlerësimi:

Njehso:

Vlerëso.

Kam 960 denarë. Dua të blejë 4 dhurata të cilat kushtojnë nga 260 denarë. A kam mjaft para. Sa më mungojnë ose sa do të më ngelin:

Vlerësimi:

Njehso:

1 **Vlerëso dhe lidhu për të qenë saktë. Pastaj njehso për të kontrolluar vlerësimin tënd.**

525 : 3	848 : 4	728 : 7	918 : 6
Ndërmjet 100 dhe200	Ndërmjet 200 dhe 300	Ndërmjet 300 dhe 400	Ndërmjet 400 dhe 500
165 · 2	72 · 6	102 · 4	24 · 15

2 **Vlerëso prodhimin e numrave 164 dhe 3, kurse pastaj kryej shumëzimin me vlera të vërteta dhe kontrollo vallë prodhimi është afër deri te vlerësimi.**

CAKTIMI I SHUMËZUESIT, TË PJESËTUESHMIT DHE PJESËTUESIT TË PANJOHUR GJATË SHUMËZIMIT DHE PJESËTIMIT

Nëse numri i panjohur zmadhohet 25 herë fitohet numri 100. Cili është numri i panjohur?

$X \cdot 25 = 100$
$X = 100 : 25$
$X = 4$

Kontrolli: $4 \cdot 25 = 100$

$X \xrightarrow{\cdot 25} 100$
$X \xleftarrow{:25} 100$

Numrin e panjohur e shënojmë me X ose me ndonjë tjetër shkronjë.
Fitojmë barazim
$X \cdot 25 = 100$
me të panjohurën X
E panjohura te barazimi është shumëzues. Shumëzuesin e panjohur e gjejmë kur prodhimin e pjesëtojmë me shumëzuesin e njohur.

1 **Gjeje shumëzuesin e panjohur X.**

a) $X \cdot 56 = 2\,688$ b) $72 \cdot X = 1\,080$ c) $X \cdot 37 = 740$
ç) $48 \cdot X = 1\,104$ d) $147 \cdot X = 5\,145$ dh) $X \cdot 28 = 4\,480$

2 **Gjeji të panjohurat a dhe b.**

a) $a \cdot 48 = 3\,000 - 360$ b) $(39 + 28) \cdot b = 536 : 2$

3 **Cili numër duhet të zmadhohet 8 herë që të fitohet numri 1 000?**

4 **Shuma e numrave 6 dhe 8 e zmadhuar disa herë është e barabartë me ndryshimin e numrave 1 000 dhe 188.**

5 **Formo detyrë tekstuale e cila zgjidhet me barazimin $5 \cdot X = 100$.**

Nëse numri i panjohur zvogëlohet 30 herë fitohet numri 45. Cili është numri i panjohur?

$X : 30 = 45$
$X = 45 \cdot 30$
$X = 1\,350$

Kontrolli: $1\,350 : 30 = 45$

$X \xrightarrow{:30} 45$
$X \xleftarrow{\cdot 30} 45$

Numrin e panjohur e shënojmë me X ose me ndonjë tjetër shkronjë
Fitojmë barazim
$X : 30 = 45$
me të panjohurën X
E panjohura te barazimi është i pjesëtueshmi. Të pjesëtueshëm të panjohur gjejmë kur herësin do ta shumëzojmë me pjesëtuesin.

6 **Gjej të panjohurën X.**

a) X : 18 = 17 b) X : 79 = 39 c) X : 21 = 98

ç) X : (10: 2) = 345 d) X : (140 : 70) = 85 – 67

7 **Sajmiri ka menduar një numër. Nëse atë numër e pjesëton me 35 dhe herësin e fituar e zmadhon për 180 do të fitohet 600. Cilin numër e ka menduar Sajmiri?**

8 **Cili numër duhet të zvogëlohet 7 herë që të fitohet numri 142.**

9 **Njehso të pjesëtueshmin nëse pjesëtuesi është 34, por herësi është numri i njëjtë i shkruar me shifra në rendin e anasjelltë.**

Nëse numrin 440 e zvogëlojmë numër herë të panjohur, fitohet numri 8. Cili është numri i panjohur?

440 : X = 8
X = 440 : 8
X = 55

Kontrolli: **440 : 55 = 8**



Numrin e panjohur e shënojmë me X ose me ndonjë tjetër shkronjë.
Fitojmë barazim
440 : X = 8
me të panjohurën X
E panjohura te barazimi është pjesëtuesi. Pjesëtuesin e panjohur e gjejmë kur të pjesëtueshmin e pjesëtojmë me herësin.

10 **Njehso të panjohurën X.**

a) 8 008 : X = 143 b) 420: X = 84 c) 3 600 : X = 200 ç) 36 : X = 254 – 248

11 **I pjesëtueshmi është 810, por herësi është 9. Sa është pjesëtuesi?**

12 **I pjesëtueshmi është numri 2 088, por herësi është numri 58. Sa është pjesëtuesi?**

13 **Prej një kopshti janë mbledhur 4 500 shporta me pjeshka. Shportat kanë qenë të ndara në disa shitore. Çdo shitore ka marrë nga 180 shporta. Në sa shitore janë ndarë shportat me pjeshka?**

14 **Gjeje të panjohurën.**

a) 5 044 : c = 26 · 2 b) (5 000 - 8) : f = 3 · 13 c) (8 610 · 2) : a = 100 - 16

Tema 3

KSHFRYTËZIMI I RENDITJES SË OPERACIONEVE TE SHPREHJA NUMERIKE ME KLLAPA DHE PA KLLAPA

Tina dhe Orhani kanë zgjidhur detyra.Shprehjen numerike 6 + 12 : 2 e kanë zgjidhur në mënyra të ndryshme. Cili e ka zgjidhur saktë?

Tina 6 + 12 : 2 = 18 : 2 = 9

Orhani 6 + 12 : 2 = 6 + 6 = 12

Shpesh ndodh në disa shprehje numerike të paraqiten më shumë operacione. Tek ato shprehje është e rëndësishme operacionet të kryhen sipas rendit të drejtë. Rendi i kryerjes së operacioneve është ky:

1. Kllapa
2. Shumëzimi dhe pjesëtimi
3. Mbledhja dhe zbritja

Rezultati pas kryerjes së gjithë operacioneve te shprehja numerike quhet **vlera e shprehjes numerike.**

6 + 12 : 2 =
= 6 + 6
= 12

Së pari pjesëtojmë, pastaj mbledhim.

16 : 4 · 2 =
=4 ·2
= 8

Pjesëtimi dhe shumëzimi kanë rëndësi të njëjtë, pra fillojmë prej të majtës.

(24 – 9) + 4 • 3 =
= 15 + 4 • 3
= 15 + 12
= 27

Së pari e njehsojmë shprehjen në kllapa. Shumëzojmë para se të mbledhim

1 **Njehso:**

a) 155 + 78 : 3 =
b) 624 – 65 : 5 =
c) 120 + 300 : 2 – 4 · 35 – 50 =
ç) 24 – (16 + 4 · 3) : 7 e
d) 5 · 12 : 3 =
dh) 45 – 5 ·3 – 24 : 6 =
e) (400 + 900 + 160) – 80 – 3 · 50 =
ë) 890 : 10 · 3 + 927 : 9 =

2 **Vendo kllapa te këto barazime që të jenë të sakta:**

a) 6 · 9 – 5 = 24
b) 9 – 8 · 23 = 23
c) 3 + 30 • 2 = 63
ç) 23 – 18 – 5 · 7 = 0

3 **Herësin e numrit 628 dhe 4 zmadhoje për prodhimin e tyre.**

4 **Prodhimin e numrave 80 dhe 9 zvogëloje për herësin e numrave 360 dhe 9. Cilin numër e fitove?**

5 **Formo detyrë tekstuale sipas figurave duke zbatuar më shumë operacione**

400 denarë

200 denarë

100 denarë

6 **Në një pyll jetojnë 198 kaproj dhe 4 herë më shumë drenusha, por ketra për 576 më pak se drenusha. Sa kafshë jetojnë në pyll?**

NJEHSIMI I VLERS SË SHPREHJES ME TË PANJOHUR

Ta shqyrtojmë detyrën:
Në një qese ka numër të panjohur të bonboneve. Në qese shtohen dy bonbone. Sa bonbone ka tani në qese?
Zgjedhim shkronjën n që ta paraqesim numrin e panjohur të bonboneve.

n – numri i panjohur i bonboneve
n – e quajmë të panjohur

n + 2 = ?
Nëse vlera e ndryshores n = 34:
Zëvendësojmë: 34 + 2 = 36

n = 34

Emri i ndryshores

Vlera e ndryshores

Zëvendësimi te shprehja është mënyra tek e cila shkronjat te shprehja e dhënë i zëvendësojmë me vlerat e dhëna.

E shkruajmë këtë fjali me shprehje:

Fillo me numrin n, shumëzo me 2, kurse pastaj shto 5.

Shprehjen e shkruajmë në mënyrë të rregullt:
Fillimi: n
Shumëzimi n me 2: 2n
Shtojmë 5: 2n + 5
Nëse n = 4, përcaktoni vlerën e shprehjes. $2 \cdot n + 5 = 2 \cdot 4 + 5 = 8 + 5 = 13$

1 **Njehso vlerën e këtyre shprehjeve kur n = 6.**

a) $3 \cdot n + 125 =$ b) $36 : n + 28 \cdot 3 =$ c) $128 \cdot n + 312 : n =$ ç) $822 : 3 \cdot n =$

2 **Nëse a = 3, b = 4, c = 5, cakto vlerën e këtyre shprehjeve.**

a) $7 \cdot a + c$ b) $4 + 2 \cdot b$ c) $a \cdot b : 6 =$ ç) $8 + a \cdot 5 =$

3 **Njehso vlerën e këtyre shprehjeve kur a = 10.**

a) $980 : a + 353 \cdot 2 =$ b) $452 \cdot 2 - 2\,430 : a =$ c) $272 : 8 \cdot a \cdot a =$

Tema 3

ZGJIDHJA E DETYRAVE TEKSTUALE

Hapat te zgjidhja e detyrave tekstuale.

Me kujdes lexoje detyrën disa herë. Mendo dhe vendos cilin operacion do ta shfrytëzosh. Vlerëso sa duhet të fitosh si rezultat të fundit.Zgjidhe detyrën.
Kryej njehsimet e nevojshme. Shkruaje përgjigjen e kërkesës së detyrës.



1 **Ndryshimin e numrave 100 dhe 45 zmadhoje për prodhimin e numrave 30 dhe 6**

2 **Prodhimin e numrave 12 dhe 4 zvogëloje për shumën e numrave 15 dhe 7.**

3 **Në bibliotekën e shkollës librat janë radhitur në 9 vitrina, në çdo vitrina ka pasur nga tre rafte. Te rafti i parë ka pasur 15 libra, tek i dyti 3 libra më pak se tek i pari, kurse te rafti i tretë ka pasur dy herë më shumë se te rafti i parë dhe i dytë së bashku. Sa libra gjithsej ka pasur në bibliotekën e shkollës?**

4 **Në ekskursion kanë udhëtuar 66 fëmijë, të cilët duhej të vendosen në 8 furgonë**
Nga sa fëmijë janë vendosur në çdo furgon?
A do t'i nxërë të gjithë fëmijët në 8 furgona? Pse?

5 **Marku ka 130 denarë. Babai i ka dhënë edhe 200 denarë, por t'i ndaj me vëllain e vet. Marku ka blerë 4 akullore nga 35 denarë dhe një çokolatë për 20 denarë. Sa denarë i kanë ngelur Marku?**

6 **Në shkollë janë sjellë 750 fidanë. Prej tyre çdo grup duhet të mbjellë nga 30 fidanë.**
a) Sa grupe ka pasur?
b) Çdo fidanë kushton 35 denarë. Sa kushtojnë të gjitha fidanët?
c) Në shkollë ka pasur 300 nxënës. Nga sa nxënës do të jenë radhitur në çdo grup?

7 **Cakto numrin që gjatë pjesëtimi me:**
a) 28 jep herës 156 dhe mbetje 10
b) 36 jep herësin 36 dhe mbetjen 6

8 **Prej një gypi rrjedhin 248 litra ujë për 4 minuta, por prej gypit tjetër 243 litra për 3 minuta.**
a) Sa ujë rrjedh prej çdo gypi për 1 minutë?
b) Sa ujë rrjedh nëpër të dy gypat për 5 minuta?

THYESA
PËRSËRITJE PËR THYRSAT

Të përkujtojmë!

Në vizatim është paraqitur një banderole e ndarë në tri pjesë të barabarta. Dy prej tyre janë ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër. Të dyja të ngjyrosura në krahasim me tri pjesët e barabarta paraqiten me shënimin $\frac{2}{3}$ që quhet thyesë.

$\frac{2}{3}$

Numërues

Vija thyesore

Emërues

Lexojmë: dy të tretat

Tregon sa pjesë prej gjithë tërësisë së ngjyrosur.

Tregon në sa pjesë të barabarta është ndarë tërësia.

Numëruesi 2 është më i vogël se emëruesi 3, që na tregon se te thyesa $\frac{2}{3}$ nuk ka 1 të plotë. Thyesat e këtilla te të cilat numëruesi është më i vogël se emëruesi quhen thyesa të rregullta. Ja disa thyesa të rregullta $\frac{4}{7}$ $\frac{5}{9}$ $\frac{3}{4}$ $\frac{1}{2}$ $\frac{8}{9}$ $\frac{5}{9}$

1 Milena ka çokolatë. Ajo Ristes i ka dhënë prej $\frac{1}{4}$ çokolatës, Simonës $\frac{1}{3}$ dhe një të gjashtën Sihanës. Mbetjen e çokolatës e ka ngrënë ajo. Nga sa copa ka ngrënë çdonjëra prej tyre? Shkruaje përgjigjen për çdonjërin prej fëmijëve.

Riste ka ngrënë _____

Simona ka ngrënë _____

Sihana ka ngrënë _____

Milena ka ngrënë _____

Çfarë pjese të çokolatës ka ngrënë Milena? _____

2 **Shiritin e dhënë ndaje në:**

a) gjysma. Sa gjysma ka në njërin shirit?

b) të katërta. Sa të katërta ka në një shirit të plotë?

c) të tetat. Sa të tetat ka në njërin shirit të plotë?

Bëni diskutim rreth vizatimit të fituar. Çfarë vëreni?

Pjesët e barabarta të trekëndëshit

4 Trekëndëshi i bardhë është ndarë në tri pjesët të barabarta. Ngjyros çdo të tretën me ngjyrë të ndryshme. A mundesh të tregosh se ato pjesë janë të barabarta? Mendo sikurse.

Tani përpiqu të bësh tri pjesë të barabarta prej këtij trekëndëshi, por në mënyrë tjetër. Ngjyros çdo të tretën me ngjyrë të ndryshme





Vlerëso dhe qëllo

5 Çfarë pjese prej çdo figure është ngjyrosur?
(Së pari vlerëso, pastaj jep përgjigjen, por në fund bëje provën).



Cili i pari do ta ngjyrosë rrethin?

6 Aktiviteti punohet në grup prej 4 lojtarëve. Çdo lojtar duhet të bëjë rreth si te figura.
Çdo pjesëmarrës duhet të bëjë 15 kartela nga letra te të cilat do të shkruajëi këto thyesa:

$\frac{1}{2}$ $\frac{1}{3}$ $\frac{1}{4}$ $\frac{1}{6}$ $\frac{1}{12}$ $\frac{3}{12}$ $\frac{4}{12}$ $\frac{5}{12}$ $\frac{6}{12}$

$\frac{7}{12}$ $\frac{8}{12}$ $\frac{9}{12}$ $\frac{10}{12}$ $\frac{11}{12}$ $\frac{12}{12}$



Përzieni kartelat dhe vendosni në mes të kthyera që të mos shikohen thyesat. Loja mund të fillojë.

Lojtari i parë tërheq kartelë dhe e ngjyros pjesën e rrethit të tij sipas kartelës së tërhequr, kurse pastaj e kthen kartelën te grumbulli. Pastaj lojtari tjetër e përsërit mënyrën. Fituesi në lojë është ai i cili i pari do ta ngjyrosë rrethin

a) Cili fitoi në lojë?
b) Cilat janë kartelat fituese?
c) Çdo lojtart'i shkruajë kartelat e tij!
ç) Në cilën pjesëtë rrethit patët sukses ta ngjyrosni? Çfarë pjese të rrethit ngel për ngjyrosje?

7 **Sipas diagramit të dhënë rretho përgjigjen e saktë.**

1) Pjesa për sallatë është paraqitur me thyesat:

a) $\frac{1}{8}$ b) $\frac{2}{8}$ c) $\frac{4}{8}$ ç) $\frac{5}{8}$

2) Pjesa për akullore është paraqitur me thyesën:

a) $\frac{1}{8}$ b) $\frac{2}{8}$ c) $\frac{4}{8}$ ç) $\frac{5}{8}$

3) Pjesa e hamburgerit është paraqitur me thyesën:

a) $\frac{1}{8}$ b) $\frac{2}{8}$ c) $\frac{4}{8}$ ç) $\frac{5}{8}$

8 **Shqyrto diagramin.**

a) Shkruaj thyesë me të cilën do t'i paraqesësh katrorët e zinj _____.

b) Shkruaj thyesë me të cilën do t'i paraqesësh katrorët e bardhë _____.



9 **Përdore diagramin për t'u përgjigjur në pyetjet:**

a) Shkruaj thyesë me të cilën do ta paraqesësh numrin e drejtkëndëshave te diagrami i dhënë.

b) Shkruaj thyesë me të cilën do ta paraqesësh numrin e trekëndëshave te diagrami i dhënë.

c) Shkruaj thyesë me të cilën do ta paraqesësh numrin e rrathëve te diagrami i dhënë.

ç) Shkruaj thyesë me të cilën do ta paraqesësh numrin e emotikoneve të buzëqeshur te diagrami i dhënë?

A mund të zbulosh mënyrë tjetër për paraqitjen e emotikoneve me fat përveç asaj që e paraqite paraprakisht.

10 **Në një shitore ka 7 shporta me mollë, 12 shporta me portokallë, 5 shporta me dardha dhe 1 shportë me qershi. Paraqiti me thyesë shportat me:**

a) qershi b) portokaj c) molla dhe dardha së bashku

_____ _____ _____

11 **Bëni skema të ndryshme me paraqitje të thyesës me ngjyrosje të tre katrorëve të tjerë B, C dhe D. Për shembull është paraqitur një mënyrë e paraqitjes së thyesës, ju bëni të tjerat sipas mendimit tuaj.**
Çfarë pjese prej rrjetës së katrorit ke ngjyros?
Çfarë pjese prej skemës ka ngelur e bardhë?
Shkruaj përgjigjen nën çdonjërin prej katrorëve të ofruar



Shqyrtoni përsëri skemën A. Skema a është ngjyrosur: ☑ ☒

a) $\frac{1}{2}$ e kaltër, $\frac{1}{2}$ e bardhë? ☐ b) $\frac{2}{4}$ e kaltër, $\frac{2}{4}$ e bardhë? ☐

c) $\frac{3}{8}$ e kaltër , $\frac{5}{8}$ e bardhë? ☐ ç) $\frac{4}{8}$ e kaltër, $\frac{4}{8}$ e bardhë? ☐

Shëno (x) te përgjigja e gabuar.

13 **Kopshti i xhaxhait Rami ka dhjetë pjesë të barabarta. Cilat pemë i kultivon ai?**



a) Cila pemë kultivohet në pjesën më të madhe të kopshtit? Shkruaje me thyesë atë pjesë?

b) Në cilën pjesë të kopshtit ai kultivon patate?

c) Cila pjesë e kopshtit shfrytëzohet për kultivimin e spinaqit?
Cila pjesë shfrytëzohet për domate të zeza?

ç) Tani bëhuni kreativ dhe shkruaj disa pyetje për figurën.

d) Xhaxhai Riste dëshiron të ndajë patatet dhe domatet. Ai nipit Adam i ka dhënë $\frac{1}{5}$ prej domateve dhe $\frac{1}{3}$ prej patateve. Sara ka $\frac{2}{5}$ marrë prej domateve dhe prej patateve, por, Nevena ka marrë mbetjen prej perimeve. Rretho pjesën e Adamit me ngjyrë të kaltër, por pjesën e Sarës me ngjyrë të verdhë.

THYESA EKUIVALENTE – PËRSËRITJE

Të përsërisim dhe të përkujtojmë!

1 **Ana, Marku dhe Mersiha i kanë ngjyrosur format e tyre si te vizatimi.**

Ana



Marku



Mersiha



a) Shkruaji me thyesa pjesët që i ka ngjyrosur çdonjëri prej tyre.
b) Krahasoji madhësitë e pjesëve të ngjyrosura te tre shokët.
c) Çfarë mendon si janë paraqitur thyesat?

2 **Në fletë të letrës vizato drejtkëndësh me brinjë 10 cm dhe 9 cm dhe ndaji si te figura. Pastaj ngjyrosi dhe preje pjesën e njyrosur. Vendosi të dy pjesët e ngjyrosura të prera njërën mbi tjetrin.**

a) Çfarë vërejtët? A ju pëlqen?
b) Shkruaj me thyesë pjesët e ngjyrosura prej diagrameve.





c) Bëni skemën tuaj me ndarje, përsëri prejeni dhe vendosni njërën mbi tjetrën dhe krahasoni pjesët e ngjyrosura. A ju pëlqen?
Nëse jo, pse ajo është ashtu?
Nëse ju pëlqen, atëherë pse ndodh ajo?

3 **Përsëritni kërkesat prej detyrës paraprake me rrethin te figura dhe diskutoni.**





4 **Vendos para teje dy mure prej thyesave si te figura. Mundesh ta fotokopjosh këtë mur.**
Pastaj njërin mur preje sipas vijave dhe vepro sipas kërkesave

a) Vendose shiritin $\frac{1}{2}$ në vendin e vet mbi murin e papastër, kurse pastaj mbi atë vendose njërin pranë tjetrit $\frac{1}{4}$ dhe prapë $\frac{1}{4}$.

b) Tani mbi shiritat e shënuar me $\frac{1}{4}$ vendos $\frac{1}{8}$ përsëri $\frac{1}{8}$ dhe ashtu deri sa nuk e mbulon shiritin me $\frac{1}{8}$.

Çka vëren? A puthiten të gjitha pjesët dhe paraqesin madhësi të njëjtë?

c) A mundesh të gjesh tjetër thyesë që saktë do ta mbulojnë shiritin $\frac{1}{2}$ si të parat?

ç) Mendo vetë disa eksperimente të këtilla me tjetër shirit. (Për shembull $\frac{1}{3}$ me $\frac{1}{9}$



5 **Çfarë zbuluam?**

$\frac{1}{2} = \frac{2}{4} = \frac{3}{6} = \frac{4}{8} = \frac{5}{10} \dots$ $\frac{1}{3} = \frac{2}{6} = \frac{3}{9} = \frac{4}{12} \dots$

Për këto thyesa thuhet se janë ekuivalente pasi të gjitha na tregojnë madhësinë e njëjtë.

Si të zbulojmë kur dy thyesa janë ekuivalente?



$\frac{1}{3}$



$\cdot 2$

$\frac{1}{3} = \frac{2}{6}$

$\cdot 2$



$\cdot 3$

$\frac{1}{3} = \frac{3}{9}$

$\cdot 3$



$\frac{5}{9}$



$\cdot 2$

$\frac{5}{9} = \frac{10}{18}$

$\cdot 2$



$\cdot 3$

$\frac{5}{9} = \frac{15}{27}$

$\cdot 3$

Çdo thyesë mund të shndërrohet në thyesë ekuivalente nëse edhe numëruesi edhe emëruesi shumëzohen me një numër të njëjtë

$\cdot 2$

$\frac{3}{4} = \frac{6}{8}$

$\cdot 2$

Numëruesi shumëzohet me 2

Emëruesi shumëzohet me 2

$\cdot 3$

$\frac{3}{4} = \frac{9}{12}$

$\cdot 3$

Numëruesi shumëzohet me 3

Emëruesi shumëzohet me 3

5 **Diagrami i parë e paraqet thyesën 16/20. Për ta fituar diagramin e dytë i fshijmë dy horizontale si te figura. Madhësia e pjesës së ngjyrosur nuk do të ndryshojë.**



$\frac{16}{20}$



+ 2

Domethënë

$\frac{16}{20} = \frac{8}{10}$



$\frac{20}{30}$



$\frac{20}{30} = \frac{10}{15}$



Çdo thyesë mund të shndërrohet në thyesë ekuivalente nëse edhe numëruesi edhe emëruesi pjesëtohen me një numër të njëjtë.

$\frac{8}{16} \overset{:2}{=} \frac{4}{8}$

Numëruesi i pjesëtuar me 2

Emëruesi i pjesëtuar me 2

1 Cili numër duhet të qëndrojë në vendin e pikëpyetjes që thyesat e dhëna të jenë ekuivalente?

a) $\frac{1}{2} = \frac{?}{6}$ $\quad \frac{1}{4} = \frac{?}{12}$ $\quad \frac{3}{5} = \frac{?}{10}$

b) $\frac{1}{3} = \frac{?}{6}$ $\quad \frac{8}{10} = \frac{?}{5}$ $\quad \frac{2}{6} = \frac{?}{12}$

c) $\frac{1}{4} = \frac{?}{8}$ $\quad \frac{2}{5} = \frac{?}{10}$ $\quad \frac{2}{6} = \frac{?}{12}$

ç) $\frac{1}{5} = \frac{?}{10}$ $\quad \frac{3}{4} = \frac{6}{?}$ $\quad \frac{3}{6} = \frac{6}{?}$

d) $\frac{1}{3} = \frac{?}{9}$ $\quad \frac{2}{10} = \frac{?}{5}$ $\quad \frac{3}{4} = \frac{?}{12}$

2 Në skajet e rrjetës së merimangës shkruaj thyesat ekuivalente për çdonjërën prej thyesave të dhëna.



3 Gjeji thyesat që janë ekuivalente dhe ngjyrosi me ngjyrë të njëjtë.

$\frac{1}{3}$	$\frac{1}{4}$	$\frac{2}{5}$	$\frac{3}{12}$
$\frac{3}{9}$	$\frac{4}{16}$	$\frac{2}{6}$	$\frac{4}{10}$
$\frac{6}{24}$	$\frac{5}{15}$	$\frac{6}{18}$	$\frac{5}{20}$
$\frac{10}{25}$	$\frac{8}{20}$	$\frac{7}{21}$	$\frac{12}{30}$

4 **Shqyrto figurën.Çfarë pjese prej shiriti është çdo copë e gjelbër?**

Shkruaje pjesën për çdonjërën copë prej çdo ngjyre. Sa të katërtat janë të nevojshme për të bërë gjysmën?
Sa të tetat do të bëjnë të katërtat?
Sa të gjashtëmbëdhjetat ka te gjysma?
Parashtroni disa pyetje për figurën?



5 **Shqyrtoni katrorin.**

Çfarë pjese prej saj është ngjyrosur me ngjyrë të kaltër?
Çfarë pjese është ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër?



6 **Agimi ka thënë se një gjysmë prej gjysmës dhe një e treta prej tre të katërtave janë të barabarta. Agimi a ka të drejtë? Si do ta kontrollojmë këtë? Përpiqu të bësh skemë si te detyra paraprake.**

7 **Cila prej këtyre thyesave NUK ËSHTË ekuivalente me zonën e vijëzuar**

a) $\frac{9}{12}$ b) $\frac{18}{24}$

c) $\frac{16}{20}$ ç) $\frac{6}{8}$



8 **Cila prej thyesave është ekuivalente me zonën e bardhë (të pavijëzuar) te diagrami nga detyra paraprake?**

a) $\frac{6}{20}$ b) $\frac{9}{12}$ c) $\frac{12}{24}$ ç) $\frac{8}{32}$

Tregimi për mbretin Ben

Bilbil-këshilltari i mençur i mbretit Ben.

Bilbili është djalë i ri që ka jetuar në një fshat të largët në fund të mbretërisë së Benit. Ai ka qenë i mençur dhe ka mundur të shkruajë shumë poezi të bukura. Një ditë ka vendosur ta provojë fatin e tij në oborrin mbretëror. I ka mbledhur të gjitha këngët që i ka shkruar dhe është drejtuar në oborrin mbretëror. Kur arriti deri te muret e jashtme të pallatit ka qenë i ndaluar prej rojës së parë.

- Ndalu! Ku shkon! – ka bërtitur roja.
- Unë jam poet dhe dëshiroj të shihemi me mbretin Ben që t'i tregojë vjershat e mija – u përgjigj poeti.
- –„Nëse me të vërtetë je poet, mbreti dëshiron poezi dhe me siguri do të të shpërblejë. Prandaj, unë do të lëshoj në oborr nëse më jep (dropka) e shpërblimit tënd”. .

Bilbili i ri u pajtua pasi që nuk kishte zgjedhje tjetër. Kur ai hyri në oborr, roja njehsoi. „Nëse ai marr 100 florinj unë do të fitoj _____ florinj

Poeti erdh deri te dera e dytë dhe te roja.

Roja gjithashtu i tha: „unë do të lëshoj Brenda vetëm nëse më jep dy të pestat e shpërblimit jote”. Poeti i ri u pajtuar.

Roja me gëzim i fërkoi duart dhe tha: „poeti do të marrë më së paku 100 florinj, prandaj do të fitoj _____ florinj!“ Edhe ashtu poeti arriti deri te dera e fundit, ku përsëri roja i tha: „do të lejoj të shikosh mbretin vetëm nëse më jep gjysmën e shpërblimit tënd që do ta fitosh”. Poeti nuk ka pasur zgjedhje tjetër.

Është pajtuar dhe hyri te hapësirat mbretërore. Roja me gëzim filloi të qeshë dhe mendoi: „Sot është ditë e mrekullueshme. Nëse ai fiton 100 florinj unë do të fitoj _____ florinj, por nëse ai fiton 1 000 florinj – ua, unë do të fitoj _____ florinj!“

Mbreti ka qenë i kënaqur prej poemave të poetit të cilat shumë e kanë disponuar dhe tha: „Puna jote është shumë e mire. Aq e mire që mundesh të dëshirosh çfarëdo shpërblimi.“ „Mbreti im, unë dua të mbjell 100 drunj”. „Çka! 100 drunj? _____”. Mbreti ka qenë shumë i habitur prej poetit të ri?

- **Çfarë mendoni se ndodhi më pas?**
- **Mbaroni tregimin.**
- **Sa pemë mbolli poeti, kurse nga sa të tre rojet?**

Mentori ka 18 euro. Kavendosur $\frac{1}{6}$ e parave t'i japë vëllait të tij më të ri. Sa euro i ka dhënë vëllait?

T'i paraqesim paratë me një shirit drejtkëndor.



Çdo ditë e paraqet thyesën $\frac{1}{6}$ dhe në çdo pjesë ka nga 3 euro.

Domethënë, vëllau i Mentorit ka marrë 3 euro, përkatësisht $\frac{1}{6}$ e 18 euro janë 3 euro.

Si mund ta fitojmë këtë? $18 : 6 = 3$

Çka do të ndodhe nëse duhej t'i jepte $\frac{5}{6}$ e parave.

Është e thjeshtë, e dimë se $\frac{1}{6}$ janë 3 euro, pra $\frac{5}{6}$ do të jetë $5 \cdot 3 = 15$ euro



Gjyshja Nada duhet të qepë perde për dritaren e shtëpisë së saj. Pjesa e perdes që e ka pasur në shtëpi është me gjatësi 252 cm. Ajo ka përdorur $\frac{4}{9}$ e saj, mbetjen e ka ruajtur për herën tjetër. Sa cm prej perdes ka përdorur gjyshja Nada për të qepur perden e dëshiruar?

Nëse kjo është perdja atëherë në sa pjesë të barabarta duhet ta ndajmë? Në 9 pjesë të barabarta. Nga sa cm do të jetë çdonjëra prej pjesëve?

$$252 : 9 = 28$$

Sa pjesa të atilla janë të nevojshme për qepjen e perdes?

4 Pjesë.

Gjyshja Nada ka përdorur $4 \cdot 28 = 112$ cm prej pjesës së perdes.

ZGJIDHJA E DETYRAVE

1 a) $\frac{1}{5}$ e 35 është b) $\frac{1}{4}$ e 36 është... c) $\frac{1}{2}$ e 72 është... ç) $\frac{1}{6}$ e 96 është

2 a) $\frac{2}{7}$ e 49 është b) $\frac{3}{4}$ e 84 është... c) $\frac{2}{3}$ e 153 është... ç) $\frac{5}{8}$ e 464 është..

3 **E dimë se 1 m = 100 cm njehso sa është**

a) $\frac{3}{5}$ e 1 m b) $\frac{3}{4}$ e 1 m c) $\frac{1}{25}$ nga 1 m ç) $\frac{13}{20}$ nga 1 m

4 **Një ditë dhe një natë ka 24 orë. Nëse Ilirjana mëson $\frac{1}{6}$ të ditë-natës, atëherë sa minuta mëson Ilirijana çdo ditë? Nëse Ilirijana çdo ditë njëlloj përveç ditës së diel atëherë sa orë do të mësojë për 1 muaj? (Merrni muajin me 30 ditë).**

5 **Ngjyros $\frac{1}{3}$ e kësulave me ngjyrë të kuqe. Ngjyros tre të pestat e kësulave me ngjyrë të kaltër.**

Sa kësula ngjyrosi me ngjyrë të kuqe?

Sa kësula ngjyrosi me ngjyrë të kaltër?

Çfarë pjese e kësulave nuk janë ngjyros?

6 **A keni dëgjuar për Klimen, vëllain e Ristes? Ai është i njohur për atë që ka fjetur gjysmë viti.**

Pjesa më e madhe e njerëzve flenë rreth 8 orë në ditë.
Çfarë pjese e ditës është ajo? _____ (sqaroje përgjigjen).
Në këtë mënyrë çfarë pjese e një viti ata flenë? Nëse një njeri ka 60 vjet, kjo do të thotë se ai ka fjetur përafërsisht _____ vjet.

7 Lista për blerje

a) Sa kushtojnë 2 kg domate?

b) Sa kushtojnë gjysmë kilogram domate?

c) Kastrioti dëshiron të blejë $2\frac{1}{2}$ kilogram domate. Sa duhet të paguajë për ato?

ç) *Sa kushtojnë $3\frac{1}{2}$ kilogram patate?*

d) Sa kushtojnë $1\frac{1}{4}$ karrota?

dh)) Besniku ka blerë kungull masa e të cilit ka qenë $3\frac{3}{4}$ kilogramë. Për atë ka paguar _____?

e) Sa duhet të paguajë për përbërjet prej listës?

ë) Bëni listën personale për blerje dhe cakto sa para janë të nevojshme për të paguar për ato?

8 Tabela e kohës së Martinit.

Përdor ngjyra të ndryshme për të ngjyrosur.

Fjetje $\frac{1}{3}$ e ditës

a) Lojë $\frac{1}{8}$ e ditës

b) Mësim $\frac{1}{4}$ e ditës

Fjetje? ☐

Lojë? ☐

Mësim? ☐

9

$\frac{1}{3}$ e numrit tim është 9.
Cili është numri im?

$\frac{1}{4}$ e numrit tim është 7.
Cili është numri im?

$\frac{1}{10}$ e numrit tim është 30.
Cili është numri im?

$\frac{1}{20}$ e numrit tim është 40.
Cili është numri im?

Tregimi për mbretin Ben

Djali Bilbil dhe mbreti Ben

Kujtohuni për djalin Bilbil prej tregimit me florinjtë? Ai djalë u bë këshilltar i mbretit Ben për shkak të vjershave të bukura të cilat i shkruante. Por, një ditë mbreti u sëmurë. Erdhi mjeku i oborrit dhe tha:

– Mbreti çdo ditë duhet të pije çaj prej kamomili, çaj prej nanexhiku dhe çaj prej trumze. Por, të jeni të kujdesshëm, ai nuk duhet të pijë më shumë çaj prej nenexhiku e prej çajit të kamomilit, por më së shumti duhet të pijë çaj trumze.

Punëtorët e oborrit i kanë mbledhur çajet, kurse pastaj kuzhinieri tek oborri i mbretit ka përgatitur prej të gjithëve nga 1 litër. I ka zgjedhur gotat më të bukura të oborrit, të kuqen me hënën në atë, të verdhën me flutur dhe të kaltrën me diell dhe filloi t'i pije çajet.

Në gotën e kuqe ai ka futur $\frac{3}{4}$ e çajit prej trumzës, tek e verdha $\frac{1}{2}$ e çajit të nanexhikut, kurse te e kaltra $\frac{5}{8}$ e çajit të kamomilit.

Bilbili të cilën gjithë këtë e ka vërejtur nga këndi i tij në dhomë tha:

– A jeni të sigurt se çajin e përgatitët sipas porosive të mjekut?

Edhe atëherë janë menduar Bilbili dhe kuzhinieri. A kanë vepruar drejt? Kujtohu se si të kontrollosh se kuzhinieri a e ka renditur çajin drejt.



trumza nanexhik kamomil

- **Nëse kuzhinieri gabon, mendo dhe jep propozim se si duhet të futet çaji.**

AKTIVITET

Vizato dy drejtkëndësha të barabartë dhe ndaje njërin në të katërtat, por tjetrin në të tetat. Prej njërit ngjyros $\frac{3}{4}$ por prej tjetrit $\frac{5}{8}$. Preji pjesët e ngjyrosura dhe vendo njërin mbi tjetrin. Cila pjesë është më e madhe?

$\frac{3}{4}$ [=] $\frac{6}{8}$

$\frac{5}{8}$ [<] $\frac{6}{8}$

ZGJIDHJA E DETYRAVE

1 Vendo njërën prej shenjave >, = ose < që të fitosh gjykim të saktë.

a) $\frac{1}{5}$ ☐ $\frac{3}{5}$ b) $\frac{5}{12}$ ☐ $\frac{5}{6}$ c) $\frac{11}{25}$ ☐ $\frac{23}{50}$ ç) $\frac{4}{9}$ ☐ $\frac{7}{18}$

2 Cila prej këtyre thyesave është më e madhe?

a) $\frac{5}{9}$ b) $\frac{1}{3}$

c) $\frac{11}{18}$ ç) $\frac{5}{6}$

3 Radhiti këto thyesa prej më të voglës deri te më e madhja.

a) $\frac{7}{9}, \frac{4}{9}, \frac{2}{9}, \frac{8}{9},$

b) $\frac{6}{20}, \frac{5}{10}, \frac{3}{4}, \frac{3}{5},$

4 Martinit ka ngrënë $\frac{1}{8}$ e copës së gurabisë që ia ka dhënë gjyshja Milka. Por motra e saj $\frac{7}{16}$ e copës së njëjtë. Cila prej tyre ka ngrënë copën më të madhe të gurabisë?

5 Katër shokë kanë shkuar për pica dhe kanë porositur pica të njëjta. Iliri ka ngrënë $\frac{1}{3}$ e picës së tij, Mile ka ngrënë $\frac{1}{6}$, Ana ka ngrënë $\frac{1}{2}$ e picës, por Petriti $\frac{7}{12}$. Cili ka ngrënë pjesën më të madhe prej picës së tij?

6 Plotësoji vendet për emërues ashtu që gjykimi të jetë i saktë.

$\frac{2}{5} < \frac{2}{☐}$

Mendo dhe përgjigju:
Detyra a ka vetëm një zgjidhje?

7 Plotësoji vendet për numërues ashtu që gjykimi të jetë i saktë.

$\frac{5}{10} < \frac{☐}{10}$

Mendo dhe përgjigju:
Sa numra të atillë mund të gjesh?

8 Cilat prej këtyre thyesave janë ndërmjet 0 dhe $\frac{1}{2}$

a) $\frac{2}{6}$ b) $\frac{2}{5}$

c) $\frac{9}{15}$ ç) $\frac{9}{10}$

9 Cilat prej këtyre thyesave janë më të vogla se $\frac{5}{8}$

a) $\frac{3}{8}$ b) $\frac{8}{12}$

c) $\frac{5}{6}$ ç) $\frac{21}{24}$

Tregimi për mbretin Ben

Djali Bilbil dhe mbreti Ben

Edhe ashtu tregimi ynë për mbretin Ben dhe djalin Bilbil do të vazhdojë duke ju falënderuar juve, fëmijë, pasi drejt e caktuat dozën e çajeve që duhej t'i pijë mbreti për t'u shëruar.

– Oh, sa ditë e bukur – i tha mbreti këshilltarit të tij, djali Bilbil.

– Do të dëshiroj të shëtisim në kopsht dhe atje të më lexosh ndonjërën nga vjershat tuaja të bukura.

– Kuptohet, mbreti im – u përgjigj Bilbili dhe së bashku dolën në kopsht. Por ai tani, plot me kujtime për lulet që mbreti i mbante nga udhëtimet e tij të largëta. U kujtua në Kinën e largët prej ku solli lule të cilat zinin $\frac{3}{4}$ e kopshtit, pra kaktusët e vyshkura prej shkretëtirës të cilat lëshojnë lule të bardhë të bukur dhe ishin të shpërndara në $\frac{1}{2}$ e kopshtit dhe shumë lule shtëpiake të mbjella në $\frac{5}{8}$ e kopshtit. Pjesa tjetër e kopshtit ishte bar i bukur.

– Bari ishte rritur për t'u kositur, – ka konstatuar mbreti.

– Thirre kopshtarin – i tha ai Bilbilit. Shpejt erdhi kopshtari. – Urdhëroni mbretëria juaj – u paraqit kopshtari. Mbreti i tha menjëherë ta kositë gjithë barin. Por, kopshtari u zemërua.

– Nuk është e mundur kjo, madhëria juaj, e dini se mund të lëviz më së shumti deri në (dropka) e kopshtit deri sa të perëndojë dielli, është shumë i madh nuk do të arrij!

– Mundesh, ka mjaft kohë! – i tha mbreti në mënyrë të inatosur

Cili është në të drejtë mbreti ose kopshtari?

AKTIVITET

Para jush keni kartelë me thyesa. Detyra juaj e parë është të zbuloni disa fjalë prej nga dy kartela dhe të bëni 1 të plotë, kurse pastaj gruponi nga tri kartela dhe përsëri të bëni 1 të plotë. Sa shuma të atilla zbuluat?

$\frac{1}{2}$ $\frac{1}{3}$ $\frac{2}{15}$ $\frac{3}{7}$ $\frac{1}{3}$ $\frac{9}{15}$ $\frac{11}{20}$ $\frac{1}{2}$

$\frac{1}{4}$ $\frac{1}{7}$ $\frac{9}{20}$ $\frac{4}{5}$ $\frac{1}{3}$ $\frac{4}{15}$ $\frac{4}{7}$

Te skema ngjyros 2 katror me ngjyrë të kaltër dhe 1 katror me ngjyrë të zezë. Sa katrorë ngjyrose?

Çfarë pjese janë të dy katrorët e kaltër në lidhje me gjithë skemën?
(shkruaje me thyesë)

$\frac{\square}{\square}$

Çfarë pjese janë të dy katrorët e kuq në lidhje me gjithë skemën?
(shkruaje me thyesë)

$\frac{\square}{\square}$

Çfarë pjese ngjyrose prej gjithë skemës?
(shkruaje me thyesë)

$\frac{\square}{\square}$

Dy thyesa me emërues të njëjtë mblidhen ashtu që i mbledhim numëruesit, por emëruesi ngel i pandryshuar.

$$\frac{3}{7} + \frac{2}{7} = \frac{3+2}{7} = \frac{5}{7},$$

Dy thyesa me emërues të njëjtë zbriten ashtu që i zbresim numëruesit, por emëruesi ngel i pandryshuar.

$$\frac{11}{15} - \frac{4}{15} = \frac{11-4}{15} = \frac{7}{15},$$

1 Njehso!

a) $\frac{3}{6}+\frac{2}{6}$ b) $\frac{4}{6}-\frac{3}{6}$

c) $\frac{5}{9}+\frac{3}{9}$ ç) $\frac{5}{8}+\frac{2}{8}$

2 Njehso!

a) $\frac{2}{5}+\frac{2}{5}$ b) $\frac{5}{7}-\frac{2}{7}$

c) $\frac{8}{10}-\frac{5}{10}$ ç) $\frac{4}{5}-\frac{2}{5}$

3 Për çdonjërën nga detyrat prej a) deri te ë) bëj skemë personale me të cilën do të tregosh mbledhjen dhe zbritjen e thyesave me emërues të njëjtë.
(mundesh të përdorësh drejtkëndësha, katrorë, rrathë...)

a) $\frac{2}{7}+\frac{3}{7}+\frac{1}{7}$ b) $\frac{2}{9}+\frac{3}{9}+\frac{1}{9}$ c) $\frac{1}{25}+\frac{13}{25}+\frac{5}{25}$

ç) $\frac{1}{50}+\frac{11}{50}+\frac{5}{50}+\frac{12}{50}$ d) $\frac{1}{20}+(\frac{13}{20}-\frac{11}{20})$ dh) $\frac{7}{12}+(\frac{7}{12}-\frac{2}{12})$

e) $(\frac{11}{30}-\frac{9}{30})+(\frac{9}{30}-\frac{3}{30})$ ë) $(\frac{13}{24}-\frac{9}{24})+(\frac{8}{24}-\frac{3}{24})$

4 Cila prej thyesave duhet të qëndrojë në vendin e shkronjës n?

$(\frac{2}{9}-\frac{1}{9})+\frac{4}{9}=\frac{2}{9}+(\frac{1}{9}+n)$ $\frac{3}{10}+(\frac{2}{10}+\frac{1}{10})=(\frac{3}{10}+n)+\frac{1}{10}$

5 Cili numër duhet të qëndrojë në vendin e shkronjës n?

a) $\frac{6}{21}+\frac{n}{21}=\frac{8}{21}$ b) $\frac{n}{13}+\frac{4}{13}=\frac{7}{13}$ c) $\frac{9}{23}+\frac{n}{23}=\frac{18}{23}$

ç) $\frac{n}{17}+\frac{8}{17}=\frac{15}{17}$ d) $\frac{n}{15}+\frac{11}{15}=\frac{14}{15}$ dh) $\frac{8}{25}+\frac{n}{25}=\frac{18}{25}$

6 Shumës të thyesave $\frac{33}{50}$ dhe $\frac{11}{50}$ shto thyesën $\frac{6}{50}$.

7 Ndryshimit të thyesave $\frac{23}{25}$ dhe $\frac{17}{25}$, shtoje thyesën $\frac{4}{25}$.

8 Dyfisho shumën e thyesave $\frac{72}{100}$ dhe $\frac{28}{100}$.

9 Për të fituar lëng prej portokalli Iliri ka përzier $\frac{3}{7}$ lëng të freskët të filtruar prej portokalli dhe $\frac{2}{7}$ ujë. Çfarë sasie të lëngut do të fitojë?

10 Për 1 minutë treni plot i ngarkuat lëviz $\frac{2}{6}$ kilometra, kurse treni i zbrazur me ngarkesë lëviz $\frac{4}{6}$ kilogram. Cili udhëton më shpejt dhe për sa?

11 Ditën e martë ka rënë $\frac{7}{12}$ decimetër borë, por të mërkurën $\frac{2}{3}$ decimetra. Cilën ditë ka rënë më shumë borë? Për sa?

12 Kire ka $\frac{5}{6}$ cm fletë të vjetra te dokumentacioni, por Milla $\frac{2}{3}$ cm te dokumentacioni i saj. Cili ka më shumë fletë të vjetra? Për sa?



SFIDA

Meri dhe Angela kanë shkuar të blejnë këmisha. Së bashku kanë pasur 1 000 den. Këmisha e Merit ka qenë 360 den., por këmisha e Angelës për $\frac{1}{4}$ më e shtrenjtë prej këmishës së Merit. Sa ka kushtuar këmisha e Angelës? Sa para kanë shpenzuar së bashku? Shkruaj si thyesë pjesën e parave që u kanë ngelur.

OPERACIONET ME NUMRA DHJETORË

KRAHASIMI I NUMRAVE DHJETORË ME NJË DHE ME DY DHJETORE

Të përkujtojmë!



$\frac{1}{10} = 0{,}1$



$\frac{10}{100} = 0{,}10$



$\frac{3}{10} = 0{,}3$



$\frac{30}{100} = 0{,}30$

$0{,}1 = 0{,}10$ dhe $0{,}3 = 0{,}30$



Te çfarëdo numër dhjetor numri i zerove të shkruara prej anës së djathtë mund të mos shkruhen pasi këta numra tregojnë madhësi të njëjtë.



Krahasimi me pllaka numerike

Një mënyrë se si të krahasojmë numra dhjetorë është t'i paraqesim me pllaka numerike. Te figura na është paraqitur një krahasim i këtillë.

SHEMBULLI 1: Krahasoji numrat 2,1 dhe 2,8



2,1 < 2,8

SHEMBULLI 2: Krahasoji numrat 2,05 dhe 2,04



2,05 > 2,04

Krahasimi i shifrave

Tjetër mënyrë për krahasim është drejtpërdrejt me krahasimin e shifrave me të cilat janë shkruar numrat

SHEMBULLI 1: Krahasoji numrat 3,42 dhe 3,46.

hapi 1:	hapi 2:	hapi 3:
3,42 3,46	3,42 3,46	3,42 3,46
krahasoji të plotat 3 = 3	krahasoji të dhjetat 4 = 4	krahasoji të qindtat 2 < 6

SHEMBULLI 2: Krahasoji numrat 4,2 dhe 4,17.

hapi 1:	hapi 2:	hapi 3:
4,2 4,17	4,20 4,17	4,20 4,17
nuk kanë numër të njëjtë të dhjetoreve	Shtoj zero	përsëriti hapat prej detyrës paraprake 2 > 1

Krahasimi me drejtëzën numerike

Numrat mund t'i krahasojmë edhe me ndihmën e pozitës së tyre te drejtëza numerike.

SHEMBULL: Krahasoji numrat 2,73 dhe 2,68



Lokalizoje vendpozitën e tyre. E di se gjithmonë numri më i madh është ai nga ana e djathtë. Prandaj

2,73 > 2,68

AKTIVITET NË ORË



1	2	3	4	5	6	7	8	9	<	>	,

1. Fillo me lojë me shokun sipas rregullave:
   - luhet në seri prej 10 përpjekjeve
   - njëri lojtar formon numër dhjetor me kartela
   - lojtari i dytë i krahason dhe sqaron
   - në mënyrë alternative i ndërrojnë rolet
   - fitues është nxënësi me më shumë përgjigje të sakta.

2. Me ndihmën e këtyre kartelave bëj disa numra dhjetorë me një dhe dy dhjetore dhe formo më së paku 5 gjykime të sakta, si për shembull:

2,4 > 2,29

1 Vendosi numrat e dhënë në vendet përkatëse te drejtëzat numerike.

0,2 0,5 1,5 1,2 0,9 1,7



0,3 0,9 1,3 0,6 1,1 1,7



2 Krahasoji numrat duke shkruar njërën prej shenjave >, =, <.

a) 3,56 ☐ 3,52

b) 0,5 ☐ 0,48

c) 32,4 ☐ 33,21

ç) 4,22 ☐ 4,6

3 Shkruaj njërën prej shenjave për krahasim >, =, < për të fituar gjykim të saktë.

a) $\frac{4}{10}$ ☐ 0,12

c) $\frac{7}{10}$ ☐ 0,5

c) 0,2 ☐ $\frac{17}{100}$

ç) 0,34 ☐ $\frac{35}{100}$

4 Shkruaj numër dhjetor për gjykimin e dhënë që të jetë i saktë:

a) 3,2 > ☐

b) 4,56 < ☐

c) 0,3 > ☐

ç) 6,24 < ☐

5 Shkruaj njërën prej shenjave për krahasim >, =, < për të fituar gjykim të saktë.

a) 43,46 ☐ 73,42

b) 58,52 ☐ 50,05 + 8,49

c) 80,71 ☐ 80,91

ç) 17,13 ☐ 17,23

d) 36,22 ☐ 26,33

dh) 85,29 ☐ 86,29

6 Rretho numrin më të vogël te çdo grup i numrave.

347	50,3	965	703	60,0	7,73	71,4	79,4
4,56	695	7,03	943	61,8	536	718	31,2
6,02	7,01	5,16	6,68	1,83	88,0	59,9	204

7 Radhiti numrat prej më të madhit deri te më i vogli.

52,00 ☐

52,02 ☐

50,20 ☐

50,22 ☐

8 Rretho numrin më të vogël te çdo grup i numrave.

9,22	64,2	58,2	4,63	8,42	68,0	67,2	1,82	15,2	5,82	98,7	9,29
9,35	6,00	30,0	3,86	61,8	89,5	95,1	3,37	75,7	87,6		
3,45	18,6	4,92	9,52	1,91	96,0	2,99	13,7	27,8	77,8	70,6	1,59
10,9	9,31	16,1	2,17	4,52		81,6	2,32	24,2	4,48	46,3	
1,93	7,39	65,1	43,8			8,22	6,99	34,9	6,61		

9 Cili prej këtyre numrave 0,5; 0,05; 0,55; 0,1 duhet të vendoset te vargu

☐ ; 0,15; 0,25; 0,35; 0,45

10 Cili numër mungon te vargu.

4,3; ☐ 4,2; 4,15; 4,1; 4,05; 4,00.

KRAHASOJI!

$0,5$ ☐ $\frac{3}{4}$ $\quad$ $\frac{1}{4}$ ☐ $0,21$ $\quad$ $0,4$ ☐ $\frac{2}{5}$

$1\frac{1}{2}$ ☐ $1,35$ $\quad$ $2,25$ ☐ $2\frac{2}{8}$ $\quad$ $3\frac{1}{3}$ ☐ $3,5$

Paraqitja skematike për shumën 1









1 Bëni shumë 1 të plotë

Bëni disa kartela të këtilla komplete.
Përzieni dhe ndani me shokët pa i shikuar. Loja mund të fillojë. Fitues është ai që bën më shumë çifte të cilat japin shumën 1 të plotë.

0,3	0,8	0,5	0,1	0,2	0,9	0,4	0,6	0,7

2 Vendosi numrat 0,2; 0,3; 0,4 dhe 0,5 ashtu që shuma vertikalisht dhe horizontalisht të jetë 1



3 Bëje shumën 1.

a) 0,3 + ☐ = 1 b) ☐ + 0,6 = 1 c) 0,2 + ☐ = 1 ç) 0,9 + ☐ = 1

4 Cila vlerë mungon te diagrami?



Paraqitja skematike e mbledhjes së numrave dhjetorë

1,0 + 1,3



= 2,3

2,0 + 1,2



= 3,2

Paraqitja skematike e shumës 2 të plota

1,2 + 0,8



= 2

1,6 + 0,4



= 2

Paraqitja skematike e shumës 3 të plota



= 3

1 **Lidhi kartelat me numra dhjetorë duke bërë shumën 10.**

4,3	6,7	2,9	5,3	7,7	3,9	1,8	9,6	2,7	8,6
3,3	8,2	0,4	6,1	4,7	5,7	7,3	2,3	7,1	1,4

MBLEDHJA E NUMRAVE DHJETORË ME NJË DHE ME DY DHJETORE

Mbledhja me pllaka numerike

SHEMBULL: Dreni ka 3 shirita të drurit me dimensione 0,28 m, 0,6 m dhe 0,09 m. Sa është gjatësia e përgjithshme e shiritave të drurit?



0,28 + 0,6 + 0,09 = 0,97

Mbledhja vertikalisht

$$\begin{array}{r} 4{,}5 \\ +\ 5{,}0 \\ \hline 9{,}5 \end{array}$$

SHEMBULLI 1: Iliri vozit biçikletë 2,37 rrathë në mëngjes dhe 0,59 rrathë pasdite. Sa rrathë gjithsej vozit Iliri gjatë ditës?

$$\begin{array}{r} 2{,}37 \\ +\ 0{,}59 \\ \hline ,\ \ \ \end{array} \qquad \begin{array}{r} {\scriptstyle 1}\ \ \ \

4 Zbulo rregullën dhe plotëso fushat e zbrazëta sipas rregullës që e zbulove.



5 Njehso shumat duke përdorur gjithmonë numrin në qendër të rrethit si për shembull 81,7 + 2,5



6 Te këmbët e merimangës vendos numër dhjetor sipas zgjedhjes tënde ashtu që gjithmonë të dalë numri te drejtkëndëshi.Çiftet le të jenë çifte përkatëse këmbët e majta dhe djathtë.



7 Afrimi ka 8 kartelat vijuese:

Cilat numra dhjetorë prej 0 deri 40 mund të bëjmë me ndihmën e këtyre kartelave?

8 Kemi 4 kartela

Përdori të 4 kartelat që të jetë e saktë detyra.

☐,☐ + ☐,☐ = 10

9 Zgjidhi detyrat.

a) ☐
− 3,6
4,5

b) ☐
− 4,59
3,36

c) ☐
− 0,53
0,28

ç) ☐
− 2,10
5,14

d) ☐
− 4,06
3,14

SFIDA

Shkëmbi i pinguinëve

Pas shpëtimi të të gjithë pinguinëve anija e fundit niset që të bëjë kontroll se a ka ngelur ndonjë penguin te shkëmbinjtë. Anija niset dhe mbron me Shkëmbin e pinguinëve. Planifiko udhëtimin e anijes, ashtu që të vizitosh të gjithë shkëmbinjtë. Pastaj njehso atë largësi që e ka kaluar anija.



ZBRITJA E NUMRAVE DHJETORË DERI 100

Paraqitja skematike për zbritjen e numrit dhjetor.

a) Zbritja e numrit të plotë prej numrit dhjetor



vertikalisht

$$\begin{array}{r} 2{,}4 \\ -\ 2{,}0 \\ \hline 0{,}4 \end{array}$$

shkruajmë 2 = 2,0
- zbresim dhjetëshe prej dhjetësheve
- e përshkruajmë presjen
- zbresim pjesë të plotë prej pjesës së plotë

b) Zbritja e numrit dhjetor pa kalim.



$$\begin{array}{r} 1{,}7 \\ -\ 0{,}5 \\ \hline 1{,}2 \end{array}$$

c) Zbritja e numrit dhjetor prej numrit dhjetor me kalim.



$$\begin{array}{r} {\scriptstyle 1\ 16} \\ \cancel{2},\cancel{6} \\ -\ 1,8 \\ \hline 0,8 \end{array}$$

Shqyrto dhe mendo rreth mënyrës për zbritjen e numrave dhjetorë.



$$\begin{array}{r} 3,89 \\ -\ 1,98 \\ \hline 1,91 \end{array}$$

Shembulli 2) Shqyrto dhe hulumto!

$$\begin{array}{r} {\scriptstyle 5\ 15} \\ 5,\cancel{6}5 \\ -\ 3,16 \\ \hline ,\ 9 \end{array}$$

zbrit qindëshe
5 – 6 = ?
15 - 6 = 9

$$\begin{array}{r} {\scriptstyle 5\ 15} \\ 5,\cancel{6}\cancel{5} \\ -\ 3,16 \\ \hline ,49 \end{array}$$

zbrit dhjetëshe
5 – 1 = 4

$$\begin{array}{r} {\scriptstyle 5\ 15} \\ 5,\cancel{6}\cancel{5} \\ -\ 3,16 \\ \hline 2,49 \end{array}$$

zbrit të plota
5 – 3 = 2

Shembulli 3) Shqyrto dhe hulumto!

$$\begin{array}{r} 8,6 \\ -\ 2,4 \\ \hline 6,2 \end{array} \qquad \begin{array}{r} {\scriptstyle 8\ 17} \\ 1\cancel{9},\cancel{7}5 \\ -\ 3,80 \\ \hline 15,95 \end{array} \qquad \begin{array}{r} {\scriptstyle 4\ 4\ 10} \\ \cancel{5},\cancel{5}\cancel{0} \\ -\ 1,96 \\ \hline 3,54 \end{array}$$

1 Njehso

a) $\begin{array}{r} 0{,}7 \\ -\ 0{,}2 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 0{,}75 \\ -\ 0{,}2 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 0{,}95 \\ -\ 0{,}54 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 0{,}7 \\ -\ 0{,}25 \\ \hline \end{array}$ d) $\begin{array}{r} 0{,}76 \\ -\ 0{,}08 \\ \hline \end{array}$

dh) $\begin{array}{r} 0{,}08 \\ -\ 0{,}04 \\ \hline \end{array}$ e) $\begin{array}{r} 0{,}67 \\ -\ 0{,}36 \\ \hline \end{array}$ ë) $\begin{array}{r} 0{,}63 \\ -\ 0{,}38 \\ \hline \end{array}$ f) $\begin{array}{r} 0{,}84 \\ -\ 0{,}46 \\ \hline \end{array}$ g) $\begin{array}{r} 0{,}51 \\ -\ 0{,}29 \\ \hline \end{array}$

h) $\begin{array}{r} 0{,}9 \\ -\ 0{,}2 \\ \hline \end{array}$ i) $\begin{array}{r} 0{,}78 \\ -\ 0{,}3 \\ \hline \end{array}$ j) $\begin{array}{r} 0{,}4 \\ -\ 0{,}06 \\ \hline \end{array}$ k) $\begin{array}{r} 0{,}9 \\ -\ 0{,}37 \\ \hline \end{array}$ l) $\begin{array}{r} 0{,}7 \\ -\ 0{,}54 \\ \hline \end{array}$

2 Plotësoje rrethin ashtu që prej numrit më të madh do ta zbresësh më të voglin, kurse te çdo njehsim përdore numrin në qendrën e rrethit.





3 Vendos te numri dhjetor presjen për zgjidhjen e dhënë që të jetë e saktë.

a) 6,43 – 0,26 = 6 1 7 b) 8,77 – 0,9 = 7 8 7 c) 45,0 – 1,9 = 4 3 1

ç) 67,34 – 3,2 = 6 4 1 4 d) 9,62 – 8,4 = 1 2 2 dh) 9,7 – 2,5 = 7 2

4 Vendi ka blerë 3 bileta nga 56,5 denarë. Ajo ka paguar për ato me banknotë prej 500 denarë. Sa para i kanë kthye?

5 Fasulja organike është i gjatë 4,6 cm. Fasulja jo organike është e gjatë 6,42 cm. Për sa është më e gjatë fasulja jo organike?

6 Huani ka 1,243 kg miell organik. Receta e tij kërkon 2 kg miell. Edhe sa miell i duhet?

7 Një kajsi ka peshuar 4,5 g para se të thahet. Pas tharjes peshon 1,375 g. Sa gramë ka humbur deri sa të thahet?

8 Belinda ka blerë 2 dardha dhe nga një prej frutave të tjera. Sa para prej 500 denarë i kanë kthyer.

Çmimet e frutave organike		
Një mollë	copë	6,25 den.
Një dardhë	copë	16 den.
Një kivi	copë	13,2 den.
Një mango	copë	23,4 den.



9 Nga pjesa e lartë te zbrazëtirat shkruaj shumën, por poshtë ndryshimin e numrave.

43,3 13,34

72,7 8,39

82,71 9,9

10 Vendos numra ashtu që të fitosh shuma të sakta horizontalisht dhe vertikalisht. Të jesh i durueshëm dhe bëj më shumë.

			18,1
2,9	7,4	0,5	10,8
			13,4
	0,2	0,5	9,1
11,7	16,8	4,8	12,6

11 **Njehso.**

```
  □8, 6 7
+ 3 5,□9
---------
  7 4, 4 6
```

```
2□, 5 6
+ 3 ,□5
---------
3 2 , 2□
```

12 Merrni zarin për rrotullim dhe shabllon si te figura dhe filloni lojën me shokun.

1) Hidhni zarin një nga një.
2) Me çdo hedhje të zarit lëvizni aq katrorë, sa u ka rënë pika te zari.
3) Zgjedhni numër njëshifror dhe mblidhni me numrin e shkruar te katrori.
4) Pyetni shokun ta kontrollojë përgjigjen.
5) Me përgjigje të saktë ngelni në atë katror, por me përgjigje të pasaktë nuk luani një rreth.
6) Te hedhja vijuese zgjedhni numër dhe zbritni.
7) Fitues është ai që i pari do të arrijë te qëllimi.

filloni	32,7				
	51,6	89,7	34,7	48,5	99,2
					64,3
78,4	82,6	25,4	13,6	29,3	
67,3					
92,6	63,1	45,8	37,7	fund	



RRUMBULLAKIMI I NUMRAVE TË PLOTË DERI TE DHJETËSHJA DHE QINDËSHJA MË E AFËRT

Të përkujtojmë!

Rrumbullakimi te drejtëza numerike

1. Rrumbullakoni numrin 132 deri te dhjetëshja më e afërt.
   Më së miri do ta zgjidhni nëse te drejtëza numerike vëreni ku gjendet numri 132. Ai është ndërmjet 130 dhe 140, por është më afër te 130. Domethënë, numri 132 rrumbullakohet në 130. Thuhet rrumbullakimi poshtë.



2. Rrumbullakoje numrin 857 te qindëshja më e afërt.
   Përsëri duhet të vëreni vendin e numrit 857 te drejtëza numerike. Numri 857 është ndërmjet qindësheve 800 dhe 900, por është më afër deri 900. Domethënë e rrumbullakojmë në 900. Thuhet rrumbullakimi lart



Rrumbullakimi pa drejtëzën numerike

- Gjeje pozitën e shifrës tek e cila duhet të rrumbullakosh dhe tërhiqe.
- Vëre këtë shifër.
- Nëse është më e vogël se 5 rrumbullako poshtë, por nëse është 5 dhe më i madh se 5 rrumbullako lart.

Rrumbullako dhjetëshe më e

132

vogël se 5

Prandaj, 132 rrumbullakohet poshtë të 130

Rrumbullako qindëshe

857

5 ose është më e madhe se 5

Prandaj, 857 rrumbullakohet lart të 90

1 Rrumbullako në dhjetëshen më të afërt

a) 131 _____ b) 136 _____

c) 137 _____ ç) 133 _____

2 Rrumbullako në qindëshen më të afërt

a) 612 _____ b) 850 _____

c) 820 _____ ç) 688 _____

Rrumbullakimi i numrit dhjetor me drejtëzën numerike

Rrumbullakoi numrat 4,8 dhe 9,4 te numrat e plotë më të afërt.
Parashtro këto pyetje:

1) Ndërmjet cilëve numra të plotë gjendet numri që e rrumbullakojmë?
2) Cili prej tyre është më afër deri te numri që e rrumbullakojmë?

Shfrytëzoje simbolin ~ për rrumbullakimin e numrave.

Numri 4,8 është më afër numrit 5 se sa te numri 4. Prandaj numrin 4,8 e rrumbullakojmë lart 4,8 ~ 5.



Numri 9,4 është më afër numrit 9 se sa te numri 10 pasi 9,4 rrumbullakohet poshtë 9,4

Nëse numri dhjetor është saktë mesi ndërmjet dy numrave të plotë, atëherë ai rrumbullakohet lart prej numrit të plot më të madh. Kështu, numri 7,5 i rrumbullakuar është 8

(ki kujdes patjetër të shkruash 8 por jo 8,0 pasi atëherë do të jetë në një dhjetore)

Rrumbullakimi i numrit dhjetor në numër të plotë pa drejtëzën numerike

Rrumbullakoi në numër të plotë këta numra dhjetorë 5,4 dhe 6,8.
Numri 5,4 gjendet ndërmjet numrave 5 dhe 6 ose shkruajmë $5 < 5,4 < 6$.
Numri 6,8 gjendet ndërmjet numrave 6 dhe 7 ose shkruajmë $6 < 6,8 < 7$.
Nëse shifra e të dhjetave është 5 dhe më të mëdha se 5 rrumbullakimi i numrit më të madh ose thuhet lart, por nëse shifra e të dhjetave është më e vogël se 5 rrumbullakimi i numrit të plotë më të vogël ose thuhet poshtë.

Numrin 5,4 e rrumbullakojmë në 5.
Numrin 6,8 e rrumbullakojmë në 7.

Shkruajmë 5,4~5.
Shkruajmë 6,8~7.

Rrumbullakimi i numrit dhjetor në të dhjetat

Rrumbullakoi numrat 2,63 dhe 2,68 në të dhjetat ose në një vend dhjetor.

Hapi:

1) tërhiqe shifrën e të dhjetave 2,63
2) vëre shifrën vijuese pas të dhjetave, përkatësisht shifrën e qindësheve dhe zbato rregullën:

Nëse shifra e qindësheve është 5 dhe më e madhe se 5 te shifra e të dhjetave shtohet 1, por nëse është më e vogël se 5 shifra e të dhjetave ngel e njëjtë.

Sipas kësaj

2,63 3 < 5 pasi mbahet shifra e të dhjetave

2,63~2,6

2,68 8 > 5 prandaj i shtohet 1 shifrës të të dhjetave (6 + 1 = 7)

7,68~7,7

3 **Rrumbullakoi numrat e të dhjetave, përkatësisht në një vend dhjetor.**

a) 7,46 ~ ☐ **b)** 4,28 ~ ☐ **c)** 6,72 ~ ☐ **ç)** 4,96 ~ ☐

d) 8,29 ~ ☐ **dh)** 5,33 ~ ☐ **e)** 0,99 ~ ☐ **ë)** 6,81 ~ ☐

f) 6,81 ~ ☐ **g)** 4,98 ~ ☐ **h)** 1,04 ~ ☐ **i)** 3,91 ~ ☐

VLERËSIMI I SHUMËS DHJETORE

Vlerësimi paraqet njehsim të përgjigjes së përafërt në mënyrë më të shpejtë (mentalisht) me qëllim që të caktohet kuptueshmëria e përgjigjes. Te një detyrë me mbledhje dhe zbritje, sa më saktë vlerësojmë aq do të jemi më afër deri te përgjigja e saktë. Në praktikë dallojmë dy lloje të vlerësimit:

1) vlerësimi me rrumbullakim dhe
2) vlerësimi prej pjesës së përparme

Vlerësimi me rrumbullakim

Vlerëso shumën:



Domethënë përgjigja e saktë është 8,94, por vlerësimi (përafërsisht) është 9.1)

Shembulli 1) Vlerëso sa është shuma 23,6 + 7,23

23,6 ~ 24

7,23 ~ 7

Domethënë, shuma do të jetë rreth 24 + 7 = 31

Tani do të mund ta njehsojmë zgjidhjen e saktë dhe të shikojmë sa jemi afër deri tek ajo.

23,6 + 7,23 = 30,83

Shembulli 2) Vlerëso ndryshimin 35,65 – 24,8

35,65 ~ 36

24,8 ~ 25

Vlerësimi: 36 – 25 = 11

Përgjigja e saktë: 35,65 – 24,8 = 10,85

Vlerësimi prej pjesës së përparme

Ky lloj i vlerësimit në ruajtjen e shifrave të para jozero prej numrit.

18,23 ~ 18
24,78 ~ 25

Vlerësimi: 18 + 24 = 42
Zgjidhje e saktë: 18,23 + 24,78 = 43,01

Të bëjmë një krahasim ndërmjet dy llojeve të vlerësimit me një detyrë:

vlerësimi prej pjesës së përparme

$$\begin{array}{r} 5{,}5 \\ 6{,}45 \\ +\ 7{,}62 \\ \hline 18{,}00 \end{array}$$

vlerësimi me rrumbullakim

$$\begin{array}{rcr} 5{,}50 & \longrightarrow & 6 \\ 6{,}45 & \longrightarrow & 6 \\ +\ 7{,}62 & \longrightarrow & +\ 8 \\ \hline & & 20 \end{array}$$

1 **Vlerëso vlerësimin prej pjesës së përparme.**

a) $\begin{array}{r} 0{,}19 \\ 0{,}74 \\ +\ 0{,}2 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 7{,}8 \\ 5{,}2 \\ +\ 4{,}4 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 2{,}65 \\ 6{,}2 \\ +\ 5{,}93 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 0{,}22 \\ 0{,}37 \\ +\ 0{,}59 \\ \hline \end{array}$ d) $\begin{array}{r} 3{,}79 \\ 4{,}38 \\ +\ 7{,}33 \\ \hline \end{array}$

dh) 3,2 + 6,43 = e) 0,257 + 0,65 = ë) 1,70 + 6,39 + 3,94 =

2 **Vlerëso vlerësimin me rrumbullakim.**

a) $\begin{array}{r} 0{,}57 \\ 0{,}91 \\ +\ 0{,}3 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 6{,}6 \\ 1{,}8 \\ +\ 4{,}2 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 8{,}57 \\ 0{,}73 \\ +\ 0{,}59 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 0{,}77 \\ 0{,}56 \\ +\ 0{,}48 \\ \hline \end{array}$ d) $\begin{array}{r} 5{,}41 \\ 2{,}79 \\ +\ 0{,}13 \\ \hline \end{array}$

dh) 7,39 + 5,3 = e) 0,55 + 0,94 = ë) 3,07 +7,5 + 4,27 =

3 Së pari vlerëso me vlerësim të pjesës së përparme, kurse pastaj me rrumbullakim. Ndërmjet cilave vlera gjendet shuma e kërkuar

a) 36,8 + 87,0 = _____

b 98,9 + 89,4 = _____

c) 4,32 + 8,16 = _____

ç) 15,0 + 0,14 = _____

d) 75,7 + 4,36 = _____

dh) 8,78 + 20,7 = _____

e) 74,8 + 0,68 = _____

ë) 9,81 + 3,30 = _____

f) 6,25 + 3,40 = _____

g) 7,49 + 9,71 = _____

4 Elona e ka vozitur biçikletën e saj 3,45 km ditën e premte, 5,38 km ditën e shtunë dhe 6,35 km ditën e diel. Vlerëso sa km ka vozitur biçikletë Elona në këto tri ditë?

4 Vlerëso sa është temperatura mesatare te qytetet e shënuar te karta e Indisë.



DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRIT DHJETOR





numri i dhënë 0,1
numri i dyfishuar 0,1 + 0,1 = 0,1 · 2 = 0,2



numri i dhënë 0,4
numri i dyfishuar 0,4 + 0,4 = 0,4 · 2 = 0,8

numri i dhënë 0,6
numër i përgjysmuar 0,6 : 2 = 0,3

numri i dhënë 0,8
numër i përgjysmuar 0,8 : 2 = 0,4

Të dyfishojmë një numër dhjetor do të thotë dy here ta zmadhojmë vlerën e tij ose ta shumëzojmë me 2.

Të përgjysmojmë një numër dhjetor do të thotë ta pjesëtojmë vlerën e tij ose ta pjesëtojmë me 2.



1 **Vepro sikurse është te shembulli i zgjidhur.**

Lidhe çdo numër me numrin e tij të dyfishuar, për shembull 1,8 i dyfishuar është 3,6.

2,3	18,2
7,5	13,4
1,8	6,8
4,6	17,8
9,1	12,4
3,4	3,6
5,2	18,8
6,7	15
8,9	4,6
2,7	10,4
6,2	9,2
9,4	5,4

Lidhe çdo numër me numrin e tij të përgjysmuar, për shembull 16,4 i përgjysmuar është 8,2.

14,6	4,2
13,2	2,8
12,6	6,3
9,4	8,2
8,4	7,9
7,2	4,9
5,6	8,5
16,4	7,3
15,8	4,7
11,2	6,6
9,8	3,6
17	5,6

2 **Çdo nxënës fiton set prej kartelave te të cilat janë shkruar numra dhjetorë. E luajnë lojën CILI I PARI DO TA GJEJË numrin e dyfishuar dhe CILI I PARI DO TA GJEJË numrin e përgjysmuar. Arsimtari jep ndonjë numër prej kartelave, por nxënësit në vendin përkatës prej skemës duhet ta vendosin kartelën e numrit të dyfishuar dhe të përgjysmuar. Fitues është ai i cili i pari do ta vendosë kartelën në vendin përkatës. Loja vazhdon deri sa nuk shpenzohen të gjitha kartelat.**



3 **Ema ka pasur pëlhurë me gjatësi 3,5 metra. Dëshiron të qepë këmishë për të cilën i nevojitet gjysma e kësaj gjatësie.**

a) Sa metra janë të nevojshme për këmishë? Sa cm janë ato?

b) Gjysma e pëlhurës që do të ngelë, kurse gjysmën tjetër do ta shfrytëzojë për veshje të kukullës së saj. Sa pëlhurë do të shfrytëzojë Elona për veshjen e kukullës?

4 **Cilin numër e ke menduar?**

a) Nëse e përgjysmoj numrin tim do të fitoj 2,3.

b) Nëse e dyfishoj numrin tim do të fitoj 9,2.

5 **Numrat në rreth njëherë dyfishoji, kurse njëherë përgjysmoji (ki kujdes ke numër që të mungon).**



6 **Dyfishoji numrat.**



7 **Përgjysmoji numrat.**



Loja luhet në çifte. Rrotullohet zari për lojë dhe nëse lojtari arrin te fusha e kuqe numri dyfishohet, por nëse arrin te fusha e kaltër numri përgjysmohet. Partnerët në lojë ndërmjet veti i kontrollojnë përgjigjet dhe nëse ka gabim ai lojtar kalon një rreth. Loja mbaron kur njëri prej lojtarëve do të arrijë në të gjitha fushat. Derisa loja zgjat duhet të mbajnë mend ose të shënojnë në cilat fusha arrijnë.



SHUMËZIMI I NUMRAVE DHJETORË ME NJË DHJETORE MË TË VOGËL SE 10

Të përkujtojmë!

Si shumëzohen numrat e plotë me 10,100 ose 1 000?

Te tabela e dhënë çdo vlerë vendore është 10 herë më e madhe prej vlerës vendore djathtas prej asaj.

DHM	M	Q	DH	NJE
			3	5
		3	5	0
+	3	5	0	0
3	5	0	0	0



Shembulli 1) Njehso!

a) 1 230 · 100 = 123 000 b) 12 030 · 10 = 120 300 c) 102 · 1 000 = 102 000

- shifrën e të qindëtave e zmadhon vlerën e vet 10 herë dhe kalon në vendin e të dhjetave
- shifrën e të dhjetave e zmadhon 10 herë dhe kalon në vendin e njësheve
- shifra e njësheve në vendin e shifrës së të dhjetave etj.

	Q	DH	NJ	,	të dhjetat	të qindëtat
numër			0	,	3	6
·10			3	,	6	0
·100		3	6	,	0	0

	Q	DH	NJ	,	të dhjetat	të qindëtat
numër			3	,	1	8
·10		3	1	,	8	0
·100	3	1	8	,	0	0

Shembulli 2) Shqyrto tabelën e plotësuar dhe diskuto me shokun (kujtohu se prej anës së djathtë mund të shkruajmë sado qoftë zero dhe vlera e numrit dhjetor nuk do të ndryshojë).

numër	numër· 10	numër · 100	numër · 1 000
0,6 = 0,60 = 0,600	6	60	600
3,4 = 3,40 = 3,400	34	340	3 400
7,2 = 7,20 = 7,200	72	720	7 200
0,56 = 0,560 = 0,5600	5,6	56	560
1,25 = 1,250 = 1,2500	12,5	125	1 250

Shembulli 3) Njehso prodhimin.

a) $20 \cdot 5{,}6$

Të shqyrtojmë se si do të veprojmë tani. E dimë prej përpara se $20 = 2 \cdot 10$, prandaj mund ta zbatojmë këtë strategji:

$$20 \cdot 5{,}6 = (2 \cdot 10) \cdot 5{,}6 = 2 \cdot (10 \cdot 5{,}6) = 2 \cdot 56 = 112$$

6) $40 \cdot 6{,}8$

$$40 \cdot 6{,}8 = (4 \cdot 10) \cdot 6{,}8 = 4 \cdot (10 \cdot 6{,}8) = 4 \cdot 68 = 272$$

Kujtohu në vetinë asociative
$(4 \cdot 10) \cdot 5 = 4 \cdot (10 \cdot 5)$



1 **Plotësoi tabelat.**

	Q	DH	NJ	,	të dhjetat	të qindëtat
numër			4	,	6	5
· 10				,		
· 100				,		

	Q	DH	NJ	,	të dhjetat	të qindëtat
numër			6	,	0	4
· 10				,		
· 100				,		

2 **Plotësoje tabelën.**

numër	numër · 10	numër · 100	numër · 1 000
0,4			
0,8			
2,53			
6,64			

Krahasoni pozitën e presjes dhjetore te numri me pozitën e presjes dhjetore te numri i shumëzuar me 10, 100 dhe 1 000. Çka vëreni?

3 **Shfrytëzoni rregullën nga aktiviteti paraprak dhe njehsoni përmendësh.**

a) $10 \cdot 3{,}628$
$100 \cdot 3{,}628$
$1\,000 \cdot 3{,}628$

b) $10 \cdot 9{,}65$
$100 \cdot 9{,}65$
$1\,000 \cdot 9{,}65$

c) $10 \cdot 0{,}5$
$100 \cdot 0{,}5$
$1\,000 \cdot 0{,}5$

ç) $10 \cdot 4{,}8$
$100 \cdot 4{,}8$
$1\,000 \cdot 4{,}8$

4 **Njehso:**

a) $30 \cdot 3{,}5 =$ **b)** $50 \cdot 4{,}3 =$ **c)** $60 \cdot 2{,}4 =$ **ç)** $60 \cdot 8{,}2 =$

SHUMËZIMI I NUMRIT DHJETOR ME NUMËR NJËSHIFROR

Shembulli 1) Të shumëzojmë 0,4 · 6.
Mund të shfrytëzojmë ndonjë strategji si për shembull:

0,4 · 6 = 0,4 · (5 + 1) = 0,4 · 5 + 0,4 · 1 = (0,4 · 10) : 2 + 0,4 =
= 4 : 2 + 0,4 = 2 + 0,4 = 2,4

Pse kështu? Pasi shumëzimi me 5 është njëjtë sikurse shumëzimi me 10, pra përgjysmimi (0,4 · 10) : 2 = 0,4 · 5 dhe pastaj vetëm shtojmë edhe 0,4.

Ose mund të shfrytëzojmë pllakat duke ditur se
6 · 0,4 = 0,4 + 0,4 + 0,4 + 0,4 + 0,4 + 0,4



Mund të zgjidhim kështu:

- **shumëzojmë sikurse do të bënim me numrat e plotë**
- **i numërojmë vendet dhjetore te shumëzuesi dhjetor**
- **shënojmë numër të njëjtë të vendeve dhjetore te prodhimi.**

3 · 4,6 → 1 vend dhjetor → 13,8

6 · 7,4 → 1 vend dhjetor → 44,4

4 · 5,62 → 2 vende dhjetor → 22,48

6 · 7,26 → 2 vende dhjetor → 43,56

1 Cakto prodhimin, pastaj zgjedh përgjigjen e saktë prej përgjigjeve të ofruara:

a) 0,9 · 7 = ____ b) 0,9 · 6 = ____ c) 0,7 · 9 = ____ ç) 0,3 · 2 = ____

d) 1,0 · 0 = ____ dh) 0,3 · 6 = ____ e) 0,0 · 8 = ____ ë) 0,2 · 8 = ____

1,6 | 0,0 | 6,3 | 1,8 | 0,0 | 5,4 | 0,6 | 6,3

2 Njehso në cilën mënyrë dëshiron.

a) 4,6 · 7 = b) 5,3 · 6 = c) 2,6 · 8 = ç) 9,7 · 2 = d) 7,6 · 4 =

3 A mundesh ta deshifrosh skemën me pllakat? Poashtu mund të shërbehesh me operacionet mbledhje dhe shumëzim.



4 Njehso dhe plotëso

hyrje 4,8	· 7	· 10	dalje/_____
hyrje 6,2	· 3	· 10	dalje/_____
hyrje 0,7	· 9	· 10	dalje/_____

5 Kompleti prej 6 librave artistike kushton 4 216,8 denarë. Kopja prej një libri, të blerë në veçanti, kushton 702,8 denarë. Sa më pak kushtojnë 6 librat nëse e blini kompletin?

6 Lana vrapon 5,3 km për një orë. Me këtë tempo, sa larg do të vrapojë për 7h?

7 **Zbulo kodin për ta hapur sëndakun me pasuri:**

- shifra e fundit është $0,5 \cdot 4$
- shuma e dy shifrave të fundit është e barabartë me $0,6 \cdot 10$
- shifra e parë është të dhjetat prej prodhimit të dyfishuar të 0,4
- prodhimi prej të gjitha shifrave është vlera e përgjysmuar e numrit 128



8 **Një banane e madhe përmban 2,4 g proteina. Sa gramë proteina do të përmbajnë dhjetë banane të mëdha?**

9 **Vargu i parë quhet aritmetik, kurse vargu i dytë gjeometrik. Zbulo rregullën se si janë fituar këto vargje.**

a) 0,2 0,5 0,8 1,1 1,4

b) 0,2 0,4 0,8 1,6 3,2

c) bëj vetë një varg aritmetik dhe një varg gjeometrik.

10 **Nëse një ekzemplar i xehes peshon 23,8 g, sa gramë përafërsisht do të peshojnë 9 ekzemplarë të barabartë?**

11 **Merita mund të notojë 18,5 metra për një minutë. Sa larg mund të notojë për 4 minuta?**





VLERËSIMI I VLERËS SË PËRAFËRT GJATË SHUMËZIMIT TË NUMRIT DHJETOR

Shembulli 1) Nikolla ka vozitur biçikletë 3 orë me shpejtësi prej 4,6 km në orë. Sa rrugë ka kaluar?

Të bëjmë vlerësim me rrumbullakim

$4{,}6 \sim 5$

$3 \cdot 5 = 15$km

Zgjidhja e saktë është:

$3 \cdot 4{,}6 = 13{,}8$

Neritoni ka kaluar rrugën

13,8 km

Për vlerësim më të përgjithshëm mund të zbatojmë dhe taktikën prej jetës së përditshme rrumbullako – poshtë dhe rrumbullako – lart, por me siguri ne vendosim çka do të jetë më afër deri te përgjigja e saktë.

rrumbullako poshtë

$4{,}6 \longrightarrow 4$

$4 \cdot 3 = 12$

rreth 12

rrumbullako lart

$4{,}6 \longrightarrow 5$

$5 \cdot 3 = 15$

rreth 15

Përfundimi: përgjigja e saktë është ndërmjet 12 km dhe 15 km.

1. **Nëse Iliri mund të vrapojë 8,73 kilometra për një orë, sa larg mund të vrapojë për 4 orë? Detyrën zgjidhe me vlerësim.**
   Ki kujdes, për cilën strategji do të vendosësh, për të rrumbullakuar lart ose për të rrumbulluar poshtë. Pse e përshpejtove atë strategji?

2. **Nikolla shikon televizor 2,28 orë në ditë. Vlerëso sa orë do të jetë ajo për 1 por javë, sa për dy javë. Pastaj gjeje kohën e saktë të cilën Nikolla e kalon para televizorit.**

3. **Një kuti e ka masën 1,74 kg. Vlerëso sa do të jetë masa e 6 kutive të atilla. Pastaj gjeje përgjigjen e saktë.**

4. **Merita ka vlerësuar se gjerësia e parkut më të afërt është rreth 24 metra. Cila do të jetë vlera më e vogël, kurse cila do të jetë vlera më e madhe për gjerësinë?**

SFIDA

6,3
+2,4
= ☐ → ☐ -2,3 = ☐ → ☐ :2 = ☐ → ☐ -1,8 = ☐ → ☐ ·2 = ☐ → ☐ ·2 = 5,6

72,45
-16,56
= ☐ → ☐ -50,01 = ☐ → ☐ +0,24 = ☐ → ☐ +2,14 = ☐ → ☐ :2 = ☐ → ☐ ·2 = 8,26

Ndihmë: Nëse nuk jeni të sigurt, a e keni zgjidhur mirë, gjithmonë mund të kontrolloni me operacionet inverse. Për shembull:

2,03 + 34,2 = 36,23

Kontrolloni kështu: 36,23 – 34,2 = 2,03

SFIDA

Përcilli udhëzimet te detyrat. Pasi që të zgjidhësh kërko përgjigjen te tabela poshtë dhe tek ajo fushë vendos shkronjën përkatëse.
Nëse numri përsëritet, atëherë edhe shkronja do të përsëritet.
Cili prej jush do ta zbulojë fjalën?

Fillo me 2,3	shumëzo deri 6 →	☐	përgjysmo →	☐	= **T**
Fillo me 0,6	përgjysmo →	☐	shto 7 →	☐	= **I**
Fillo me 3,5	shto 8,2 →	☐	zbrit 1,7 →	☐	= **A**
Fillo me 4,25	përgjysmo →	☐	zbrit 4,3 →	☐	= **M**
Fillo me 12,34	shto 5,18 →	☐	përgjysmo 5 →	☐	= **E**
Fillo me 24,3	shto 56,5 →	☐	përgjysmo →	☐	= **K**

4,2	10	6,9	87,6	4,2	10	6,9	8,2	40,4	10

1 Tre vëllezër kanë trashëguar 17 florinj. Vëllau më i vogël duhet të fitojë $\frac{1}{2}$ e florinjve, vëllau i mesëm $\frac{1}{9}$, kurse vëllau më i vogël duhet të fitojë $\frac{1}{3}$ e florinjve. Por ata nuk mund të pajtohen, pasi u binte pjesa prej një floriri. Ndihmoni vëllezërit të ndajnë florinjtë dhe të jenë të kënaqur.

2 Suada ka qenë në garë nga matematika. Për disa përgjigje të saktë ka marrë 4 pikë, kurse për çdo përgjigje jo të saktë janë zvogëluar 6 pikë. Ka pasur 24 detyra, por ajo ka pasur 56 pika. Sa detyra ka zgjidhur Suada.

3 Në nëntë kartela janë shkruar të gjitha shifrat prej 1 deri 9 (te çdo kartelë nga një shifër). Eda i ka kartelat me shifrat 7, 2 dhe 4, Mara me 6, 5 dhe 1, kurse Seadi i ka 8,3 dhe 9. Me shfrytëzimin vetëm të operacioneve +, – dhe : çdonjëri prej tyre te numrat e vet mund të fitojë rezultate të ndryshme. Cili prej tyre mund të fitojë rezultat 20?

4 Në pjesë të autostradës bëhet riparim. Shoferët janë të detyruar atë pjesë ta kalojnë nëpër rrugë qarkore, në vizatim të shënuar me vija të ndërprera.

Sa kilometra më gjatë do të udhëtojnë?



TEMA 4
Matje

- Gjatësia
- Masa
- Vëllimi
- Syprina
- Koha

REZULTATI NGA TË MËSUARIT

Nxënësi /nxënësja do të aftësohet:

1. të shfrytëzojë lidhjen e njësive matëse (gjatësi, masë dhe vëllim) dhe shënimi prej matjeve si numër njëemëror/ shumëemëror në kontekst real;
2. të shfrytëzojë lidhjen e njësive matëse për syprinën dhe të njehsojë syprinën e drejtkëndëshit;
3. të shfrytëzojë njësitë e ndryshme për matjen e kohës për të treguar intervalet kohore.

SFIDAT E MUNDSHME

Shpesh ndodh nxënësit ta harrojnë ekuivalencën e njësive matëse (për shembull: sa mililitra ka në një litër). Matja është temë për të cilën nuk mësohet aq shpesh. Duke përsëritur këto fakte më shpesh dhe do të kthehemi tek ato gjatë gjithë vitit.
Disa nxënës mund të përziejnë konceptet masë dhe peshë. Ne do t'i përcjellim përkufizimet përkatëse, të pasuruara me shembuj.

Fjalori i koncepteve të reja

Gjatësia, masa, vëllimi (numër i emërtuar – njëemëror dhe shumëemëror, tonelata, dekagrami). Syprina e formave 2D (njësitë matëse për syprinën: metër katror – m^2, decimetër katror – dm^2, centimetër katror – cm^2, syprina e drejtkëndëshit, syprina e katrorit). Koha (mileniumi, intervalet kohore).

Tema 4

GJATËSIA

MATIM GJATËSI – MILIMETRI, CENTIMETRI, DECIMETRI, METRI, KILOMETRI

Është e nevojshme të matim këto gjatësi: gjatësia e stilolapsit, gjatësia e faqeve të mprehëses, gjatësia e hijes së shtëpisë ose ndërtesës ku jeton, gjatësia e lumit Vardar, gjatësia e mizës...

Në cilën njësi matëse për gjatësi do ta shprehni matjen?

Pse e zgjodhët këtë njësi matëse? Si e bëtë vlerësimin tuaj?

_____

_____



_____

_____

_____

Numëro disa masa të tjera për gjatësinë që e di?

√ Të kujtohemi!

Njësia themelore matëse për gjatësi është metri (m).

Njësi matëse më të vogla për gjatësi janë:
- decimetri (dm)
- centimetri (cm)
- milimetri (mm)

Njësia më e madhe matëse për gjatësi është:
- kilometri (km)

1 m = 10 dm = 100 cm = 1 000mm
1 dm = 10 cm = 100 mm
1 cm = 10 mm
1 km = 1 000m



1 **Cila njësi matëse mund të qëndrojë te vendi i „*“.**

- Marku në fletore ka vizatuar katror metra gjatësi të brinjës 30 *. _____
- Milla deri te shkolla udhëton rreth 350 *. _____
- Për të arritur deri te qyteti vijues Edo me automobil duhet të kalojë 60 *. _____
- Gjatësia e lapsit është 10 *. _____

2 **Me vizore mati gjatësinë e çdo segmenti në cm, mm dhe m dhe shkruaje në vendin përkatës në tabelë.**

	Gjatësia cm	Gjatësia mm	Gjatësia m
_____			
_____			
_____			
_____			
_____			
_____			

3 **Vizato segment me këto gjatësi:**

2,3 cm, 50 mm, 4 cm 5 mm, 17 mm, 7 cm 2 mm.



4 **Plotësoi tabelat.**

	m	dm	mm
245 cm			
705 cm			

	dm	cm	mm
39 m			
7 m			

5 **Radhiti sipas madhësisë gjatësitë:**

325 mm, 2 dm 35 mm, 4 dm 30 cm 5 mm, 2 m 9 cm, 1 400 m

duke filluar prej vlerës më të madhe. Zgjidhe gjatësinë ndërmjet dy vlerave më të mëdha të matura dhe paraqiti në milimetra, centimetra, metra dhe kilometra.

MASA

MATIM MASË – KILOGRAM, GRAM

Vlerëso dhe lidhi masat përkatëse!

2 000 kg | 10 g | 7 kg | 2 kg | 1 kg | 300 g

Çdo send ose trup ka masë. Instrumenti për matje të trupave është peshorja.
Njësi themelore matëse për masën është një kilogram (1 kg).
Njësia matëse më e vogël për masën prej kilogramit është grami (g). **1 kg = 1 000 g**

1 Shndërro kilogramin në gram dhe anasjelltas.

- 458 g = _____ kg
- 450 g = _____ kg
- 17 671 g = _____ kg
- 71 g = _____ kg
- 5,5 kg = _____ g
- 1, 07 kg = _____ g
- 0,35 kg = _____ g
- 1,68 kg = _____ g

2 Ana ka paketuar 8,5 kg fasule në kuti të cilat kanë 500 g. Sa kuti janë të nevojshme për Anën të paketojë të gjitha fasulet?

3 Peshorja është në baraspeshë. Cakto masën e orës!



4 Merita ka shkruar në shitore dhe ka blerë 1 200 g limonë, 1 kg 400 g banane, 2,5 kg portokaj, 800 g kivi dhe 2 100 g mollë. Shëno masën e çdo lloj të pemëve te peshoret të cilat janë dhënë te figura. Pastaj njehso sa ka qenë masa e gjithë pemëve që i ka blerë Merita? Masa e përgjithshme a mund të jetë e matur në këtë lloj peshoreje?



DEKAGRAMI

Orgesi dëshiron të bëjë gurabi. Në recetë shkruan se i duhen 10 dkg miell për pastiçeri, 15 dkg sheqer vanile, 40 dkg kakao. Sa është masa e materialit të përdorur?

☐ + ☐ + ☐ = ☐

100 herë më e vogël njësia matëse për masën e kilogramit është dekagrami (dag).
Shënojmë 1 dag.
1 kg = 100 dag

Shembuj për masën të paketuara në **dag** janë qeset në sheqer të vanilinit, cimet, pluhur për pastiçeri. Dekagrami është njësi matëse **10 herë më e madhe** prej gramit. .

1 dag = 10 g
1kg = 100dag = 1 000g

1 **Lexo recetën.**

Cili prodhim që do të përdoret për përgatitje të sallatës së pemëve ka masë më të madhe?

Kush ka masë më të vogël?

Cilat prodhime kanë së bashku masë prej 1 kg?

2 **Krahasoji masat:**

400 kg	☐	40 dag	6 000 g	☐	600 dag
7 kg 50 dag	☐	705 dag	6 kg 3 dag	☐	630 dag
2 dag 7 g	☐	300 g	1 kg 100 dag	☐	200 dag

Tema 4

TONELATA

Tonelata është njësia matëse më e madhe për masën me të cilën matet pasha e madhe. **Një tonelatë** shkurtimisht shkruhet **1 t**

Një **tonelatë** ka 1 000 **kilogramë.**

1 t = 1 000 kg



1

150 kg + ☐ = 1 t

850 kg + 5 000 dag = ☐ kg

600 dag + 400 dag = ☐ kg

1 t - ☐ = 600 kg

5 t - ☐ = 2 500 kg

1 t - 900 kg = ☐ dag

2

Kopshtari ka mbledhur 595 kg mollë dhe 600 kg dardha. Kopshtari a ka mbledhur 1 t pemë. Kontrollo përgjigjen tënde!

3

Marku ka blerë 1 kilogram çokolatë dhe i ka ndarë me Millën dhe Ajshen. Millës i ka dhënë 200 g, kurse Ajshen 30 dag. Sa çokolata i kanë ngelur Marku?

VËLLIMI

MATIM VËLLIMIN – LITRI, DECILITRI, CENTILITRI, MILILITRI

Vlerëso dhe lidhi shishet me lëng me numrin e gotave të cilat do të mbushen prej tyre.



Lëngu nuk ka formë. Ai e fiton formën sipas enës tek i cili gjendet. Madhësia e hapësirës **që e zë** lëngu në enë mund të matet. Njësia matëse për vëllimin e lëngut është litri.

Shënojmë 1 l.

Njësi më të vogla se litri janë: decilitri (dl), centilitri (cl) dhe mililitri (ml).

1 l = 10 dl

1 l = 100 cl

1 l = 1 000 ml

1 **Krahasoji sasitë e lëngut:**

1 l	☐	9 dl	5 l	☐	50 dl	33 l	☐	3 dl
250 cl	☐	2 l	0,5 l	☐	250 ml	1l 500 ml	☐	20 dl
2 l 10 dl	☐	3 l	42 dl	☐	4l 2dl	550 l	☐	50 dl

Vlerëso, pastaj njehso!
Sa gota prej 2 dl mund të mbushësh me ujë prej fuçisë që përmban 10 l.

_____

Shëno masat te çdo gotë

170 ml

350 ml

890 ml

250 ml

2 **Radhiti këto masa, duke filluar prej më të voglës.**

74,09 dl; 10l; 540 cl; 3 600 ml; 34 l 8 dl; 11, 5l;

3 **Një kuti e vogël përmban 12 ml qumësht. Tek ena e madhe për përzierje derdhen 12 kuti me qumësht. Sa qumësht (të matur në litra) ka në enë?**

4 **Sa lëng gjithsej ka tek enët të matur në litra?**

1t 10l 10dl 1dl 2cl 5ml

_____

1 Lidhi enët me lëng që i përgjigjet vëllimit të tyre prej prodhimeve të dhëna në mënyrë përkatëse.

2 Mbushi enët sipas instruksioneve të dhëna të cilat gjenden deri te çdo enë.

3 Si mundesh të matësh 6 litra ujë, vetëm me një enë prej 4 litra dhe një tenxhere prej 9 litra?

4 Dy enët nxënë sa gjysma e tenxheres, por tri gota ujë nxënë sa gjysma e enës së madhe. Sa gota ujë nxënë dy tenxhere?

NUMËR I EMËRTUAR

3 cm

NUMËR MATËS — NJËSIA MATËSE

Numrat njëemëror 1 m, 1 dm, 35 cm,

Numrat polinom 4 m 5 dm, 2 km 3 m

Numri i emërtuar përbëhet prej numrit të pa emërtuar dhe njësisë matëse të shkruar pranë tij. Numri i emërtuar që është shkruar me një numër të pa emërtuar dhe një njësie matëse quhet edhe numër njëemëror.

Numri që përmban dy ose më shumë numra njëemëror të llojit të njëjtë quhet numër shumëemëror.

Si do të fitohet numri njëemëror prej numrit shumëemëror? Por anasjelltas?

1. mënyra: 1m 2 dm 5 cm = 100 cm + 20cm + 5cm = 125 cm
2. mënyra: 1m 2 dm 5 cm = 125 cm

1. mënyra: 1m 2 dm 5 cm =10dm + 2dm + 0,5dm =12,5 dm
2. mënyra: 1m 2 dm 5 cm = 12,5 dm

1 **Shndërroji këta numra shumëemërorë në numra njëemëror dhe anasjelltas.**

8 cm 5 mm = _____ mm

29 dm 6 cm = _____ cm

8 kg 901 g = _____ g

1 km 700m = _____ t

120 mm = _____ cm _____ dm

840 cm = _____ m _____ dm

9 861 ml = _____ l _____ ml

4 043 g = _____ kg _____ g

1 Kilogrami ose dekagrami?

30 ____

300 ____

4 ____

1 ____

100 ____

1 ____

2 Vlerëso dhe kontrollo vlerësimi tende me matje dhe rrumbullako tërë njësinë matëse deri te më e afërta.

	vlerëso	mat	rrumbullako
	_____ cm _____ dm	_____ cm _____ dm	
	_____ cm _____ dm	_____ cm _____ dm	
	_____ mm _____ dm	_____ mm _____ dm	

3 Rrumbullako masat e njësive matëse deri te më e afërta.

5, 86 dl = _____ 8, 40 mm = _____ 27, 090 dag = _____

609, 71 cl = _____ 71, 55 cm = _____ 1, 66 kg = _____

SHNDËRRIMI NË NJËSI MATËSE PËRKATËSE

Shndërroji njësitë matëse dhe plotëso tabelat.

Gjeji sende të cilat do të mund t'i masësh në njësinë e dhënë matëse.

Gjatësia

sendi	metri	centimetri	milimetri
			1 mm
			10 mm
			34,5 mm
		75 cm	
	10,3 m		
	150 m		

Masa

sendi	kilogrami	grami	dekagrami
	3 kg		
	4,5 kg		
		7 400 g	
		800 g	
			100 dag
			500 dag

Vëllimi

sendi	litri	centilitri	mililitri
			3,2 ml
			8 ml
		25,9 cl	
		68,7 cl	
	15,2 l		
	50 l		

1 **Plotësoje tabelën sipas shembullit:**

Numër shumë emëror	Numër njëemëror	Numër njëemëror të shprehur me njësinë matëse më të vogël
1 cm 5 mm	1,5 cm	15 mm
		6 500 m
	4,36 km	
		500 g
1 kg 300 g	g	
3 m 20 cm		
	dag	1 250 g
	l	1 500 ml
	1,75 l	
2 l 400 ml		
		659 mm
10 l 60 ml		
	25,75 l	
13 cm 9 mm	dm	
		200 ml

2 **Radhiti sipas madhësisë këto njësi matëse, duke filluar prej më të voglës:**

a) 2 l 400 ml, 3 200 ml, 1,75 l, 3l 40 ml, 10 l 50 ml, 5 700 ml, 6,65 l, 289 ml.

_____

b) 15 mm, 345 mm, 3,54 cm, 34 mm, 1 m 20 cm 5 mm, 1 075 m, 30,67 cm, 1 km 700 m, 100 m

_____

3 **Shndërroji**

40 g = _____ kg	250 km = _____ m	9 ml = _____ l
2,2 kg= _____ g	8 cm = _____ m	7 mm= _____ cm
76l = _____ ml	1 234 mm = _____ cm	35 g = _____ kg
4,5 cm = _____ km	856ml = _____ l	12,45 m = _____ cm

4 **Mentori ka blerë 8 shishe me lëng prej nga 330 ml. Sa litra lëng ka blerë?**

5 **Te shtegu i atletikës ka pasur 8 garues të cilët duhej të garojnë në vrapim në 400 m. Sa kilometra kanë vrapuar të gjithë së bashku?**



1 Gjerësia e një kokrre fasule është përafërsisht 1 cm. Vlerëso, kurse pastaj kontrollo sa kokrra mund të vendosësh sipas gjatësisë në:

Banga e shkollës _____

Klasa _____

VLERËSIMI!

_____

_____

2 Tre shirita kanë gjatësi prej 17 cm, 27 cm dhe 8 dm. Zvogëloje çdonjërin për 20 mm. Sa do të jetë shuma e gjatësive të reja të fituara? Çfarë vëren?

Vlerëso dhe kontrollo vlerësimin tënd me matje dhe rrumbullako deri te njësia matëse e plotë më e afërt.

☐ + ☐ + ☐ = ☐

3 Në një garë kanë marrë pjesë 3 automobila në shtegun e gjatë 148 km. I pari ka kaluar gjysmën e shtegut, i dyti $\frac{1}{4}$ e shtegut, kurse i treti $\frac{3}{4}$ e shtegut. Sa milimetra ka kaluar çdonjëri prej tyre? Sa kilometra gjithsej kanë kaluar të gjithë së bashku.

4 Tre shokë Bobi, Jan dhe Mirsadi kanë ngjyrosur shirit prej letre për të zbukuruar klasën për Viti e Ri. Bobi ka ngjyrosur $\frac{2}{3}$ e 12 m, Jani ka ngjyrosur dyfish më shumë se Bobi, kurse Mirsadi dyfish më pak se Bobi. Nga sa cm ka ngjyrosur çdonjëri prej tyre?

Jani = ☐ Bobi = ☐ Mirsadi= ☐

5 Te figura janë dhnën masat e kafshëve. Cakto sa është masa e përgjithshme e qenit, maces dhe miut?

6 Agimi duhet të pijë një shishe me 180 më shurup. Për sa ditë do ta pijë shurupin nëse çdo ditë pin në mëngjes dhe në mbrëmje nga 15 ml.

7 Iliri dhe Sara kanë dëshiruar të shkojnë prej Velesi për në Shkup që të shikojnë një pjesë teatrale. Së pari kanë shkuar në këmbë deri te stacioni i autobusit në Veles dhe kanë kaluar 2 650 m. Pastaj janë vozitur me autobus dhe kanë kaluar 54 km. Në Shkup me autobus urban kanë kaluar 4,7 km. Dhe prej stacionit të autobusit deri te teatri kanë kaluar edhe 251 m. Sa rrugë gjithsej kanë kaluar? Zgjidhjen shprehe në numër shumëemëror dhe njëemëror.

SYPRIMA E FORMAVE 2D
PERIMETRI I DREJTKËNDËSHIT DHE KATRORIT

Krijojmë situatë problemore!

Perti është kopshtar i pasionuar. Në oborr ka lule të rrethuara me drunj. Shpesh konsultohet me gjyshen Mare, e cila ka kopsht me gardh të ulët që kafshët të mos i hanë perimet. Perti rregullisht e viziton edhe mikun Edin që jeton në fermën malore. Ato akoma nuk kanë kopsht të rrethuar, por kanë qëllim ta rrethojnë kopshtin me drunj.

- Si do t'i ndihmojë Endrit sa metra drunj duhet të blejë?
- Si gjyshja Mare ka dëgjuar sa metra tel të metalit saktë është e nevojshme që ta rrethojë oborrin e vet në formë të drejtkëndëshit me brinjë 30 metra dhe 180 decimetra?
- Nëse gjyshja Mare dëshiron të vendosë edhe shtylla të drurit për të mbështetur pjergullat e ulëta, sa shtylla i nevojiten nëse largësia ndërmjet tyre është 3m?

Udhëzim:

Dimensionet e oborrit të gjyshes Mare janë shprehur në njësi të **ndryshe të emërtuara matëse.** Duhet të paraqiten në numra të njëjtë të emërtuar 180 dm = _____ m

Se si Petri ka dëgjuar sa metra drunj anësorë i nevojiten Edinit? Në oborrin e Edinit ka pasur 9 vija lulesh.

Petri ka caktuar _____ te drejtkëndëshi ashtu që i ka matur gjatësitë e brinjëve, kurse pastaj _____ të gjitha gjatësitë e matura. Kështu, ka caktuar sa metra drunj anësorë janë të nevojshme për _____ vijën e luleve. Gjithsej, për 9 vija të luleve janë të nevojshme _____ drunj anësorë.

Mendo se si Petri ka caktuar sa metra tel është e nevojshme për rrethimin e oborrit të gjyshes Mare dhe se si të caktojë numrin e shtyllave të drurit. Skico!

Shembulli 1: Sa është perimetri i drejtkëndëshit me brinjë 5 dm dhe 2 dm?

Skica:

Zgjidhje: a=5 dm,b= _____ dm

L= 5 dm + _____ dm + _____ + 2 dm =

_____ dm+ _____ dm = _____ dm

Por mund të zgjidhet edhe kështu:

L= 2 (a + b)

L = 2 (5 dm + _____ dm)

L = 2 _____ dm

L = _____ dm

Shembulli 2: Mbulesën në formë të katrorit me brinjë prej 12 dm, dëshirojmë ta qepim me shirit. Sa metra shirit është i nevojshëm?

Zgjidhje:



Katrori ka _____ brinjë me _____ gjatësi.
Për ta gjetur perimetrin e katrorit duhet ta matim gjatësinë e brinjës së tij.

L = 4 a

L= 4 · 12 dm

L= 48 dm

48 dm = 4 m dhe 8 dm = 4,8 m

Për qepjen e mbulesës së katrorit është e nevojshme 4,8 m shirit.

Shembulli 3: Të njehsohet sa metra më së paku duhet të jetë i gjatë teli që e mbështjell platformën e vogël të pllakëzuar në formë të gjashtëkëndëshit të rregullt brinja e të cilit është e gjatë 1,45 metra, nëse teli shitet vetëm me metra të plotë?

Njehsojmë:

a = 1,45m

L = 6 • 1,45 m

L = _____ m

Për ta mbështjellë platformën, është e nevojshme _____ metra tel

Shembulli 4: Në vizatim janë dhënë disa shumëkëndësha. Mati gjatësitë e brinjëve dhe njehso perimetrin e tyre. Çka vëren? A mundesh të njehsosh në mënyrë më të shpejtë? Shkruaje mënyrën për njehsimin e perimetrit të kërkuar.



_____

_____

_____

_____



_____

_____



_____

_____



_____

_____

_____

_____

SYPRINA E DREJTKËNDËSHIT DHE KATRORIT

Krijojmë situate problemore!

Jane do ta shtrojë me pllaka pjesën drejtkëndore prej murit mbi çezmën te kuzhina me pllaka qeramike. Ai ka pllaka të ndryshme në disponim, por nëna i ka thënë të shfrytëzojë vetëm një lloj të pllakave (përkatësisht ose vetëm katrore ose vetëm drejtkëndore). Ai ka 13 pllaka katrore, 25 trekëndore dhe 5 pllaka drejtkëndore. Çfarë pllaka mund të shfrytëzojë?



Plotësoni gjykimet më poshtë për të qenë të sakta (ku duhet të vendohet numri, shkruani numrin).

Jetonit i duhen _____ pllaka katrore. Ta mbulojë murin me pllaka trekëndore, do të shpenzojë _____ pllaka. Janë të nevojshme vetëm _____ pllaka drejtkëndore. Ai mund të shfrytëzojë pllaka katrore ose pllaka _____. Nuk ka mjaftueshëm pllaka _____ për pllakëzimin e murit

Përsërisim: Tanimë e dimë se madhësia që e përshkruan madhësinë e formës 2D në rrafsh është syprina e tij.

Për matjen e syprinën në formën 2D mund ta shfrytëzojmë edhe syprinat të cilat nuk janë prej përpara me marrëveshje (jo standarde) sikurse që bëmë te shembulli paraprak me shfrytëzimin e pllakave. Megjithatë, shumë është e lehtë të flitet dhe të kuptohet nëse shfrytëzojmë njësi matëse me marrëveshje për matjen e syprinës. Ato janë milimetër katror 1 mm, centimetër katror 1 cm^2, decimetër katror 1 dm^2 dhe metër katror 1 m^2



1 dm = 10 cm	1 dm^2 = 100 cm^2
1 m = 10 dm	1 m^2 = 100 dm^2
1 m = 100 cm	1 m^2 = 10 000 cm^2
1 dm = 100 mm	1 dm^2 = 10 000 mm^2



Shembulli 1: Sa është syprina e katrorit me brinjë 1 cm?

a) = 2 cm^2 b) = 1 cm^2 c) = 1 dm^2

NJEHSIMI I SYPRINËS SË DREJTKËNDËSHIT DHE KATRORIT

Shembulli 1: Kopshti i Jakovit e ka formën drejtkëndore me gjatësi a = 156 m dhe gjerësi b = 60 m. Sa është syprina e kopshtit?



S – Shenja për syprinën

$S = a \cdot b$

$S = 156\ m \cdot 60m$

$S = 9\ 360\ m^2$

Shembulli 2: Është dhënë drejtkëndëshi me brinjë a = 25 mm dhe b = 3 cm. Sa është syprina e tij?



a = _____ mm

b = _____ cm = _____ mm

Njehsojmë: 25mm · _____ mm = _____ mm^2

Syprina e drejtkëndëshit është S = _____ mm^2

ose S = _____ cm^2

Udhëzim:

Kur gjatësia dhe gjerësia janë dhënë në njësi të ndryshme matëse, së pari patjetër duhet të shndërrohen në njësi matëse të njëjtë. Pra, pastaj e njehsojmë syprinën e kërkuar.

Shembulli 3: Me katrorë me brinjë 2 cm mbuloje drejtkëndëshin e dhënë. Sa katrorë janë të nevojshme?

Njehsojmë syprinën e katrorit me brinjë
a = 2 cm

$S = a \cdot a$

$S = a^2$

$S = 2\ cm \cdot 2\ cm$

$S = 4\ cm^2$

Njehsojmë syprinën e drejtkëndëshit me brinjë
a = 6 cm и б = 4cm

$S = a \cdot b$

$S = 6\ cm \cdot 4\ cm$

$S = 24\ cm^2$



Pasi katrorët kanë syprinë prej 4 cm^2, për mbulimin e drejtkëndëshit të dhënë do të jenë të nevojshëm **24 : 4 = 6 katrorë**.

Mbaj mend:

Syprina e drejtkëndëshit njehsohet me shumëzimin e gjatësisë dhe gjerësisë së tij dhe shkruajmë në njësinë matëse përkatëse. Nëse gjatësitë e brinjëve janë dhënë në cm, do të njehsohet syprina në cm^2 (e njëjta vlen edhe për njësitë e tjera). Kur gjatësia dhe gjerësia janë dhënë në njësi matëse të ndryshme, së pari duhet të shkruhen njësitë me njësi matëse të njëjtë. Pastaj e njehsojmë syprinën.

Syprina e katrorit njehsohet me shumëzim të gjatësisë së brinjës së tij me vetveten.

Shembulli 1: Njehso syprinën e formës.
Cakto gjatësinë e brinjëve të drejtkëndëshave, kurse pastaj me formulën njehso syprinën e të njëjtëve. Çdo katror ka brinjë me gjatësi 1,5 cm.



$S = a \cdot b$











1 Te rrjeti katror ku brinja e katrorit është 1 cm, vizato drejtkëndësh me perimetër 24 cm, kurse pastaj vizato katror me perimetër të njëjtë. Pastaj njehso syprinën në cm^2. Çfarë vëren? Drejtkëndëshi dhe katrori a kanë syprinë të njëjtë? Cakto më shumë zgjidhje të ndryshme.

2 Dhoma e Ivës e ka formën e drejtkëndëshit me gjatësi 4,65 m dhe gjerësi 30 dm. Babai i Ivës ka dashur të mbulojë dyshemenë me laminat. Sa metër katror laminat do të shpenzojë për laminat nëse 1 metër katror prej laminatit që kushton 500 denarë?

3 Njehso syprinën e formës në rrjetin e katrorit, më së paku në dy mënyra. Pastaj njehso perimetrin e tij.



1 Njehso syprinën e formave duke formuar drejtkëndësh dhe katror.

A



A = _____

B



B = _____

C



C= _____

Ç



Ç= _____

2 Njehso syprinat e formave.



3 Katrori dhe drejtkëndëshi kanë syprina të barabarta S = 36 m^2. Sa është gjatësia e brinjës tjetër të drejtkëndëshit, nëse njëra brinjë është e gjatë 12 m? Njehso perimetrin e tij. Srejtkëndëshi dhe katrori a kanë perimetra të barabartë?

4 Te rrjeta katrore me brinjë të katrorit a = $\frac{1}{5}$ m forma 2D simetrike e vizatuar. Cakto perimetrin dhe syprinën e tij. Sqaro përgjigjen tënde!



5 Te rrjeta katrore me brinjë të katrorit a = $\frac{3}{4}$ 4 dm të vizatuar në formën 2D. Cakto perimetrin e tij në decimetra, kurse syprinën shprehe në cm^2. A mundesh të njehsosh në mënyrë të shkurtër duke shfrytëzuar njohuri për formën 2D simetrike? Sqaro!



6 Njehso syprinën dhe perimetrin e çdo forme 2D që është ngjyrosur me ngjyrë të ndryshme. Njehso syprinën dhe perimetrin e gjithë formës 2D.

Si e njehsove syprinën, e si perimetrin e gjithë formës 2D?

a)



1 katror e ka brinjën e gjatë a = 7cm

b)



1 katror e ka brinjën e gjatë a = 5,5 m

7 Njehso:

- Sa metra katrorë laminat nevojiten për të mbuluar dyshemenë e dhomës tënde.
- Një banjë është pllakëzuar me pllaka me brinjë 30 cm. Janë përdor 150 pllaka. Sa metër katror është syprina e dyshemesë së banjës?

8 Në brinjët e një trekëndëshi janë zgjedhur 6 pika dhe atë 3 pika janë kulmet e tij. Cakto numrin e trekëndëshave të cilët kanë kulme tek ato 6 pika.



9 Maja ka fletë të letrës me dimensione 15 cm dhe 25 cm. E ka prerë fletën në dy pjesë drejtkëndore prej të cilave njëra ka perimetër 40 cm. Sa është perimetri i pjesës tjetër, kurse sa është syprina e të dy pjesëve?

10 Prej një teli janë bërë dy katrorë. Nëse vendosen njëri pranë tjetrit mund të fitohet drejtkëndësh me dimensione 2 dm dhe 3 dm. Sa dm tel janë përdor për të bërë dy katrorë?

11 Çatia e një shtëpie është në formë të prizmit trekëndor. Brinja më e vogël e drejtkëndëshit është 4 metra, kurse brinja më e madhe është dy herë më e madhe. Të dy muret janë trekëndësha barabrinjës.

- Cakt perimetrin e të gjitha mureve të prizmit.
- Sa qeramidhe janë tënevojshme për të dy anët e çatisë, nëse një qeramidhe është me dimensione 20 cm dhe 50 cm?

11 Syprinat e dy drejtkëndëshave janë të barabarta.

- Sa është gjerësia e drejtkëndëshit të ngjyrosur?
- Cili prej të dy drejtkëndëshave ka perimetër më të madh?



KOHA
PARAQITJA E KOHËS SË SAKTË NË ORË, MINUTA DHE SEKONDA

Të përkujtojmë!

1 orë = 60 minuta

1 minutë = 60 sekonda

Periudha kohore prej 10 vitesh quhet **decenie.**

1 decenie = 10 vite

1 **Vendosi shigjetat e orëve dhe trego kohën e cila kërkohet.**

7 : 30 : 10

9 : 45 : 30

14 : 15 : 40

19 : 05 : 35

10 : 30 : 50

2 **Shkruaje kohën e saktë që e tregon ora.**

_____ ora _____ minuta _____ sekonda

3 **Krahasoje kohën dhe vendos shenjën <, > =**

1 min. ☐ 100 sek. 60 sek. ☐ 1 min. 20 sek. ☐ 2 min.

3 min. ☐ 180 sek. 6 min. ☐ 60 sek. 5 h. ☐ 250 min.

4 **Në shitore për 5 ditë janë shitur 123 orë dore dhe 3 herë më pak orë muri. Sa më shumë janë shitur orë dore se sa orë muri?**

5 **Çfarë këndi formojnë shigjetat e orëve?**

_____

_____

_____

_____

_____

6 **Nën çdo orë shkruaj sa është ora. Ndërmjet tyre shkruaje intervalin kohor të kohës së kaluar në të dy orët.**



_____ h. _____ min.

☐ ☐



_____ h. _____ min.

☐ ☐

7 **Cilën kohë do ta tregojë ora pas 34 minuta. Shëno kohën tek ora.**



8 **Shndërroji .**

245 orë = _____ ditë _____ orë

900 sekonda = _____ minuta

660 sekonda = _____ minuta

972 minuta = _____ orë _____ minuta

9 ditë dhe 13 orë = _____ orë

12 ditë 23 orë = _____ orë

$9\frac{1}{2}$ ditë = _____ orë

9 **Shndërroji**

a) **në vite**

2 shekuj = _____

52 javë = _____

730 ditë = _____

48 muaj = _____

18 muaj = _____

3,5 shekuj = _____

b) **në muaj**

3 vjetë = _____

$\frac{1}{3}$ vjetë = _____

12 javë = _____

1 decenie = _____

2,5 vjetë = _____

c) **në ditë**

96 orë = _____

3 javë = _____

12 orë = _____

36 orë = _____

ç) **në minuta**

$3\frac{1}{2}$ orë = _____

480 sekonda = _____

$\frac{1}{4}$ 4 orë = _____

5,5 orë = _____

10 **Shndërroji në njësi matëse të përzier:**

a) 85 min =_____ orë _____ minuta

b) 200 min =_____ orë _____ minuta

c) 180 min = _____ orë _____ minuta

ç) 190 s = _____ minuta _____ sekonda

d) 364 s = _____ minuta _____ sekonda

dh) 3 654 s = _____ orë _____ minuta _____ sekonda

11 **Lidhi orët sikurse është treguar:**

15 minuta pas 5 orë

3 orë

15 minuta deri në 5 orë

8 orë

30 minuta pas 10 orë

12 Nëna e Kaltrinës ka filluar ta përgatitë drekën në ora 14:45. Dreka ka qenë gati në ora 15:30. Sa kohë është përgatitur dreka?

13 Admiri ka shkuar në trening për futboll në ora 16:20. Treningu ka zgjatur 65 minuta. Në sa ora Admiri mbaruar me treningun?



Të përkujtojmë!

Periudha kohore prej 100 vjet quhet **shekull.**

1 shekull = 100 vjet

Periudha kohore prej 1 000 vjet quhet **milenium.**

1 milenium = 1 000 vjet

1 **Shndërroji masat dhe plotëso tabelën.**

Numri i **shekujve** në një **milenium**	
Numri i **decenieve** në një shekull	
Numri i **viteve** në një decenie	10
Numri i **muajve** në një vit	
Numri i **javëve** në një vit	
Numri i **ditëve** në një vit	365
Numri i **orëve** në një ditë	
Numri i **minutave** në një orë	
Numri i **sekondave** në një minutë	

2 **Plotësoje tabelën ashtu që shuma e njësive për kohën në çdo shtyllë të jetë 1 shekull.**

3 decenie		92 vite dhe $\frac{1}{2}$ decenie		25 vite dhe 5 decenie
	77 vite		6 decenie dhe 5 shekuj	

3 **Plotësoje tabelën ashtu që shuma te çdo shtyllë të jetë 1 milenium.**

3 shekuj		900 vjet dhe $6\frac{1}{2}$ decenie		37 decenie dhe 5 shekuj
	390 vjet		60 decenie dhe 360 muaj	

4 **Paraqiti intervalet prej orëve.**

Sa është ora? _____

Sa do të jetë ora për 4 orë dhe 43 minuta? _____

Sa ishte ora para një ore dhe 20 minuta? _____

Sa do të jetë ora për 2 orë dhe 10 minuta? _____

Sa është ora? _____

Sa do të jetë ora për 4 orë dhe 23 minuta? _____

Sa ishte ora para 1 ore dhe 34 minuta? _____

Sa do të jetë ora për 4 orë dhe 52 minuta? _____

Sa është ora? _____

Sa do të jetë ora për 2 orë dhe 31 minuta? _____

Sa ishte ora para 2 orë dhe 26 minuta? _____

Sa do të jetë ora për 1 orë dhe 34 minuta? _____

5 **Bëje kornizën kohore dhe planin për:**

1) Një ditë shkolle

a) _____ **ç)** _____

b) _____ **d)** _____

c) _____ **dh)** _____

2) Përgjigje

a) _____ **ç)** _____

b) _____ **d)** _____

c) _____ **dh)** _____

2) Ekskursion

a) _____ **ç)** _____

b) _____ **d)** _____

c) _____ **dh)** _____

6 **Babai i Igorit është nisur në punë në ora 07:15. Prej punës kthehet në ora 17:05. Sa gjatë babai I Igorit kishte dalë nga shtëpia?**

7 **Damjani me gjyshen e vet kanë shkuar në kopsht për t'i ndihmua në mbjelljen e luleve. Kanë filluar të punojnë në orën 11:08. Kanë punuar 3 orë dhe 56 minuta. Në ora sa kanë mbaruar me punë?**



8 **Merima ka dëshiruar të shkojë në teatër. Prindërve të saj u ka treguar se do të kthehet në shtëpi menjëherë pas mbarimit të shfaqjes. Prej shtëpisë ka dalë në ora 17:30. Deri në teatër ka shkuar në këmbë 20 minuta. Shfaqja ka filluar 10 minuta pas arritjes së saj dhe ka zgjatur 45 minuta. Menjëherë pas mbarimit të shfaqjes është nisur për në shtëpi dhe ka ecur 8 minuta. Në ora sa Merima është kthyer në shtëpi?**

1 Paraqite orën digjitale dhe analoge në kohën e dhënë.

	ora digjitale	ora analoge	Këto janë aktivitete në një ditë të shtune të Markut. Shkruaj shembull të fakteve për çdo aktivitet.
8.30 paradite ora			
2 dhe 20 minuta më vonë ora			
1 dhe 15 minuta më vonë ora			
6 dhe 23 minuta më vonë			
17 minuta më vonë			

2 **Përgjigju në këtë pyetje:**

Një milenium ka _____ vjet.

Në 10 vjet ka _____ decenie.

1 vjet dhe 24 ditë kanë _____ ditë, por _____ orë.

Në këtë vit kanë kaluar _____ ditë, të shndërruar në _____ orë, në _____ minuta, në _____ sekonda.

3 **Në shkollë qëndroj prej orës 7 dhe 30 minuta deri në orën 12 dhe 45 minuta.**

Sa orë dhe minuta jam në shkollë?

Sa minuta qëndroj në shkollë?

Sa sekonda qëndroj në shkollë?

Sa minuta qëndroj në një javë pune, nëse çdo ditë qëndroj në kohë të njëjtë.

4 **Sa minuta kanë kaluar nga ky vit?**

5 **Sa sekonda është një mësim në shkollë?**

6 **Zgjidh dy ngjarje historike dhe thuaj sa dekada më parë kanë ndodhur ato?**

7 **Njehso kur është data e mijëvjeçarit të ri?**

8 Orët në shkollë fillojnë në ora 8:00, por mbarojnë në ora 13:30.
Sa kohë Mario ka qenë në shkollë?

9 Gjyshi i Agimit është nisur në arë në ora 07:15. Prej arës deri në shtëpi kthehet në ora 18:05. Sa gjatë gjyshi i Agimit ka qenë në arë?

9 Ana është nisur në garën e basketbollit. Prindërve të vet u ka thënë se do të kthehet në shtëpi menjëherë pasi të mbarojë gara. Prej shtëpie ka dalë në ora 18:30. Deri te salla sportive ka ecur 30 minuta. Gara ka filluar me vonesë prej 10 minuta. Gara ka zgjatur 40 minuta. Menjëherë pas mbarimit të garës është nisur për në shtëpi me taksi dhe ka udhëtuar 8 minuta. Në ora sa Ana është kthye në shtëpi?

1 **Është dhënë orari i trenit të udhëtimit prej Shkupi për në Manastir.**

qytet	Shkup	Zelenikovë	Veles	Çashkë	Bogomillë	Prilep	Manastir
koha	6:48	7:19	7:53	8.12	8:50	9:39	10:12

Për sa kohë ka arritur treni i udhëtarëve:

prej Shkupit deri në Zelenikovë _____

prej Zelenikovës deri në Veles _____

prej Velesit deri në Çashkë _____

prej Çashkës deri në Bogomillë _____

prej Bogomillës deri në Prilep _____

prej Pilepit deri në Manastir _____

Sa kohë gjithsej ka udhëtar prej Shkupi deri në Manastir? _____

Shndërroji në minuta _____

2 **Duke shfrytëzuar orari e trenit prej detyrës 1, plotëso.**
Treni i udhëtarëve niset prej Shkupi në ora 11:13, plotëso orarin e udhëtimit.

qyteti	Shkupit	Zelenikovë	Veles	Çashkë	Bogomillë	Prilep	Manastir
koha	11:13						

3 **Shkruaje orarin e udhëtimit prej Manastirit deri në Shkup, nëse treni niset prej Manastirit në ora 16:00.**

qyteti	Manastir	Prilep	Bogomillë	Çashkë	Veles	Zelenikovë	Shkupit
koha	16:00						

4 **Ditën e shtunë klasa VIa ka pasur ekskursion nga Shkupi deri në Manastir me tren.**

Është nisur nga Shkupi me tren të udhëtarëve në ora 6:48 në mëngjes, por janë kthyer me trenin e udhëtarëve që është nisur nga Manastiri në ora 16:00.

Sa kohë kanë kaluar prej momentit të nisjes nga Shkupi deri në kthim në Shkup? _____

Sa kohë kanë qëndruar nxënësit në Manastir? _____

NJEHSIMI I INTERVALEVE KOHORE DHE ZONAT KOHORE



1 **Përgjigju në pyetjen.**

Sa zona kohore ka në Evropë? _____

Sa zona kohore ka në Australi? _____

Sa zona kohore ka në Amerikën Veriore? _____

2 **Shkruaj tre shtete evropiane që janë në zonën e njëjtë kohore me Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

_____

3 **Shkruaj tre shtete evropiane që janë në orën + 1 prej zonën kohore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

_____

4 **Shkoj në shkollë në ora 7:30.**

Sa është ora në atë kohë në Sidnej? _____

Sa është ora në atë kohë në Nju-Jork? _____

Sa është ora në atë kohë në Londër? _____

5 Millani, Igori dhe Sashko janë shokë të cilët jetojnë në Nju-Jork, Amsterdam dhe Tokio. Janë dakorduar të kenë lidhje konferencë në Skajp. Igori është lidhur në Skajp në ora 23:00 sipas kohës lokale në Amsterdam. Sa ka qenë ora te shokët e tjerë?

6 Sa herë në një ditë e një natë do të puthiten shigjetat për minuta dhe shigjeta për orë tek ora me shigjeta?

7 Sot është e diel. Ora e murit shkon përpara çdo ditë nga dy e gjysmë minuta. Kur kjo orë përsëri do të tregojë kohë të saktë? Edhe atëherë a do të jetë ditë e diel?

TEMA 5
Puna me të dhëna

- **Leximi Mbledhja, organizimi, rregullimi dhe paraqitja e të dhënave**
- **Gjasa për ndodhjen e ngjarjes**

REZULTATET NGA TË MËSUARIT

Nxënësi /nxënësja do të aftësohet:
1. të planifikojë dhe realizojë hulumtim të pyetjeve nga konteksti i përditshmërisë;
2. yë vlerësojë mundësinë që të ndodhë ngjyrja e caktuar me eksperiment të dhënë.

SFIDAT E MUNDSHME

Hulumtimi, mbledhja e të dhënave në tabelë është pikënisja e të kuptuarit të qëllimit për të për të kuptuar punën me të dhëna. Nxënësit shpeshherë i përziejnë diagramet si shtyllor dhe vijor dhe në mënyrë jo drejtë i vendosin koordinatat te diagram vijor dhe shtyllor sipas të dhënave të mbledhura në tabelën e dendësisë. Sfida është të planifikohet hulumtimi, të formulohen pyetje konkrete për hulumtim.
Aktivitet sfidues është nxënësit të mësojnë dhe praktikisht të zbatojnë të dhënat e mbledhura me diagram shtyllor, vijor dhe rrethor me të cilat do t'i paraqesin të dhënat.

Fjalori i koncepteve të reja

Diagram shtyllor, diagram vijor, diagram rrethor, mod/moda

Tema 5

LEXIMI, MBLEDHJA, ORGANIZIMI, RREGULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

PARAQITJA DHE TË LEXUARIT E TË DHËNAVE TË DIAGRAMIT SHTYLLOR

- Si mund të mbledhim të dhëna?
- Pse na duhen?
- Në çfarë mënyre mund t'i paraqesim?

1 Nxënësit në një klasë të pestë kanë bërë anketë tek e cila shkruhet për frutin e tyre më të këndshëm. Të dhënat e mbledhura i kanë paraqitur në këtë diagram



Cili frut ka marrë më shumë vota? _____

Sa vota më shumë ka pasur kumbulla prej pjeshkës?

_____

Sa më shumë vota ka marrë rrushi prej portokallit?

_____

Sa më pak vota kanë marrë dardhat dhe bananet?

_____

Bananet kanë marrë dyfish më shumë vota prej mollës. „A është kjo e saktë"? _____

Rrushi ka marrë dyfish më shumë vota se portokajtë. „A kjo është e saktë"? _____

2 Shoqata ekologjike „Flora" në vitin 2 020 çdo muaj ka mbjellë fidanë në lokalitetet e Maleve të Osogovës. Të dhënat i kanë paraqitur me diagram.



Sa fidanë kanë mbjellë në vitin 2020?

_____

Në cilin muaj kanë mbjellë më pak fidanë?

_____

Në cilin muaj kanë mbjellë më shumë fidanë?

_____

Sa fidanë janë mbjellë në korrik në krahasim me qershorin? _____

Sa fidanë më pak janë mbjellë në maj në krahasim me prillin?_____

Sa është ndryshimi i fidanëve prej gjysmës së parë të vitit në krahasim me gjysmën e dytë të vitit? _____

3 **Në bibliotekën e shkollës, bibliotekistja Merita ka pasur evidencë për numrin e librave të dhënë gjatë vitit. Të dhënat i ka paraqitur në tabelë.**

Muaj	Numri të librave të dhënë
Janar	26
Shkurt	56
Mars	68
Prill	40
Maj	35

Qershor	70
Korrik	0
Gusht	0
Shtator	35
Tetor	50
Nëntor	59
Dhjetor	30

Të dhënat e shkruar në tabelë paraqiti me diagram shtyllor.

PARAQITJA DHE LEXIMI I TË DHËNAVE PREJ DIAGRAMIT RRETHOR

Te tabela vijuese janë dhënë informatat për aktivitetet ditore të Damjanit pesëvjeçar.

Aktivitet	shkolla	fjetje	mësim	sportim	Shikim të televizionit/puna në kompjuter	ngrënie
Numri i orëve në një ditë e një natë (h)	6	8	3	2	3	2

Sa ore ka një ditë e një natë?
Çfarë pjese e ditës dhe natës paraqet aktiviteti i Damjanit? Plotëso:

Aktivitet	**Numri i orëve (h)**	**Pjesë prej gjithë ditës e natës**	**Pjesë prej tërësisë**
shkolla	**6**	**24 : 6 = 4**	$\frac{1}{4}$
fjetje	**8**	**_____ : 8 =**	
mësim	**3**	**24 : _____ = 8**	$\frac{1}{8}$
sportim	**2**		
Shikim TV/puna në kompjuter	**3**		
ngrënie	**2**		



Të dhënat për aktivitetet e Damjnanit gjatë një dite mund të paraqiten me ndihmën e diagramit rrethor. Nëse rrethin e paramendojmë si një tërësi, atëherë çdo aktivitet (pjesë e ditës) e paraqesim si pjesë të rrethit.
Kur kemi të dhëna të cilat duhet të organizohen dhe paraqiten si pjesë e tërësisë ose shprehen në përqindje, shpeshherë shfrytëzohet paraqitja me ndihmën e diagramit rrethor.

1 Është bërë anketë se çfarë filmi duan të shikojnë nxënësi e klasës së pestë.
Të dhënat janë paraqitur në këtë tabelë:

Lloj i filmit	Horor	komedi	aksion	dramë	Fantastika shkencore	Numri i përgjithshëm i nxënësve
Numri i nxënësve	12	32	24	16	12	

Plotësoje tabelën për të caktuar pjesën e nxënësve të cilët shikojnë një lloj të filmit, kurse pastaj të dhënat e fituara paraqiti me ndihmën e diagramit rrethor.

Lloj i filmit	Sa pjesë prej numrit të përgjithshëm të nxënësve	Pjesa prej tërësisë së
hororit	_____ : 12 =	$\frac{1}{8}$

2 Diagrami i dhënë rrethor i paraqet informatat që duan të sportojnë 240 nxënës prej një shkolle. Diagrami është ndarë në pjesë sipas numri të nxënësve të cilët duan sport të caktuar dhe atë:



futboll
basketboll
notim
skijim

Cakto sa është pjesa e nxënësve prej numrit të përgjithshëm të nxënësve që duan sport?
Sa është numri i nxënësve të cilët duan futboll, basketboll, notim dhe skijim?

Udhëzim: futboll duan $\frac{1}{2}$ e 240 nxënësve, kurse ajo është _____ nxënës.

3 **Numri i përgjithshëm i nxënësve në klasën e pestë është 84 prej të cilëve 38 vajza dhe 46 djem.**

Sa përqind kanë qenë djem? _____
Sa përqind kanë qenë vajza? _____
Sa përqind ka pasur më shumë djem se vajza? _____



4 **Petri me shoqene vet Denicakanë bërë hulumtim: Cila kohë vjetore është më e dashur për shokët e tyreve?**

Sa përqind prej shokëve kanë thënë se dimri është stina më e mirë? _____
Sa përqind prej shokëve kanë thënë se vera është stina më e mirë? _____
Cila pjesë e shokëve kanë zgjedhur dimrin si stinë më të dashur?



Cili pjesë e shokëve e kanë zgjedhur pranverën për stinë më të dashur?
Cila përqindje e shokëve e kanë zgjedhur verën si stinë më të dashur?
Nëse Petri dhe Denica hulumtimin e kanë bërë me 20 shokë, sa e kanë zgjedhur verën?
Petri dhe Denica cakanë anketuar 32 shokë, sa prej tyre e kanë zgjedhur vjeshtën si stinë më të dashur?

5 **Në një shkollë nxënësit kanë pasur mundësi të ndjekin më shumë gjuhë të huaja.**
Te diagram rrethor janë paraqitur të dhënat sipas nxënësve që kanë prezantuar në orë.
Shqyrto diagramin dhe përgjigju në këto pyetje:

Gjuhët e zgjedhura prej nxënësve



Cila gjuhë është mësuar më shumë? _____
Çfarë pjese e nxënësve kanë mësuar gjuhë gjermane? _____
Çfarë pjese e numrit të përgjithshëm të nxënësve kanë prezantuar në orët e gjuhë shqipe dhe italiane?
Më shumë prej nxënësve a kanë mësuar gjuhë të njëjtë? _____
Nëse ka pasur 120 nxënës, sa nxënës kanë marrë pjesë në orët e gjuhës gjermane? _____
Cilat gjuhë i kanë mësuar më shumë se ¼ e nxënësve? ____

Elementet e diagramit vijor:



1 **Shkalla** – tregon numrin e nxënësve në boshtin y. Te ky diagram ajo është ndarë në 10 ndarje, çdo ndarje tregon numrin e diçkait që matet.

2 **Emri** i boshtit y – na tregon çka është ajo që matet/numërohet.

3 **Pika** – tregon sa diçka ka ose ndodh në periudhë të caktuar (fakte). Këtu çdo pike tregon sa akullore janë shitur në ditën e caktuar.

4 **Emri i boshtit x** –tregon informatën e njohur (faktin). Me ndihmën e informative prej boshtit x të dhënat mund të krahasohen.

5 **Emri i diagramit** – na tregon për çka janë të dhënat.

6 Te diagram pikat fqinje lidhen me **vija** dhe fitohet vija e thyer. Prandaj edhe diagrami quhet vijor.

Nëse prej njërës pikë deri te tjetra vija është e formës atëherë numrat që paraqesin informata të caktuara zmadhohen, pra thuhet se ka trend **të rritjes, nëse vija është e formës** thuhet se kemi trend të zvogëlimit, kurse nëse vija është horizontale atëherë themi se **nuk ka ndryshim**

Ja edhe një shembull për elementet e diagramit vijor:



1 **Në sallonin e automobilave në vitin 2 021 të punësuarit e kanë përcjellë shitjen, kurse të dhënat i kanë shënuar në diagram vijor.**



Duke shfrytëzuar diagramin vijor përgjigjuni në këto pyetje.

Sa automobila janë shitur gjatë muajit maj?
Sa automobila janë shitur në tre muajt e parë të vitit?
Sa automobila më shumë janë shitur në muajin korrik prej majit?
Në cilin muaj janë shitur 26 automobila?

Te tabela përgjigju me E SAKTË ose E PASAKTË për thëniet:

A	Fillimi dhe mbarimi i viti ka më së paku numër të shitjeve të automobilave	
B	Shitja e automobilave rregullisht zmadhohet prej marsit deri në gusht	
C	Në gusht ka dyfish më shumë automobila të shitur prej dhjetorit	
Ç	Salloni ka fituar më së shumti në gusht dhe shtator	
D	Shitja e automobilave është zvogëluar prej gushtit deri në dhjetor	

2 Prindërit e Ivanit çdo ditë kanë ecur. Rezultatet prej ecjes i kanë shkruar në tabelë.

Ditët	largësia në km
E hënë	3,6
E martë	4,4
E mërkurë	2,8
E enjte	1,8
E premte	4,2
E shtunë	3,6
E diel	5,2

Rezultatet paraqiti në diagram vijor.
Cilën ditë kanë ecur më shumë?
Cilën ditë kanë ecur më pak?
Në cilat ditë kanë ecur njëlloj?

3 **Te tabela janë dhënë të dhënat për popullatën në një qytet. Paraqiti me ndihmën e diagramit vijor. Përgjigju!**

- Sa ka qenë popullata në vitin 2010? _____
- Sa është rritja e popullatës prej vitit 2000 deri në 2010?
- Në cilin vit ka pasur zvogëlim të popullatës për 1 000? _____
- Në cilat vite ka rritje të popullatës për 4 000? _____
- Si ka qenë ndryshimi i popullatës prej vitit 2000 deri në vitin 2020?



Viti	Popullata
2 000	3 000
2 005	7 000
2 010	9 000
2 015	8 000
2 020	10000

MODA

E dhëna që më së shpeshti përsëritet në një grup të të dhënave quhet MODA.

Në grupin e të dhënave mund të mos ketë moda ose ka më shumë se një moda.
Për shembull: Në grupin e të dhënave: 2 2 3 4 2 4 4 3 5 të dhënat 2 dhe 4 paraqiten me nga 3 herë, pra kemi dy moda të ndryshme.
Në grupin e të dhënave 1 2 3 4 5 6 çdo e dhënë përsëritet nga një here, pra themi se ky grup i të dhënave nuk ka moda.

1

1 Radhiti numrat prej më të voglit deri te më i madhi, kurse pastaj cakto modën te çdo grup i numrave.

1, 3, 5, 1, 89, 24, 6, 32, 5, 5	Moda:
8, 7, 7, 8, 40, 62, 31, 7, 43	Moda:
2, 5, 17, 49, 2, 4, 8, 17, 2, 5	Moda:
5, 6, 3, 42, 7, 7, 10, 8, 5, 8, 7	Moda:
1, 30, 1, 4, 5, 3, 1, 1, 3, 5	Moda:
12, 2, 5, 8, 10, 10, 4, 6, 10, 7	Moda:

2

Gjeje numrin që mungon prej paraqitjes së të dhënave?

2, 2, 3, 4, 4, 5, 6, 25, 190, , 3, 50, 8, 9	Moda: 4
10, 11, 32, 45, 4, 5, 7, 7, 26, 3, 5, 8	Moda: 5
1, 1, 2, 4, 4, 6, 8, 9, 68, 36, 100, 8	Moda: 8

3

Prej të dhënave të paraqitura te të dy bashkësitë gjeje MODËN.



Moda:



Moda:

4

Prej grupit vijues të të dhënave cakto MODËN:

A) tenis, basketboll, henboll, basketboll, futboll, henboll, volejboll, henboll, vaterpollo

B) çanta, futrolla, çanta, libri, fletorja, çanta, lapsi, goma, futrolla, Lapsi, vizorja

C) banania, molla, dardha, molla, qershia, dardha, kumbulla, molla, qershia, banania.

5

Mblidhi të dhënat për numrin e këpucëve të cilat i mbajnë shokët në klasën tënde. Sipas të dhënave cakto MODËN.

Tema 5

GJASA PËR NDODHJEN E NGJARJES

GJITHMONË, NDOSHTA, ASNJËHERË

Gjatë realizimit të një eksperimenti më së shpeshti na intereson ecuria e eksperimentit. Çdo ecuri quhet edhe ngjarje.
Në një eksperiment ndonjë ndodhi mund të ndodhë, asnjëherë të mos ndodhë ose gjithmonë të ndodhë.
Shembull: Hedhja e monedhës prej 5 denarë në sipërfaqe të rrafshët.
Ngjarje që mund të ndodhin janë: paraqitet „numri" dhe paraqitet „stema". Mundësia të ndodhë çdonjëra prej këtyre ngjarjeve është me gjasë të barabartë.
Ngjarja që asnjëherë nuk ndodh është „është paraqitur numri 2 denarë".
Ngjarje që asnjëherë të ndodh është ngjarja që të paraqitet numri ose të paraqitet stema.

Të shqyrtojmë fotografitë dhe të përgjigjemi në pyetjet:

1 **Gjatë realizimit të një eksperimenti disa ngjarje do të ndodhin më shpesh, por disa më rrallë.**
Shqyrtoni stilolapsin dhe përgjigjeni?

1. A është e besueshme se shigjeta të qëllojë në fushën e verdhë ose të kaltër? Pse?
2. Në cilat ngjyra janë fushat ku mundësia të qëllojë shigjeta është e barabarta?
3. Në cilën ngjyrë të fushës shigjeta asnjëherë nuk do të qëllojë?
4. Në cilën ngjyrë të fushës është e besueshme të qëllojë shigjeta e pikados? Pse?

2 **Në një enë ka topa 5 të bardhë dhe 2 të zinj. Nxirren 3 njëkohësisht. Deri te çdonjëri prej ecurive shkruaj a është e mundshme, e sigurt ose e pamundshme.**

Prej topave të nxjerrë të paktën njëri është i bardhë _____.
Janë nxjerrë tre topa të zinj _____.
Janë nxjerrë 2 topa të zinj dhe një të bardhë _____.Janë nxjerrë topa me ngjyrë të njëjtë _____.

3 **Brenda çantës gjenden këto sende:**

Çka është më e besueshme, të nxirret stilolapsi ose të nxirret ngjyra?
Çka është më e besueshme, të nxirret lapsi ose të nxirret ngjyra?
Cili send është me besueshmëri më të vogël të nxirret prej çantës?
Cili send ka besueshmëri më të madhe të nxirret prej çantës?

4 **Sa ecuri të ndryshme mund të fitohen gjatë hedhjes së zarit për të luajtur? A është më e besueshme të paraqitet njëshi ose pesëshja? Sqaro!**



5 **Nëse hedh dy zare për të luajtur njëkohësisht, cilat ecuri mund t'i fitosh? Shkruaj të paktën 4 ecuri të ndryshme!**

6 **Sa është gjasa, me siguri ose e pamundshme gjatë hedhjes së dy zareve njëkohësisht të ndodhin këto ngjarje:**

- Shuma e pikave te faqja e sipërme prej të dy zareve është 18.
- Paraqitet numri i njëjtë i pikëve.
- Ndryshimi i numrit prej faqes së sipërme të të dy zareve që nuk është më i madh se 5.
- Në faqen e sipërme prej të dy zareve ka numër çift të pikave.

6 **Gjatë hedhjes së dy zareve, radhiti sipas mundësisë të ndodhin, ecuritë e dhëna, duke filluar prej më të besueshmes! Sqaro përgjigjen!**

Të paktën njëra prej pikave paraqitet numër tek i pikave
Paraqiten dy njëshe
Shuma e pikave prej të dy zareve është 4
Te zari i parë numri i pikave është më i madh se numri i pikave të zarit të dytë.